



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

TRANSKRIPT

I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 3 DHE 1 E 4 QERSHOR 2018

SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 3. MAJA, 1. I 4. JUNA 2018. GODINE

MAJ/QERSHOR - MAJ/JUN
2018

Rendi i ditës

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbaleve nga seanca e mëparshme,
4. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Traktatit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Hungarisë për ekstradim,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për amnistinë,
7. Emërimi i drejtorit dhe zëvendës drejtorit të Sekretariatit Ekzekutiv të Agjencisë për Krahasim dhe Verifikim të Pronës,
8. Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për (1) një anëtar të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës nga komuniteti shqiptar,
9. Propozimi i Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje për shkarkimin e nënkryetares së Kuvendit, znj. Aida Dërguti,
10. Formimi i Komisionit Hetimor Parlamentar në lidhje me shpenzimet për lobim nga Presidenca dhe Qeveria e Republikës së Kosovës.

Dnevni red

1. Vreme za izjave van dnevnog reda,
2. Vreme za parlamentarna pitanja,
3. Usvajanje zapisnika sa prethodnih sednica,
4. Razmatranje Nacrta zakona o ratifikaciji traktata između Republike Kosova i Mađarske za ekstradiciju,
5. Prvo razmatranje Nacrta zakona o disciplinskoj odgovornosti sudija i tužioca,
6. Prvo razmatranje Nacrta zakona o amnestiji,
7. Imenovanje Direktora i zamenika direktora Izvršnog sekretarijata Agencije za upoređivanje i proveru imovine,
8. Formiranje ad hoc Komisije za izbor kandidata za jedan (1) član Borda Radio Televizije Kosova iz albanske zajednice,
9. Predlog parlamentarne grupe Pokreta Vetëvendosje za razrešenje potpredsednice Skupštine, g.đe Aida Dërguti,
10. Formiranje Parlamentarne istražne komisije u vezi sa troškovima za lobiranje od strane Predsednika i Vlade Republike Kosova.

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

Kabinet qeveritar,

I hap punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, sipas rendit të ditës, të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 19 prill 2018.

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Koha për deklarime jashtë rendit të ditës është e kufizuar deri në 30 minuta, diskutimi në emër të grupit parlamentar zgjat deri në pesë minuta, ndërsa diskutimi i deputetit zgjat deri në tre minuta.

Deputetët e paraqitur për diskutim duhet të deklarohen se në çfarë cilësie e kërkojnë fjalën.

Anton Quni e ka fjalën.

ANTON QUNI: Faleminderit, zoti kryetar!

Do të flas në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës.

Dua të vazhdoj aty ku nuk m'u lejua nga kryesuesi i seancës, zotit Xhavit Haliti, në seancën e kaluar.

Në përmbledhje të shkurtër dua të ritheksoj se në periudhën '98-'99, përkundër vështirësive, kishte komunikim, marrëveshje, ndihma ndërmjet autoriteteve të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe institucioneve të saj dhe të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Posaçërisht ishe e theksuar gatishmëria dhe bashkëpunimi i Ministrisë së Mbrojtjes me Shtabin e Përgjithshëm të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës për të zhvilluar kapacitetet e plota ushtarake.

Nga fondet që janë menaxhuar nga Qeveria e Kosovës dhe Ministria e Mbrojtjes janë ndarë mjete të shumta, të cilat u janë dorëzuar në besim komandantëve të njëjësive lokale, nënzoneve, zoneve, deri te Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Në takimet e rregullta të ne ushtarakëve me ministrin e Mbrojtjes, kolonel Ahmet Krasniqi, e pastaj me kolonel Halil Bicajn, gjithnjë është kërkuar dhe biseduar për unifikimin dhe ndërtimin e një hierarchie ushtarake dhe për të gjitha vështirësitë në këtë proces.

Në këto biseda është kuptuar, gjithnjë sipas kolonel Ahmet Krasniqi, se këto procese të unifikimit me të gjitha amplitudat e saj janë të varura edhe nga qëndrimi i Xhavit Halitit, në atë kohë i njohur si "Zeka".

Për të qenë më specifik, në shumicën e transaksioneve për qëllime të ndryshme, siç janë: ndihma urgjente Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, blerja e armatimit për njësitë operative të UÇK-së së Ministrisë së Mbrojtjes, e të tjera, lakohej emri i Xhavit Halitit.

Në dokumentet ku palët dëshmojnë pranim-dorëzimin e mjeteve qëndrojnë preambula e Qeverisë së Kosovës, apo e Ministrisë së Mbrojtjes, vulat përkatëse dhe numrat e protokollit.

Në shpjegimet e mia në emisione dhe intervista të ndryshme fokusi ishte te faktet që dëshmojnë se ka ekzistuar dhe ka funksionuar Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Kosovës, për të cilën ende ka mohime nga aktorë të ndryshëm.

Në dëshmitë e mia nuk ishin në fokus shuma apo totali i të hyrave nga institucionet e Kosovës te Shtabi i Përgjithshëm, komandat e zonave, njësitë, e tjera.

Por, reagimi agresiv i zotit Xhavit Haliti dhe fare i paarsyeshëm, tani më bën të dyshoj se në pyetje janë shuma shumë më të mëdha dhe të bëj pyetje a u përdorën ato para për qëllimin e destinuar?

Është fakt se kompetent për çështjet e financimit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës janë të gjithë ata që ju, zoti Haliti, i apostrofuat në seancën e kaluar. Unë do të respektoj autoritetin e tyre që të deklarohen kur ata e shohin të arsyeshme, por me forcën e fakteve dhe argumenteve gjithnjë do të flas edhe për rolin e Ministrisë së Mbrojtjes për çlirimin e Kosovës.

Unë këtu, ashtu siç kërkuat ju, zoti Haliti, i kam dëshmitë, ato dëshmi janë të klasifikuara dhe varet nga ju a do t'i publikoni apo jo, por nëpërmjet administratës do t'i përcjell te ju, ku janë të gjitha dëshmitë, ku përfshihen protagonistët, dita, data, vula, preambula, shuma e kalimit të mjeteve financiare nga Ministria e Mbrojtjes...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Zoti Haliti e ka kërkuar fjalën.

XHAVIT HALITI: Se sa i mbani sekretet, zotëri, po shihet që i jepni Administratës së Parlamentit dhe Administrata e Parlamentit nuk është institucion për ruajtjen e dokumenteve të klasifikuara.

Sidoqoftë, sa për ta përkujtuar, unë kam pasur raporte me Ibrahim Rugovën, me Bujar Bukoshin, me Agim Mehmetin, me Nikë Gjeloshin, me Shaqir Shaqirin, me Anton Kolën, me të gjithë kemi biseduar, duke filluar shumë herët, deri te themelimi i Fondit kombëtar, si e kemi quajtur atëherë dhe prishja e atij fondi unik nga Bujar Bukoshi dhe Ali Aliu, që e kanë shndërruar në

Fond të 3%-shit dhe e di shumë mirë edhe Fondin e Qeverisë së Kosovës edhe Fondin e Ahenit të famshëm, sepse këto ndodhin kur ka përçarje politike, por unë nuk dua t'i analizoj këto çështje.

E vërteta është që mua më është afruar Ahmet Krasniqi, nuk e kam ditur kush është, më është afruar përmes Shaban Mujës, Bardhyl Mahmutit dhe Bilall Sherifit dhe më kanë thirrur në një takim në shtëpinë e Bilall Sherifit. Që ku është Bilalli këtu, në takim ka qenë edhe Hilmi Nebiu, Ahmet Krasniqi nuk ka qenë ministër i Mbrojtjes.

Oficerët, të cilët ju po i quani 'oficerë të Ministrisë së Mbrojtjes', i kanë pasur tri ministri të mbrojtjes.

Ahmeti ka qenë vullnetmirë, ka premtuar që të gjitha mjetet që disponon Qeveria e Kosovës në mërgim do t'ia dorëzojë Shtabit të Përgjithshëm për ta udhëhequr luftën, ky ka qenë premtimi me shkrim.

Ato të tjerat, biseda të mëparshme nuk është vendi dhe nuk hapësirë kohore për të diskutuar. Problemi është dhe e mira e asaj është edhe kjo që e thatë edhe ju, që ka pasur përpjekje dhe ka pasur bashkëpunim, por ka pasur edhe hezitim.

Unë kam bashkëpunuar ngushtë me Ahmet Krasniqin deri sa është vrarë, kam bashkëpunuar edhe me zotin Bicaj, edhe me Agim Mehmetin, unë s'kam ditur as kush je. I di problemet që kanë qenë, akuza, kundër-akuza, pas luftës e kam marrë vesh kush ke qenë, kush je, tash je deputet i Kuvendit të Kosovës.

Por dua të them që segmente të caktuara, edhe të grupit të oficerëve, edhe të Qeverisë së Kosovës e kanë penguar Ahmet Krasniqin, një.

Dhe, e dyta, Ahmet Krasniqi është emëruar ministër i Mbrojtjes shumë vonë dhe ka luftuar me ato struktura të Qeverisë, sepse nuk e emëronin për ministër të Mbrojtjes. Kështu që unë i di gjërat më thellë se disa që mund të jenë edhe oficerë të ish-armatës së Jugosllavisë.

Paratë që po thoni, komandantëve, po i referohem një diskutimi në Vjenë, të bërë nga zoti ish-kryeministri yt. Ne do të organizohemi në atë mënyrë, sepse komandantët e UÇK-së dhe këta të UÇK-së do të fillojnë vrasjen e njëri-tjetrit dhe disa do t'i fusim në burg e do ta marrim ne drejtimin e pushtetit.

Në funksion të kësaj, jo, se ti nuk e di, është e vërtetë, në funksion të kësaj...

KRYETARI: Zoti Haliti, e kryet kohën tuaj, e mbajmë një debat se nuk di ku kanë shkuar, as kush i ka marrë paratë, as kah kanë shkuar. E mbajmë një debat dhe flasim nja dy ditë për këtë punë, ka nevojë. Zoti Quni e inicion, e mbajmë një debat, po pesë minuta, po më vjen keq, replika nuk ka, ta kini parasysh.

Fjalën e ka Rexhep Selimi, në emër të Grupit Lëvizja Vetëvendosje.

REXHEP SELIMI: Zonja dhe zotërinj deputetë,
Po ju drejtohem sot me shkas, nga ngjarja e aksidentit tragjik i së shtunës së kaluar, ku rezultojnë ende të zhdukur dy policë të Kosovës, Malësor Dashi dhe Armend Troni, në rrugën Kaçanik-Hani i Elezit.

Duke qenë pranë shqetësimit të familjeve, miqve dhe kolegëve, edhe ne Lëvizja Vetëvendosje shprehim shqetësimin lidhur me rastin që rezultoi të jetë tragjik për këta dy policë të Kosovës.

Po ashtu mbështesim edhe Forcën e Sigurisë së Kosovës, klubet e zhytjeve të Prishtinës, Mitrovicës dhe të qyteteve të tjera, zjarrfikësit e Kosovës, si dhe zhytës e alpinistë vullnetarë që po përpiqen ta japin kontributin e tyre në gjetjen e Armendit dhe të Malësorit.

Po ashtu ne nuk duam që për momentin të përqendrohemi rreth konspiracioneve dhe enigmave të ngritura gjithandej lidhur me aksidentin dhe zhdukjen e policëve.

Por, kërkojmë nga organet e sigurisë dhe të drejtësisë që ta kryejnë detyrën dhe punën e tyre me profesionalizëm dhe me përgjegjësi, të mos fshehin asgjë dhe të mos lënë asgjë pa u zbuluar lidhur me rrethanat e aksidentit dhe të zhdukjes së dy policëve të Kosovës.

Por, përderisa sot është dita e gjashtë që trupat ende nuk janë gjetur, me gjithë kërkimet e pareshtura, në ndërkohë po mungon një koordinim ndërmjet faktorëve që kanë gatishmëri të ndihmojnë me punë profesionale në kërkimin e trupave.

Për të pasur një efektivitet më të madh dhe një sukses në operim, nuk ka munguar gatishmëria e as rreth 50 zhytësve dhe shumë vullnetarëve të tjerë që ka Kosova, por ka munguar një koordinim i nevojshëm ndërmjet faktorëve nga Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave.

Me shkas nga kjo ngjarje kërkojmë që menjëherë të hartohet një plan, të formohet një trup koordinues i emergjencave, i cili mekanizëm do ta hartonte dhe detajonte planin e veprimit dhe koordinimit në mes të institucioneve të sigurisë dhe të emergjencave dhe me klubet e zhytjes, alpinistëve, bjeshkatarëve e vullnetarëve të tjerë, në mënyrë që të jenë të koordinuar në situata të tilla.

Për fat të keq, ka pasur edhe mund të ketë prapë raste të tjera, edhe më të rënda. Prandaj, duhet të jemi më të përgatitur për situata të tilla.

Në kuadër të një plani të veprimi në raste emergjencash, menjëherë duhet të fillojmë hartimin e një plani për një ushtrim në terren, ku institucionet e sigurisë dhe ato të vullnetarëve do të bënin stërvitje të përbashkëta periodike të përvitshme që në rast emergjencash do të ishin shumë më të koordinuar dhe më eficientë.

Përveç kësaj, shteti i Kosovës duhet të bëjë menjëherë sigurimin jetësor për policët e Kosovës dhe për gjithë zyrtarët të institucioneve të sigurisë dhe të emergjencave, të cilët e vënë jetën në rrezik në mbrojtje të ligjit, të shtetit dhe të qytetarëve të Kosovës. Është e papranueshme që policët e Kosovës ende nuk e kanë sigurimin e jetës, e po ashtu është e pandershme që neve të na kujtohet kjo vetëm kur policët vdesin apo rrezikohen në kryerjen e detyrës. Policinë e Kosovës duhet ta doni jo vetëm në menaxhimin e protestave, por edhe atëherë kur ata japin jetën e tyre, edhe kur ata gjymtohen dhe paralizohen në krye të detyrës, edhe kur ata punojnë ditë e natë me përkushtim, edhe kur ata luftojnë krimin dhe rrezikohen nga kriminelët. Policia e vërtetë e Kosovës janë si Enver Zymberi që dha jetën për Kosovën, edhe si Mazllum Bajraktari që la shëndetin në krye të detyrës dhe sot ka ngelur në karrocë.

Prandaj, shteti i Kosovës do të duhej t'i mbronte jetët dhe shëndetin e policëve nga fatkeqësitë dhe po ashtu ta mbronte integritetin e tyre nga abuzuesit dhe keqpërdoruesit, qofshin ata brenda, qofshin në krye të policisë, apo edhe jashtë saj. Që policët ta kryejnë detyrën e tyre, së pari shteti duhet ta kryejë detyrën e tij, t'ua bëjë sigurimin e jetës atyre që po na e bëjnë sigurinë publike. Faleminderit!

KRYETARI: Dardan Molliqaj e ka fjalën, në emër të Grupit Parlamentar GDP.

DARDAN MOLLIQAJ: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Kabinet qeveritar,

Të dashur qytetarë të Republikës,

Ne si deputetë të Kuvendit të Kosovës në muajt prill dhe maj kemi marrë dy shkresa nga dy kompani të rëndësishme publike në Kosovë, përkatësisht nga Posta e Kosovës dhe nga Telekomit i Kosovës.

Në këto dy shkresa që i kemi marrë flitet për gjendjen e rëndë në këto dy ndërmarrje. Sa i përket Postës së Kosovës, kemi një problem thuajse dukshëm më të vogël se sa i përket Telekomit të Kosovës. Një marrëveshje dhe në bazë të ligjit Qeveria e Kosovës, përkatësisht Ministria e Zhvillimit Ekonomik është e obliguar t'i kryejë të gjitha humbjet që ndërmarrjet publike, përkatësisht Posta e Kosovës mund t'i ketë gjatë operimit të saj. Që nga viti 2014, përkatësisht

edhe 2013, Ministria e Zhvillimit Ekonomik nuk i ka kryer obligimet, të cilat i ka konform ligjit të paraparë për mbulimin e humbjeve të ndërmarrjeve publike, përkatësisht të ndërmarrjes Posta. Si rezultat i kësaj, Posta e Kosovës rrezikon të falimentojë.

Shumë shpesh është thënë që ky rrezikim po vjen për shkak të numrit të madh të punëtorëve, ku është një element, po asnjëherë nuk është elementi kyç dhe nëse nuk ka intervenim të shpejtë të Qeverisë së Kosovës, përkatësisht të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, kemi rrezikim serioz të kësaj ndërmarrjeje.

Ndërmarrje tjetër shumë me rëndësi është Telekom i Kosovës dhe në bazë të dokumentit që na është ofruar, Telekom i Kosovës ka 60 milionë euro borxhe dhe nëse nuk ka intervenim të menjëhershëm të Qeverisë së Kosovës, rrezikon falimentimi i menjëhershëm i kësaj ndërmarrjeje. Problemin kryesor që e ka ndërmarrja Telekom, sikurse edhe Posta, është se me vendim të një Qeverie të mëhershme, përkatësisht Qeverisë Thaçi 2, janë ndaluar të gjitha investimet në infrastrukturën e Postës dhe në Telekom për shkak të fillimit të procesit të privatizimit të Telekomit dhe si rezultat i kësaj nuk ka pasur përfitime të njëjta kjo kompani siç i kishte paraprakisht.

Problemi i dytë dhe më i madhi është kontrata me Z-Mobile. Siç e dini të gjithë, kjo kontratë është kriminale, e cila është ndihmuar nga Qeveria Thaçi 2 dhe faktorë të tjerë, e cila e ka favorizuar një ndërmarrje private, siç është Z-Mobile, ku pronarë të saj janë Devollët dhe, si rezultat i kësaj marrëveshjeje të dëmshme dhe ajo që duhet thënë fitimi i saj në arbitrazh për shkak të dëshmive favorizuese nga zyrtarët e Telekomit, pra Z-Mobile e ka fituar rastin për shkak se zyrtarët e Telekomit kanë dëshmuar ose nuk kanë dëshmuar fare, duke e favorizuar vendimin në dobi të Z-Mobile. Si rezultat i kësaj kemi diku 23,4 milionë euro, të cilat kompania në fjalë ka kërkuar që brenda 15 ditësh të realizohen. Pra, brenda muajit maj Telekom i Kosovës obligohet ta realizojë pagesën e borxhit prej 23,4 milionë eurosh një kompanie, Z-Mobile.

Ndonëse është ligjore në kuptimin se si kanë marrë vendime gjykatat, dihet që kjo kontratë është krejtësisht kriminale dhe dihet që prapa kësaj kontrate dhe prapa këtij vendimi kanë qëndruar Qeveria Thaçi 2 dhe eksponentë të kësaj qeverie. Nëse s'ka veprim të menjëhershëm të Qeverisë së Republikës së Kosovës, pra kemi rrezikim serioz që Telekom i Kosovës dhe Posta të falimentojnë. Kjo Qeveri, ndonëse s'është përgjegjëse drejtpërdrejt për atë çka ka ndodhur, është përgjegjëse për t'i shpëtuar këto ndërmarrje. Nuk është e drejtë të dalë në opinion publik që këto ndërmarrje nuk po funksionojnë dhe janë të rrezikuara për shkak të numrit të madh të punëtorëve, ky është një prej problemeve, por është problemi më i vogël. Problemi më i madh është se keni dashur ta privatizoni dhe i keni ndaluar investimet dhe problemi i dytë është që keni bërë një marrëveshje kriminale, jo kjo Qeveri, po Qeveria tjetër.

Kjo Qeveri është duke i ndarë për çdo muaj nga 1 milion euro për pagesën e rrymës të konsumatorëve në veri të Kosovës. Shteti i Kosovës çdo muaj është duke i ndarë nga 1 milion euro dhe nuk ka asnjë alarm dhe asnjë përpjekje për t'i shpëtuar dy ndërmarrje, të cilat janë të rëndësishme në të gjitha fushat e jetës në Kosovë. Pres nga kryeministri, nga Qeveria e Republikës, por edhe Kuvendi të kemi një reagim të shpejtë për këto ndërmarrjeje, përndryshe do të kemi krizë të madhe...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Teuta Haxhiu, në emër të Grupit Parlamentar Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Sot kam një lajm të mirë për punëtorët e arsimit shqip të viteve të '90-ta. Të gjithë deputetët e kanë projektligjin në kutitë e tyre postare, pas një debati të organizuar në vitin 2013 dhe pas rekomandimeve të Komisionit Parlamentar të atëhershëm, i cili e obligonte Qeverinë e Republikës së Kosovës që në afat prej tre muajsh të sjellë Projektligjin për punëtorët e viteve të '90-ta në Kuvend. Megjithatë, jemi në vitin 2018 dhe kjo Qeveri e ka sjellë këtë projektligj, për çka e falënderoj Qeverinë e Republikës së Kosovës që të gjithë së bashku, sepse mbi të gjitha edhe deputetët, shumica prej tyre, por edhe qeveritarët janë ish-nxënës të këtyre punëtorëve të viteve të '90-ta.

Prandaj, Projektligji për statusin e punëtorëve të arsimit shqip të Republikë së Kosovës që nga viti shkollor 1990-1991 deri në vitin shkollor 1998-1999 trajton njohjen e validitetit të sistemit arsimor të Republikës së Kosovës që nga vitet shkollore, pra '90-'91 deri në atë '98-'99, duke përcaktuar statusin dhe njohjen e stazhit të beneficuar me përkrahje financiare përmes pensioneve dhe beneficioneve të veçanta për kategoritë që ndërtuan sistemin e pavarur të arsimit shqiptar dhe organizuan mësimin në kushte të okupimit klasik prej këtij viti, pra '90-'91 deri në vitin '98-'99. Jam shumë e bindur që të gjitha grupet parlamentare, ashtu sikurse edhe kemi debatuar që sa vjet, do të jemi të përkushtuar 100% që ky projektligj të bëhet ligj dhe të bëhet i zbatueshëm. Pra, edhe një herë i ftoj të gjithë mësimdhënësit që bashkarish, edhe institucionet arsimore, por edhe secilin mësimdhënës që të bëjë maksimumin, që të jemi të përkushtuar që arsimin, ashtu siç e mbajtëm në vitet e '90-ta, pra në këto kushte, 18 vjet pas, pra të japim maksimumin në mënyrë që cilësia e arsimit të jetë në nivelin e dëshiruar.

Unë jam shumë e sigurt që në Kosovë kemi shumë mësimdhënës që janë të përkushtuar, por i ftoj të gjithë që bashkarish të bëjmë, pra, edhe një herë më të mirën për vendin tonë, për fëmijët tanë. Faleminderit!

KRYETARI: Milaim Zeka e ka fjalën, në emër të Grupit Parlamentar Nisma.

MILAIM ZEKA: Faleminderit, kryetar!

I nderuar kryeministër,

Të nderuar qytetarë të Kosovës,

Ne vazhdimisht në këtë foltore po e theksojmë problemin e madh që është krijuar në ndërmarrjet publike dhe është më se e vërtetë që Qeveria duhet të ndërmarrë një vendim shumë të shpejtë për ta shpëtuar Valën edhe Postë Telekomin e Kosovës nga bankrotimi.

Unë sot kam dalë këtu për çështje të studentëve të Malit të Zi. Gjatë një vizite që komisioni parlamentar e ka pasur në Qeverinë e Malit të Zi dhe në shtetin e Malit të Zi, shqiptarët atje na kanë bërë një lutje që ne ta paraqesim një problem përmes Parlamentit të Kosovës, ku i bëjnë thirrje ministrit të Arsimit që të krijojë një numër të caktuar të studentëve shqiptarë të Malit të Zi, minimum 30 ose 50 studentë, në mënyrë që ata të pranohen në universitetin publik të Kosovës. Dhe, meqenëse ministri vjen kështu nga partia ime, po të bëj thirrje si deputet, edhe në emër të Grupit Parlamentar, zoti ministër, që të keni parasysh se studentët shqiptarë në Mal të Zi nuk kanë mundësi të shkollimit në gjuhën e tyre amtare dhe, në mungesë të mundësisë për studime, ata po e lëshojnë vazhdimisht vendin e tyre dhe po shpërngulen në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Kjo ishte një lutje e atyre që unë e transmetova tek ju nëpërmjet foltores së Parlamentit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Tani jemi në përfundim, i kemi edhe tre-katër minuta, Slobodan Petroviqi, pastaj kryeministri e ka kërkuar fjalën. Janë edhe shtatë-tetë vetë të tjerë, në fund të fundit, seanca vendos, ju sa të doni, si të vendosni ju, të gjithëve jua jap fjalën.

SLOBODAN PETROVIĆ: Hvala, predsedniče!

Poštovani premijeru, uvaženi predstavnici Vlade,

Poštovani dame i gospodo narodni poslanici,

Prošlo je nešto više od mesec dana kako smo u prilici da vidimo da Vlada koju vodi gospodin Ramuš Haradinaj nije u punom sastavu, naime ono što mene interesuje i pored svega jeste iz ugla Srpske zajednice. Svakako Srpska zajednica je ustavna kategorija ono što imate vi kao politički dogovor između stranaka i to nešto što je na vama svakako da i to interesuje i mene i naše građane ali pre svega u poslednjih mesec imao sam puno pitanja pre svega iz Srpske zajednice koju interesuje ko je srpski predstavnik u Vladi.

Još jednom kažem da je pravo svake političke stranke da bude u poziciji ili opoziciji i ovo se ne odnosi pitanje na konkretno, na političke stranke, nego jednostavno pitam premijera s obzirom da je i Ustav garant da Srpska zajednica ima svog predstavnika u Vladi, mene jednostavno interesuje kao sve pripadnike Srpske zajednice, koje taj predstavnik koji je ispred Srpske zajednice u Vladi Kosova. U koliko ga imamo, želimo da znamo koji je, a koliko ga nemamo, isto je i to pitanje, jer jednostavno to je obaveza i vas kao premijera i Vlade da imate

predstavnik iz Srpske zajednice. Znači, još jednom kažem, prošlo je više od mesec dana jednostavno je više nego vremena prošlo i prosto je ova pitanje za vas premijeru, a ujedno i pitanje može da bude i za vas predsedniče Skupštine, pošto ste vi šef koalicije koja je na vlasti i očekujemo da će te dati odgovor meni kao i svim građanima u toku dana, odnosno do kraja nedelje, u suprotnom da znamo kako da se ponašamo pre svega kažem, govorim ispred Srpske zajednice, to je nešto što interesuje i Srpsku zajednicu, a verujem i druge građane. Zahvaljujem se!

KRYETARI: Faleminderit! Koha e rregullt për deklarime ka përfunduar, unë i jap fjalën kryeministrit të Republikës së Kosovës, ndërkohë grupet parlamentare le ta mendojnë a dëshirojnë ta përfundojnë, janë 9 deputetë. I bie diku, po e dini sa minuta ju vetë...

KRYETARI: Kryeministër, fjala për ju!

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: I nderuar kryetar i Kuvendit, zoti Veseli,
Të nderuar deputetë,
Kolegë ministra të Kabinetit qeveritar,
Qytetarë të vendit,

I dëgjova qëndrimet e deputetëve veç e veç në bazë të grupeve parlamentare. Diskutimin e parë nuk e zura dhe s'kam ndonjë koment, ndërsa çështja e dy policëve që tanimë po konsiderohen të humbur, vërtet është shqetësim i të gjithë neve dhe e kuptojmë shqetësimin e të gjithëve. Ky shqetësim ka prekur pa dallim çdo institucion, çdo pore të shoqërisë sonë. Më së vështiri e kanë familjet, të afërmit dhe bashkëpunëtorët e tyre. E vërteta është se ka koordinim atje, ka koordinim dhe ka vullnet për ta pranuar çfarëdo përkrahje, qoftë të zhytësve, qoftë të vullnetarëve. Mirëpo, ekziston edhe një praktikë, disa duke ndenjtur në Prishtinë nëpër kateteri po u japin këshilla atyre sesi ta bëjnë punën. I kemi dëgjuar disa kësi ekspertësh. Nuk është në rregull, sepse ata që janë atje e kanë bukur vështirë. Janë në ujë e në kushte të vështira dhe është mirë që të gjithë, kush të ketë mundësi, të shkojë e t'i përkrahë, por për t'u dhënë këshilla nga Prishtina, besoni është problem të shkosh e ta shohësh gjendjen reale atje.

E di se keni qenë për ta parë, por ajo që është me rëndësi u tha me të drejtë që policët e Kosovës paskan sigurim jetësor, e ajo është temë shqetësuese, duhet ta trajtojë kjo Qeveri dhe të gjitha institucionet. Pra, nuk po thellohem më tutje, por sa i përket kësaj teme, shpresoj që do ta kemi një epilog të asaj gjendjeje. Edhe unë i bashkohem falënderimit për të gjithë që marrin pjesë në kërkimin e tyre.

Te Posta dhe Telekom, vërtet këto kompani kanë vështirësi të mëdha financiare. Edhe praktikat dikur kanë ekzistuar, si rasti i "Trepçës", për t'i dhënë infuzione prej Buxhetit, mirëpo ato janë të përkohshme dhe nuk janë fort logjike e tregut, kur Qeveria si aksionare u jep para kompanive të veta. Më mirë është për t'i aftësuar ato, të përballen po me këtë problem që e kanë, pra ta gjejnë

zgjijdhjen ata vetë dhe të aftësohen për treg, për partneritet, e ndoshta edhe për investitorë potencialë, por nëse shkojmë kah logjika për t'u dhënë infuzion, mbase ua zgjasim jetën pak, por epilogu nuk do të jetë i mirë në fund.

Dëgjova për studentët e Malit të Zi që në të kaluarën ka ekzistuar një praktikë kur institucione të caktuara relevante kanë bërë shkresa në Universitet dhe në ministri e në institucionet dhe këtu në Parlament dhe u është dhënë në disa raste një kuotë studentëve që vijnë nga jashtë Kosova, për shkak të specifikave të caktuara. Nëse do të përballeshim me një kërkesë të tillë, ne do ta shqyrtonim, pa dashur ta mohojmë të drejtën e të gjithë studentëve të tjerë, të të gjithë aplikuesve për të drejtë në studime. Pra, do ta mirëprisnim dhe do ta shqyrtonim atë nëse na vjen një kërkesë, një shkresë, apo një lëndë për këtë.

Zoti Petroviq tha se për Listën serbe, apo m'u duk, se nuk i afrohej shumë mikrofonit, por pyetja ishte nëse janë apo jo në Qeveri dhe çka po ndodh? Ata kanë marrë një qëndrim të largimit nga Qeveria. Ne kemi shprehur një mospajtim me këtë, por gjendja ka mbetur e padefinuar, të ju them të drejtën. Kjo është gjendja tash për tash.

Unë i kam edhe disa pyetje parlamentare të parapara, por mendova se po fillojmë në orën 10:00, e ne filluam pak me vonesë, në orën 11:30 më duhet të lirohem dhe do të provoj të kthehem nëse bën për pyetje parlamentare, ose t'ia delegoj ndonjë kolegut ato që janë paraparë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Deputetët që e kanë kërkuar fjalën për deklarime jashtë rendit të ditës, kalojnë në seancën e radhës.

3. Koha për pyetje parlamentare

Në bazë të nenit 45, paragrafi 1 i Rregullores së Kuvendit, koha për pyetje parlamentare zgjat 60 minuta. Për këtë seancë janë parashtruar 18 pyetje parlamentare.

Deputeti Slobodan Petroviq, pyetje për kryeministrin Ramush Haradinaj. Kjo pyetje është nga seancat e mëparshme.

SLOBODAN PETROVIĆ: Pre svega zahvaljujem se predsedniče, poštovani premijeru, uvaženi predstavnicu Vlade, narodni poslanici.

Ja sam postavio to pitanje na prošloj sednici. Ono što sam na prošloj sednici uputio kao pitanje premijeru i ministru Unutrašnjih poslova jeste za istragu o ubistvu gospodina Olivera Ivanovića. Ono što je vezano za taj događaj više nego poznato, nema potrebe da vas podsećam o čemu i na koji način se radi, s obzirom da je prošlo skoro četiri meseca i da nemamo apsolutno nikakvu informaciju vezanu za istragu. Ja bi vas zamolio i uputio sam poslaničko pitanje, mene, i ne samo pripadnike Srpske zajednice, nego i sve građane Kosova i šire, interesuje sve ono što je

vezano za istragu o ovom zločinu i kada će da se počinioci, odnosno nalogodavci izvedu pred lice pravde? Zahvaljujem se!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti kryeministër, fjala për ju!

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Faleminderit, zoti deputet Petroviq! Hvala vam!

Në pyetjen tuaj se deri ku kanë shkuar hetimet, ose çka ka ndodhur me hetimet për vrasjen e zotit Oliver Ivanoviq, ndoshta e kuptojmë edhe në bazë të ndjeshmërisë së rastit, që shumë aspekte të shumë hetimeve nuk kam të drejtë dhe nuk i posedoj, ose s'i kam mundësitë t'i sjell në Parlament, mirëpo jam i informuar prej organeve relevante që hetimet janë intensive dhe nuk është përjashtuar asnjë pistë. Janë hetimet që po ndodhin, pra me intensitetin, ose me seriozitetin e vet.

Ne e kemi shprehur gatishmërinë të kemi shkëmbim të informatave edhe me Serbinë, me autoritetet e saj, nuk ka ndodhur ndonjë përparim në këtë drejtim, mirëpo e përsëris edhe një herë - mbetemi të vendosur që e vërteta rreth këtij rasti dhe ato që Kosova mund t'i gjejë t'i nxjerrë në dritë nga pjesa e Kosovës, ose nga pala kosovare. Mund të ndodhë që zbardhja e këtij rasti është e pamundshme pa hetime intensive edhe në Serbi. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit të Kosovës, z. Xhavit Haliti.)

KRYESUESI: Faleminderit, zoti kryeministër! Pyetje shtesë, zoti Petroviq?

SLLOBODAN PETROVIĆ: Zahvaljujem se vama, premijeru!

Pre svega, ono što je za mene jako interesantno, pre svega činjenica da je upravo zbog tog događaja, tog zločina, bio doveden u pitanje i Briselski sporazum, naime ako se sećate da je bio uslov da se nastavi Briselski sporazum vezan za ovaj događaj, odnosno za pronalaženje počinioca, pa me interesuje Briselski dialog u Briselu je nastavljen, da li učesnici tog Briselskog sporazuma znaju nešto više nego mi vezano za tu istragu, ili šta je u pitanju, s obzirom da je to bio jedan od uslova da ukoliko se ne pokrene istraga ili nađe nešto što...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Zoti kryeministër, e keni fjalën.

KREMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Zoti Petroviq, faleminderit edhe një herë! Hvala vam!

Çështja e zbardhjes së rastit të zotit Ivanoviq është interes për Kosovën dhe besoj se me këtë pajtohemi të gjithë, se do të ishte dëshmi e zotësisë sonë, e aftësive tona me rend e ligj që ta nxjerrim të vërtetën dhe nuk besoj që dikush në Kosovë po mungon në punë. Ajo që s' duam ta bëjmë është që të paragjykojmë, ose të gjykojmë në publik, ose nëpërmjet medieve, për shkak se kjo vetvetiu edhe mund t'i dëmtojë edhe hetimet, ta zëmë. Ndërsa, për ne ka qenë e papranueshme që të ndodhë ndërprerja e bisedimeve atëherë.

Në fakt, atmosfera rreth bisedimeve u dëmtua edhe më shumë pas incidentit me zotin Marko Gjuriq, mirëpo Kosova mbetet e hapur për të vazhduar. Janë disa marrëveshje që janë në pritje, sidomos ajo për energjinë, që nuk po ndodh zbatimi i saj. Njëkohësisht, besoj se jeni në dijeni që Qeveria e ka ndërmarrë veprimin që edhe i takon, të paraqesë para deputetëve një platformë për bisedimet me Serbinë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Po vazhdojmë me pyetjet për kryeministrin. Zoti Driton Selmanaj, pyetje për kryeministrin Ramush Haradinaj.

DRITON SELMANAJ: Faleminderit, kryesues!

Duke aluduar në takimet sekrete ndërmjet presidentit Thaçi dhe Vuçiq më 18 mars 2018, gazeta prestigjioze vjeneze "Der Standard" ka shkruar rreth bisedimeve për ndarjen e Kosovës. Sipas kësaj të përditshmeje, gjermanët e kanë parandaluar ndarjen e Kosovës, të cilën e kanë favorizuar serbët, por edhe pala kosovare, për shkak të lodhjes me çështjen e veriut të Kosovës. Kjo, sipas diplomatëve, edhe ka bërë që të ndërhyjë Berlini. Gjithmonë sipas këtij shkrimi, thuhet se diplomatët perëndimorë kanë frikë se Thaçi dhe Vuçiq mund të flasin në kanale tjera rreth ndarjes së Kosovës.

Për t'i shtuar edhe më shumë shqetësimet për këtë çështje, më 24 mars, ju zoti kryeministër, në emisionin "Argument Plus" në RTV-21 keni thënë se që nga koha sa jeni në krye të Qeverisë nuk e keni lexuar fare marrëveshjen ndërmjet Kosovës dhe Serbisë për themelimin e Asociacionit të Komunave me shumicë serbe, ani pse çështja e asociacionit ka qenë kauza e dytë e juaja në kohën sa ishit në opozitë. Po ju citoj: "Për besë, s'jam marrë me këtë temë. Beso që hiç s'jam marrë, prej që është negociuar një herë kjo temë e që kam bërë kundërshtime opozitare. Prej vendimit pastaj të Gjykatës Kushtetuese, më kurrë s'jam marrë me këtë temë. E kam ndie në raste të caktuara, por kurrë s'e kam këqyr çka është kjo".

Pyetja, zoti kryeministër: A keni informata që presidenti i vendit, Thaçi, po negocion me presidentin e Serbisë, Aleksandar Vuçiq, për çështjen e veriut të vendit me rrezik dhe shkëmbim territoresh? A jeni në dijeni që Kuvendi me Rezolutën e miratuar 18 tetor 2012, në pikën 4 të saj, ekskluzivisht e autorizon Qeverinë e Republikës së Kosovës që ta udhëheqë procesin e bisedimeve me pjesëmarrje të komisioneve të nevojshme të Kuvendit, por jo ndonjë institucion tjetër? Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti kryeministër, e keni fjalën!

KREMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Faleminderit, zoti deputet Selmanaj!

Kemi konsultime të rregullta me presidentin Thaçi dhe jam interesuar për agjendën e dialogut, për ta kuptuar përmbajtjen dhe çdo gjë rreth kësaj teme. Unë nuk kam dijeni se ka pasur biseda për ndarje. Në fakt, më është përmendur ndarja edhe mua, edhe të tjerëve vendimmarrës, por më shumë si ide që mund të burojë nga Serbia, kështu na është thënë. Po i dëgjojmë mandej dhe çka mendoni. Qëndrimet e mia besoj se janë të qarta që është rikthim në kohërat e tragjedive të luftërave të ish-Jugosllavisë dhe këtë qëndrim nuk e kam ndryshuar. Mendoj se është qëndrimi më real i gjendjes, i përshkrimit të gjendjes.

Unë kur komunikoj në intervista nuk e kam hallin tuaj, të deputetëve, kurrë, as të intelektualëve, se ju po keni mënyrë të mbërrini te informatat. Unë vij prej katundit, jam lindur e rritur në katund, dhe kam dëshirë të më kuptoj edhe ai populli im atje, dhe ju flas me një gjuhë sa më të thjeshtë, edhe i respektoj sa më shumë, se ashtu flasin ata. Ndërsa, për ju e di që ju keni mundësi të mbërrini te të gjitha. Çka desha të them, që besoj me rëndësi po ashtu, në bisedime me Serbinë janë çështje e ndjeshme dhe kanë për të ndodhur farë teorish konspirative, luftëra speciale, kanë për t'u hapur shumë propozime, e kanë për t'u lëshuar balona. Kosova është mirë të ketë kujdes çka do të përvetësojë, e çka jo. Respekti politik, ndoshta kjo është hera e fundit që do të jemi në situatë kur do të definohet perspektiva jonë afatgjatë dhe i kisha lutur partitë politike që të mos i bëjmë gabimet e së shkuarës. Ata që përfaqësojnë, që janë në tavolinë, të mos nxitohen, kushdo qofshin. Por, edhe këta tjerët që sot s'janë në tavolinë, të mos i ikin tavolinës. Më mirë të shihet materia, se sa të merre vesh prej dikujt, si rasti ynë që po e pyesim njëri-tjetrin. Është shumë më mirë për të qenë në tavolinë kur të diskutohet materia, cilado qoftë, dhe arsyeja pse e kemi sjellë platformën në Parlament, se u diskutua si "Platforma e Haradinajt". Nuk është e imja ajo, besoni.

Më së paku unë kam punuar në atë platformë. Ajo është e Qeverisë, Qeveria është e koalicionit qeverisës po, po e gjithë popullit, se e ka votuar ky Parlament, ata që kanë votua pro.

Ndërsa nga momenti që e kemi sjellë te ju, ajo është juaja, ndërtoni një platformë sa më të qëndrueshme dhe keni parasysh krejt elementet, për shkak se nuk kemi mundësi të riparojmë, nëse është luftuar shumë për korrigjim...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Vazhdoja, ta përfundojë mendimin kryeministri.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Vetëm dy sekonda, se kur u ndodhte deputetëve, habitesha pse po lakmojnë të flasin më gjatë.

Korrigjimi i demarkacionit u tregua dhe po shihet që është sfidë, korrigjimi i Asociacionit për fat ishte i paraparë me Gjykatën Kushtetuese.

Një marrëveshje përfundimtare që mund të jetë në perspektivë Kosovë-Serbi, nuk e di a korrigjohet më, edhe nuk është mirë ta neglizhojë askush rolin e vet te përmbajtja e kësaj marrëveshjeje. Faleminderit!

KRYESUESI: Pyetje shitesë, po, regjia.

DRITON SELMANAJ: Në fakt, kryeministër, pyetja ime është edhe pak më e qartë. Mos po hiqni dorë vullnetarisht prej një mandati kushtetues që e keni?

Ne deri sot nuk kemi mandatuar asnjë institucion tjetër pos juve, po mendoj Qeverinë e Kosovës, një kohë ka qenë Isa Mustafa, kur s'e keni lënë as të flasë këtu me ve e me sprej e me gjithçka tjetër, duke e sulmuar po për këtë temë, dhe tash ju për këtë temë thoni 'unë nuk di sen', ndërkohë thoni 'le të merret presidenti, se unë sun po merrem me këtë punë'. Tash ju po thoni që ka ardhur një dokument te ju që s'është imi, po i Qeverisë. Nuk ka mandat tjetër tjetërkush të flasë në emër të Qeverisë pos juve. Unë e shoh dokument me nënshkrim të kryeministrit Haradinaj, nëse e ka sjellë dikush tjetër te ti dhe ti nuk je në dijeni, kjo është shqetësim tjetër më pas për mua. Që ty të bien dokumente njerëzit të cilët ti as vetë nuk e di çka po të bien, e më pas thoni 'po ju deputetët merreni me këtë'.

Mos po heq dorë prej mandatit kushtetues që e ke? Nuk po them nga frika, sepse nuk e besoj që ti ke frikë, po nga dilemat e tua që mund t'u dalësh në ballë temave të mëdha.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti kryeministër Haradinaj, e keni fjalën.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Edhe mua më duket ashtu, po mund të jetë e kundërta. Unë po ua jap dorën atyre që u takojnë, e që jeni ju, jua kam sjellë juve vendimin, deputetëve të vendit, jeni më shumë, është më e garantuar platforma e çdo gjë, se sa nëse është vetëm imja ose vetëm e zotit Thaçi ose të njërit prej nesh.

Po nuk e di ku është institucioni më i sigurt se sa te ju. Ju e keni platformën, ju lutem, merreni si tuajën.

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Ismajl Kurteshi, pyetje për kryeministrin Haradinaj.

ISMAJL KURTESHI: Faleminderit!
Zoti kryeministër,

Avokati i Popullit ka konstatuar se faturimi i energjisë së shpenzuar nga serbët e veriut te qytetarët e tjerë të Kosovës përbën shkelje të të drejtave të njeriut.

Avokati i Popullit ka konstatuar se me këtë veprim janë shkelur së paku katër ligje bazë, Ligji për energjinë, Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi, Ligji për mbrojtjen e konsumatorëve si dhe Ligji për marrëdhënie detyrimore. Qeveria nuk mund dhe nuk do të duhej të mbulonte këto shpenzime me të holla të taksapaguesve për pjesën tjetër të vendit dhe qytetarët e pandërgjegjshëm, mirëpo do të duhej të mbuloheshin eventualisht nga Fondi për veriun, sepse është një fond i cili mblidhet nga të hyrat doganore dhe dedikohet për zhvillimin e këtyre katër komunave.

Zoti kryeministër,

Çka po ndërmer Qeveria që serbët që jetojnë në pjesën veriore të Kosovës më në fund të fillojnë ta paguajnë vetë rrymën që po e shpenzojnë.

KRYESUESI: Zoti kryeministër, e keni fjalën.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Zoti deputet Kurteshi,

E vërtetë është se kështu ka ndodhur në të kaluarën, energjia e shpenzuar në veri ka hyrë në atë kategorinë e humbjeve të përbashkëta dhe një pjesë e saj është paguar prej investitorit, në këtë rast prej KEDS-it, po një pjesë e caktuar prej qytetarëve, qytetarëve të tjerë prej gjithë vendit.

Për fat, tanimë kjo gjendje ka ndryshuar, sepse është gjetur kjo shkelje dhe Qeveria e vendit nuk ka të drejtë më, edhe KEK-u edhe operatorët, sikurse KEDS nuk ka drejtë t'ia faturojë më qytetarit këtë. Kjo është ndërprerë, nuk i faturohet dikujt energjia e tjetrit. Ajo që i faturohet secilit prej nesh prapë janë humbjet, se humbjet e mëdha prapë po e rritin tarifën, e po na bie të paguajmë shumica prej nesh. Mirëpo, këto të veriut tani nuk janë kategori të humbjeve, pra nuk është si humbje që duhet paguar qytetarët. Kjo është e mirë, mendoj si veprim i parë.

Veprimi tjetër i ndarjes së parave nuk është veprim i pëlqyer as prej Qeverisë, as prej meje dhe nuk është veprim në alternativë që të mos merren në Fondin e veriut ose edhe nga ndonjë donator, qoftë nga Komisioni Evropian, ose nga paratë amerikane që na i kanë dhënë. Po ka qenë një veprim bukur urgjent pas devijimeve që kanë ndodhur në nivel Evrope dhe pas ndërhyrjeve që kanë ndodhur e që kanë mundur të shkaktojnë pasoja të mëdha pikërisht për interesin energjetik të Kosovës në të ardhmen.

Po nuk është një zgjidhje e përhershme, nuk është një model zgjidhjeje, ka qenë një urgjencë, e cila edhe mund të përsëritet ndoshta edhe një herë, ose ndoshta fare, po nuk është zgjidhje e përhershme, nuk guxon të jetë.

Arsyeja pse disa procese nuk janë aq të mira, edhe informatat pse nuk janë sjellë këtu, kjo ka të bëjë me disa ndjeshmëri.

Ju e dini, u krijua një devijim kohor, diku u tha për disa njësi kohore në gjithë Evropën, Normac, edhe acarimi ose nxjerrja në dritë e këtij problemi i ka pasur disa kosto, u ka kushtuar të gjithëve, na ka kushtuar edhe neve pak. Neve na ka kushtuar me këtë milionëshin që e kemi paguar. Mirëpo, presion edhe çdo gjë po shkon kah domosdoshmëria që të merremi vesh për të operuar në veri një treg energjetik normal, që produkti të paguhet.

Për këtë është gjetur një formulë që të ketë operatorë në terren, pra që i bëjnë shërbimet e pagesave, dhe Kosova ka treguar një fleksibilitet, mirëpo Serbia në këtë rast, si pjesë e marrëveshjeve të Brukselit, nuk po i zbaton. Kemi bërë ndërhyrjet te nivelet më të larta vendimmarrëse në botë për këtë temë dhe mendojmë se...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Regjia. Pyetje shtesë, zoti deputet Kurteshi?

ISMAJL KURTESHI: Po. Atë që kryeministri po e quan fleksibilitet, unë e quaj diskriminim në baza nacionale të shqiptarëve, sepse qoftë faturimi, në faturat e atyre që e paguajnë rrymën, qoftë pagesa përmes buxhetit të Kosovës është diskriminim dhe do të duhej që për këtë të vendosë Qeveria e Kosovës dhe të mos kërkojmë kurrfarë vendimi të vendimmarrësve, sepse në këtë vend kjo Qeveri është vendimmarrëse dhe askush nuk është përgjegjës përveç kësaj Qeverie për diskriminimin e qytetarëve.

Zoti kryeministër, mendoj që ju po e bëni të njëjtin gabim që e kanë bërë ata që i kanë dërguar në faturat tona borxhet e veriut dhe do të duhej që ta ndërpritni këtë menjëherë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti kryeministër!

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Qëndrimi juaj është i drejtë, zoti deputet, fuqia zbatuese e Kosovës i ka do kufizime, jo veç Qeveria, po krejt Kosova jonë, e tillë çfarë është, po do të jemi bashkë që të bëhet realitet ajo që thoni ju, se është i drejtë qëndrimi juaj, vërtet keni të drejtë.

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Adem Mikullovc, pyetje për kryeministrin Haradinaj.

ADEM MIKULLOVCI: Faleminderit, zoti kryesues!

Unë pata edhe një deklaratë jashtë rendit të ditës, po nuk ma dhatë fjalën, kështu që mbet për seancën e ardhshme.

Pyetja ime është kjo: Në vitin 1997, avokati Bajram Kelmendi ngriti aktpadi kundër Slobodan Milosheviqit dhe regjimit serb për gjenocid ndaj popullit shqiptar në Kosovë. Atë aktpadi në Gjykatën e Strasburgut, gjykatë evropiane, avokati e pagoi me kokën e vet dhe kokën e dy djemve të vet në lule të rinisë.

Pyes Ministrinë e Drejtësisë, pyes Qeverinë, a ka ndërmend dikush të ngre ndonjë aktpadi kundër Serbisë, apo jo? Ne duhet ta mbulojmë Gjykatën e Strasburgut me aktpadi të shumta, ka regjione e regjione që secila edhe veç e veç kërkon nga një aktpadi, Gjakova, Prekazi, Krusha e Madhe, Suhareka, të mos i përmend të gjitha dhe është marramendëse që asnjë ministri, asnjë ministër, as Oda e Avokatëve të Kosovës që 18 vjet nuk e ngriti asnjë aktakuzë kundër Serbisë.

KRYESUESI: Zoti Haradinaj!

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Faleminderit, i nderuar deputet Mikullovc! Pikërisht këto ditë janë edhe përvjetorët e plot masakrave në vend, para disa ditësh ishin në Meje, në Krushë më herët, kanë qenë në vazhdimësi, dje ishim në Studime, në Vushtrri dhe është një situatë, po e them ashtu, e padrejtë, për plot prej këtyre krimeve nuk ka drejtësi, nuk ka ndodhur drejtësia.

Dje në Studime u tha prej çdo folësi se nuk ka ndodhur drejtësia për këtë rast.

E gjendja është si vijon, i nderuar deputet, Republika e Kosovës nuk është palë kontraktuese me Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Strasburg dhe nuk mund të jetë si shtet palë në këtë gjykatë, pra ne si institucione, si Qeveri, e kemi të pamundur të jemi palë, po mund t'i përkrahim, t'i nxisim, t'i sponsorizojmë e t'i ndihmojmë iniciativat që vijnë nga individët, nga shoqëria civile dhe nga cilido mekanizëm që e gëzon këtë të drejtë të ngritjes së padisë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë, zoti Mikullovc.

ADEM MIKULLOVCI: Zoti kryeministër, ne nëse nuk jemi palë, Serbia është dhe gjithkush mund të padisë palën që është anëtare e saj, kjo një.

E dyta, me kalimin e viteve, mua kjo po më dhemb, po zbehen kujtimet, po zbehen dëshmitë, po harrohen sendet, çdo vonesë, çdo ditë është vonim. Kjo po më çudit, kaq.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Haradinaj, prapë.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Ke të drejtë plotësisht, do të thotë, ajo është e vërteta që po e thoni ju.

Mendoj se Qeveria e vendit mund të bëjë punë, po këtë mund ta bëjë duke i përkrahur çdo palë tjetër, vetë nuk mundet, institucionet nuk munden, po çdo palë tjetër, qoftë një familje, qoftë një i dëmtuar, një viktimë, një institucion i caktuar, një person i caktuar që ka dijeni e që vepron, mund ta përkrahim, po si institucione nuk e kishim këtë të drejtë, këtë desha t' ju them, ju lutem.

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Time Kadriaj, pyetje për kryeministrin Haradinaj.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Kryeministër, më datën 21.3.2018 është ratifikuar marrëveshja për demarkacionin, pjesë e këtij ligji është edhe raporti i Komisionit Shtetëror, të njohur si Komisioni Bulliqi. Po ashtu është edhe marrëveshja e nënshkruar në mes të dy presidentëve, me të cilën është dakorduar krijimi i dy komisioneve me qëllim të korrigjimit të gabimeve të shenjzimit të vijës kufitare.

Tash ka kaluar një muaj e sa nga ratifikimi i kësaj marrëveshjeje. Cilat janë veprimet e Qeverisë së Kosovës në këtë drejtim?

KRYESUESI: Zoti Haradinaj, e keni fjalën.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Pas ratifikimit në Parlament të ligjit, është quajtur Ligji për ratifikim të marrëveshjes, ligj në të cilin është pjesë përbërëse edhe raporti i Komisionit Shtetëror, njëkohësisht marrëveshja e presidentëve për korrigjim, kemi ndërmarrë disa veprime me rëndësi.

E para, Komisioni ynë Shtetëror ka përgatitur një bazë të koordinatave, në bazë të të cilave synohet korrigjimi. Me këtë bazë të koordinatave kemi pasur mundësinë që në nivelin politik t'i informojmë autoritetet e Malit të Zi.

Në nivelin politik është vazhduar komunikimi për domosdoshmërinë dhe për rëndësinë e korrigjimit në dy drejtimet të cekura në ligjin që e ka ratifikuar Kuvendi, pra në drejtimin e Çakorit dhe të Kullës.

Veprime të tjera që janë krijimi i trupave veç e veç dhe i punës së përbashkët duhet të pasojnë tani, por edhe Kosovës i është dashur një kohë përgatitore, për shkak se edhe kjo nuk mund të jetë edhe një herë e ridiskutueshme, pra duhet të jemi të kujdesshëm në çdo të dhënë, me çdo koordinatë, me çdo materie që përfaqësojmë për korrigjim, sepse do të jetë e fundit kjo mundësi dhe, për këtë arsye kemi bërë kujdesin e duhur.

Njëkohësisht për interes të gjithë ekspertëve e qytetarëve, do të ndodhë edhe publikimi zyrtar i të gjeturave, i të dhënave të raportit të Komisionit tonë Shtetëror, por bazuar në ato të dhëna dhe në

koordinata që veç politikisht tash e kem pasur mundësinë deri tash edhe t'i diskutojmë, pra ka filluar ideja, puna rreth korigjimit.

Në të ardhmen, grupet punuese kur ulen me siguri që do të raportojnë periodikisht për të arriturat e tyre. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë, a ke Time?

TIME KADRIJAJ: Faleminderit, kryesues!

Kryeministër, faleminderit për sqarimet, sepse është e rëndësishë së veçantë që këto t'i dinë edhe deputetët dhe qytetarët, sepse ka qenë edhe brengë e qytetarëve dhe ne kërkojmë që të intensifikohen veprimet në këtë drejtim, në mënyrë që të arrijmë deri te rezultatet dhe korigjimi i kufirit.

KRYESUESI: Faleminderit! Tani po vazhdojmë me pyetje të tjera të deputetëve.

Deputeti Zafir Berisha, pyetje për ministrin Nenad Rikallo, a do ta bësh pyetjen, ministri nuk është këtu?

ZAFIR BERISHA: Faleminderit, kryesues!

Ministrin nuk di ku mund ta gjejmë, po sido që të jetë, unë pyetjen po e bëj, është kryeministri, është një çështje që i përket Qeverisë.

Fjala është për Ligjin rreth pyjeve, për shkak se Agjencia për Menaxhimin e Pyjeve menaxhon rreth 50% të territorit të Kosovës dhe është me një ligj, i cili tash ka defekte dhe thjesht koha e ka bërë demode atë ligj.

Në anën tjetër, informatat tregojnë se nga Legjislatura IV ky ligj sillet dhe mbështillet nëpër duar të Qeverisë dhe nuk vjen në Kuvend. Jam shumë i interesuar si deputet dhe si qytetar të di arsyen pse Ligji për pyjet e Kosovës nuk po procedohet nga Qeveria dhe t'u adaptohet rrethanave të reja për të qenë më funksional dhe thjesht t'i shërbejë territorit dhe qytetarëve të Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti kryeministër, e keni fjalën.

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Do të interesohem për ligjin në fjalë dhe besoj në afatin më të shpejtë kohor do t'jua kthejmë përgjigjen. Njëkohësisht diçka që do të bëjmë kujdes është edhe Ligji për Qeverinë. Qeveria është kjo që është tani, e madhësisë që është, po do të përgatisim një ligj që kushdo që formon Qeverinë në të ardhmen, ta formojë në bazë të ligjit dhe të jetë i kornizuar, e besoj do ta keni edhe atë ligj në Parlament. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Deputeti Imet Rrahmani, pyetje për ministrin Uran Ismajli. Nuk është ministri këtu, nuk shtrohet as pyetja. Deputeti Driton Selmanaj, pyetje për ministrin Bedri Hamza.

DRITON SELMANAJ: Faleminderit!

Agjencia Kundër Korrupsionit ka filluar procedurën e hetimeve paraprake lidhur me kompensimet shtesë, të cilat janë në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë për punonjësit, shërbyes civilë ose zyrtarë të autoriteteve publike ose organizatave buxhetore të caktuara me vendim të caktuar, si kryesues, anëtarë në komisione, borde ose organe të caktuara.

Kjo temë ka nxjerrë përfundim se vendime të caktuara të marra nga ministra të caktuar, apo edhe nga vetë Qeveria nuk kanë bazë ligjore për kompensime të tilla apo për vlerën e këtyre kompensimeve.

Nuk është përcaktuar ndonjë procedurë e përzgjedhjes së punonjësve, shërbyesve civilë ose zyrtarëve të një autoriteti publik ose organizate buxhetore adekuat si kryesues në komisione, borde ose organe të caktuara.

Nuk dihet koha në të cilën këto komisione borde ose organe të caktuara kryejnë këto funksione, në kuadër të orarit të rregullt të punës apo jashtë tij.

Pyetja është: Çfarë hapash ka marrë Ministria e Financave për të zbatuar në plotëni nenin 80 të Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, i cili qartazi e rregullon këtë çështje?

KRYESUESI: Zoti ministër Hamza, e keni fjalën.

MINISTRI BEDRI HAMZA: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Të nderuar deputetë,

I nderuar deputet Selmanaj,

Lidhur me pyetjen tuaj se çfarë hapash ka ndërmarrë Ministria e Financave për të zbatuar nenin 80 të Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, ju informoj si në vijim:

Kompensimi shtesë i punonjësve, shërbyesve civilë dhe zyrtarëve të autoriteteve publike ose të organizatave buxhetore për anëtarët e trupave të përkohshme është e ndaluar me nenin 80 të Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, i cili thotë:

“Nëse një punonjës, shërbyes civil ose zyrtar i një autoriteti publik ose organizatë buxhetore, sipas një akti të Qeverisë kërkohet që të shërbejë në një komision, bord ose organ apo autoritet

tjetër publik, ky punonjës, shërbyes civil ose zyrtar nuk ka të drejtë të pranojë dhe nuk do të pranojë kurrfarë kompensimi shtesë për këtë shërbim. Shërbimi konsiderohet pjesë e detyrave të obligueshme të postit, të cilin e mban punonjësi, shërbyesi civil ose zyrtari i sipër cekur”.

Për vëmendjen tuaj, ky kufizim nuk është i vlefshëm për të gjitha rastet e kompensimit shtesë, siç është rasti kur kompensimet janë të parapara me ligjet në fuqi, meqë këto janë akte të Kuvendit të Republikës së Kosovës ose organeve të tjera jashtë Qeverisë dhe mbulon vetëm kompensimet e përcaktuara me aktet e Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Me qëllim të zbatimit të këtij neni, Ministria e Financave ka lëshuar me dhjetëra opinione ligjore për organizata buxhetore dhe sqarime të tjera lidhur me zbatimin e tij.

Po ashtu është siguruar se çdo kompensim shtesë që aprovohet nga organizata buxhetore të përmbajë dokumentacionin e plotë që përfshin, përveç tjerash, vendimin nga autoriteti komentet i organizatës buxhetore, reflektimin e saktë të shtesës me formular të përcaktuar të nënshkruar nga personat përgjegjës të organizatës buxhetore.

Legjislacioni në fuqi nuk i ka përcaktuar Ministrisë së Financave ndonjë përgjegjësi shtesë për të inspektuar apo vlerësuar ligjshmërinë e vendimeve të tilla që mund të vijnë nga organizatat buxhetore.

Sipas nenit 10 të të njëjtit ligj, zyrtari kryesor administrativ i secilës organizatë buxhetore mban përgjegjësinë kryesore për të siguruar zbatimin e përpiktë të dispozitave të këtij ligji, përfshirë edhe zbatimin e këtij neni.

Për më tepër, janë njësitë e auditimit të brendshëm, Zyra Kombëtare e Auditimit dhe, në raste të caktuara, edhe institucione të tjera që duhet të ndërmerren masa për shkelje të tilla dhe jo Ministria e Financave.

Megjithatë, me të pranuar të raportit nga Agjencia Kundër Korrupsion, të cilit i referoheni, Ministria e Financave, brenda kompetencave dhe përgjegjësi ligjore, do të trajtojë këtë çështje.

Në anën tjetër, konsiderojmë se adresimi i duhur i kësaj çështjeje duhet të bëhet edhe përmes Ligjit për pagat, që është në proces dhe përmes të cilit do të adresohet dhe do të zgjidhen raste të tilla. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë, zoti deputet?

DRITON SELMANAJ: Po, faleminderit!

Në fakt, zoti ministër, pyetje ime kishte vetëm këtë qëllim, sepse unë po e shoh që ka shumë raste ku shërbyes civilë gjatë kohës sa janë duke punuar në një institucion angazhohen deri në katër apo pesë komisione ose anëtarë bordesh dhe të ardhurat e tyre shpeshherë e kalojnë edhe dyfishin e pagës bazë që e marrin. Tash zakonisht njerëz të tillë lidhen me interesat të cilat i përfaqëson një ministër i caktuar, nëse është nga PDK-ja, njerëzit e PDK-së i kanë përfitimet e tilla, nëse është nga AAK-ja, që mund të ketë ndodhur edhe në kohën e LDK-së kur ka qeverisur LDK-ja, po krejt çka po them unë, Ministria e Financave, në këtë rast, meqenëse Ligji për menaxhimin e financave publike është ligj i veçantë për këtë tematikë, duhet të ketë udhëzime administrative që përcaktojnë qartë që asnjë person në kohën e orarit të rregullt nuk mund të ketë kompensim shtesë, po edhe nëse për ndonjë institucion të veçantë ka nevojë për kompensim shtesë, nxirrni akte, po jo në kundërshtim me ligjin aktual, për të cilën unë po e shoh që

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti ministër?

MINISTRI BEDRI HAMZA: Zoti Selmanaj,

Unë e dhashë përgjigjen edhe në paraqitjen time të parë, ligji na obligon të gjithëve, i detyrohem të gjithë.

Neni 80 i Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë është më se i qartë, domethënë përjashtohen vetëm rastet kur janë të rregulluara me ligje të tjera të veçanta, ndërsa me vendime të Qeverisë, vendime individuale të ministrave të caktuar, ligji e ndalon.

Ne kemi dhënë në raste të konsiderueshme opinionet tona ligjore dhe auditorët e brendshëm, Zyra Kombëtare e Auditimit i evidenton tërë këto si të gjetura dhe kur ka raste për të hapur edhe procedura të tjera, besoj që edhe organet e tjera do ta kryejnë punën e tyre. Mirëpo, ligji është më se i qartë, domethënë nuk lejohet kompensimi për punë shtesë brenda orarit të punës.

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Sami Kurteshi, pyetje për zëvendëskryemministren Behgjet Pacolli.

SAMI KURTESHI: Faleminderit, zoti kryesues!

Kjo është një pyetje që ka të bëjë me zëvendëskryemnistren Pacolli ose me kryemnistren Haradinaj, sepse ka të bëjë me marrëveshjet ndërkombëtare. As njëri, as tjetri s'janë këtu dhe nuk po e shoh ndonjërin nga ministrat që do të duhej të ishte kompetent për një përgjigje në lidhje me çështjen që unë do ta shtroj. Prandaj, unë po e shtyj për herën e ardhshme.

KRYESUESI: Faleminderit! Unë desha që t'i them edhe një herë Anton Qunit, le t'i informojë mediat që nuk e ke sjellë asnjë dokument që dëshmon që unë i kam marrë 8 milionë. Sepse po dezinformojnë mediat që ke argumentuar 8 milionë, unë s'i kam marrë 8 milionë, të kam thënë edhe atë ditë, edhe sot po të them, edhe ty, edhe mediave që po manipulojnë, po si koleg po të them, interpretimin qysh e keni bërë në emisione të ndryshme është tjetër, por mirë është t'u thuhet që ta ndërprejnë gënjeshtren, sepse mediat janë të interesuara të krijojnë kësi lloj skandalesh, kështu që nuk po e hapim debatin, por mirë është që t'ju thuash vetë, me sms a qysh u ke thënë të bëjnë këtë informatë, thuaju le ta zhbëjnë, ose po i nxjerr letrat edhe unë.

ANTON QUNI: Faleminderit!

Me të vërtetë nuk e kuptoj pse e shfaqni këtë nervozë!

KRYESUESI: Unë e shfaq, sepse po i shoh portalet, s'ka portal që s'thotë e dorëzoi Anton Quni një dokument që dëshmon se Xhavit Haliti i ka marrë 8 milionë marka. Tregoj që s'ke dorëzuar një dokument që unë i kam marrë 8 milionë marka, ke dorëzuar dokument, po, por jo për 8 milionë marka. Kaq!

ANTON QUNI: Në rregull, ju i keni të gjitha dëshmitë për cilën shumë bëhet fjalë. Janë një ndër dëshmitë, normalisht që nuk kam arritur t'i siguroj të gjitha, por në ato dëshmi janë vula e Ministrisë së Mbrojtjes, është numri i protokollit, janë protagonistët...

KRYESUESI: A janë tetë milionë marka, po të pyes?

ANTON QUNI: Zoti Haliti, janë më shumë se 8 milionë marka...

KRYESUESI: Të nënshkruara prej meje?

ANTON QUNI: Jo, jo, janë më shumë se tetë milionë marka që Qeveria e Republikës së Kosovës i ka ndarë për nevojat e Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, për nevojat e komandantëve të zonave që kanë parashtruar kërkesa të ndryshme, për nënzonat, për njësitë, e tjera, e tjera, që të gjitha ju çdoherë i keni mohuar. Unë këtu nuk jam në stacionin policor, që juve t'ju përgjigjem ashtu siç ju mendoni.

Ndoshta ende po mendoni që ende jemi në kohën '98- '99, kur keni marrë në pyetje njerëz të ndryshëm, i keni kërcënuar, i keni dhunuar, i keni abuzuar, por sot jemi në Parlament.

KRYESUESI: Në qoftë se del një shqiptar ose një përfaqësues i cilido komunitet në Kosovë që unë e kam marrë në pyetje, që unë e kam shantazhuar, që unë i kam thënë një fjalë të keqe, përveç në gjaknxehtësi, ndoshta me shokët e mi, më shumë, unë po them nuk kisha qëndruar këtu. Unë s'kam rrahur askënd, s'kam vrrarë askënd kështu si po thua ti, s'kam marrë në pyetje

askënd, se s'ka qenë detyra ime. Do gjëra i di ti, edhe unë s'po dua të flas, por ti sot edhe atë ditë ke gënjyer. Unë nuk kam nënshkruar dokument, sepse unë nuk kam nënshkruar në pseudonim kurrë në raportet me Qeverinë e Kosovës. Gjithçka çka kam nënshkruar dhe unë mendoj që kemi bërë mirë edhe Qeveria, edhe unë çka kam nënshkruar. E kam nënshkruar me emër dhe mbiemër timin, unë jap llogari vetëm për pjesën që e kam nënshkruar edhe në këtë botë, edhe në atë botën tjetër. Kështu që nuk e thashë për ty, e thashë, sepse mediat si duket janë të interesuara të krijojnë jo debat të brendshëm, por disa media të paguara janë të interesuara të hapin të tjera çështje. Unë jam i interesuar që ne të merremi vesh bashkë për gjithçka, edhe ata që s'kanë qenë, edhe ata që kanë qenë, kontributi është i të gjithëve, pa përjashtim. Të gjithë kemi gabime, të gjithë kemi të meta, prandaj unë mendoj që është fer të thuash këtë që unë s'kam nënshkruar 8 milionë marka. Kaq! Në qoftë se i bën, në rregull, e po e mbyllim.

Anton. nëse do, merre fjalën, po, po e mbyllim më mirë.

Jepja fjalën edhe një herë Antonit, se është interesant për mediat, jo për juve, zotërinj deputetë.

ANTON QUNI: Më vjen mirë që përfundimisht po reflektoni dhe po tregoni që keni pasur bashkëpunim, e tjera. Unë ju dorëzova disa dokumente, urdhëroni, mbetet në diskrecionin tuaj t'i publikoni nëse mendoni që është koha, bëni thirrje edhe tek autoritetet e Qeverisë që kanë menaxhuar me këto fonde, a janë në pyetje më pak apo më shumë. Ju i kërkuat disa dëshmi, unë ato dëshmi jua ofrova.

KRYESUESI: Jo, nuk i solle! Nuk ke sjellë dëshmi për tetë milionë marka, ke gënjyer atë ditë, prapë po them. Dëshmi për tetë milionë marka të firmosura nga unë s'ke sjellë. Të lutem, vazhdojmë!

Deputetja Albulena Haxhiu, pyetje për ministrin Uran Ismajli.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Unë ju ftoj që të dilni në debat televiziv dhe t'i adresoni të gjitha këto që po i diskutoni ose në prokurori ndoshta, edhe më mirë, për shkak se në secilën seancë po na maltretoni kur ne nuk po dimë shumë gjëra në këtë drejtim.

KRYESUESI: Po, ju na keni maltretuar me gaz e s'na keni lodhur fort, po lëre atë punë, fol çka ke për të folur.

ALBULENA HAXHIU: Unë po ju sugjeroj që për hir të qytetarëve të Republikës së Kosovës dhe për hir të drejtësisë, do të duhej që të shkonit ose në debate televizive, të ballafaqoheshit, ose në prokurori.

KRYESUESI: Debatin deputetët e bëjnë në Parlament, jo në televizion.

ALBULENA HAXHIU: Debati bëhet edhe në Kuvendin e Republikës së Kosovës, por ky është keqpërdorim i foltores së kryesuesit të Kuvendit.

KRYESUESI: Ne debatojmë me fjalë, jo me gaz, jo me gaz lotsjellës, jo me shishe të ujit, jo me vezë...

ALBULENA HAXHIU: Ju po e keqpërdorni për interesa tuaja foltoren e Kuvendit, me karrigen e kryesuesit apo të kryetarit të Kuvendit.

KRYESUESI: Këtu të vetmen armë, deputetët seriozë e kanë veç fjalë, jo gazin.

ALBULENA HAXHIU: Nuk e di pse po shqetësohesh, zoti Haliti. Në mungesë të argumenteve, e përmendni gazin lotsjellës, mos. Nëse keni argumente, urdhëroni, po s'po shoh, ke akuza të pabaza dhe për atë po të them ose shko në prokurori ose shko në debat me zotin Quni.

Po vazhdoj me pyetjen parlamentare, pyetja është për ministrin Pal Lekaj, por ai s'qenka këtu, megjithatë po e bëj. Janë dy pyetje, po filloj një herë me ministrin e Shëndetësisë, as ai s'qenka këtu.

Në kontratën e punës së infermierëve të QKUK-së, e nënshkruar në vitin 2012, është e cekur që gjatë ditës së premte dhe vikendeve, pra të shtunën dhe të dielën, duhet të bëhet pagesa prej 50% në orë për punë sipas Ligjit të punës, saktësisht paga shtesë. Pyetja për ministrin e Shëndetësisë është se a jeni në dijeni që kjo pagesë realizohet vetëm për mjekët dhe jo edhe për infermierët? Meqë ministri i Shëndetësisë po refuzon të jetë i pranishëm, do ta bëj sërish këtë pyetje.

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Albulena Haxhiu, pyetje për ministrin Pal Lekaj. Ministri s'qenka këtu.

ALBULENA HAXHIU: Nexhat Krasniqi deri në vitin 2008 ka qenë i punësuar në cilësinë e Drejtorit të Prokurimit në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë. Gjatë punës së tij në këtë ministri u ka dhënë tenderë kompanive të ndryshme në formë të kundërligjshme, me çka ka dëmtuar me miliona euro buxhetin e Republikës së Kosovës. Në lidhje me këto afera korruptive, Gjykata Themelore e ka dënuar me 26 muaj burgim efektiv për veprën penale keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar në bashkëkryerje. Pas apelimit në Gjykatën e Apelit, kjo gjykatë ka marrë vendim që të pandehurit t'i shqiptohet dënimi me 1 vit e gjashtë muaj burgim me kusht.

Gjatë zhvillimit të procedurës gjyqësore lidhur me këtë rast ai është emëruar si Drejtor i Prokurimit në Ministrinë e Infrastrukturës. Në këtë periudhë sekretari i Ministrisë së Infrastrukturës, Xhelal Bekteshi, e ka suspenduar të pandehurin nga pozita në mbështetje të Ligjit për shërbyesit civilë dhe i ka ndaluar që t'u afrohet zyrrave të Prokurimit Publik të kësaj ministrie. Edhe pse i dënuar me burgim, zoti Krasniqi, në kundërshtim me Ligjin për shërbyesit

civilë, më 2 mars 2018 është rikthyer sërish si drejtor i Prokurimit Publik në Ministrinë e Infrastrukturës, ani pse ka qenë i dënuar dhe është i dënuar për keqpërdorim të pozitës apo autoritetit zyrtar në bashkëkryerje.

Dhe, pyetja për ministrin Pal Lekaj është pse ka lejuar rikthimin sërish, pra në pozitën e Drejtorit të Prokurimit të Ministrisë së Infrastrukturës personin i cili është dënuar me vendim nga Gjykata Themelore dhe është vërtetuar nga Gjykata e Apelit, Gjykata Supreme, madje edhe Gjykata Kushtetuese. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Ministri s'është këtu. Deputetja Besa Baftiu, pyetje për ministrin Uran Ismajli, ministri s'është këtu.

BESA BAFTIU: Faleminderit, kryesues!

Po e shoh që ministri i Shëndetësisë nuk është këtu, mirëpo më duhet t'ju njoftoj se unë këtë pyetje e kam parashtruar edhe në mandatin e kaluar dhe nuk kam marrë përgjigje dy herë nga ish-ministri. Po shpresoj se ministri në seancën e ardhshme do të më japë përgjigjen, pyetja ka të bëjë me certifikatat mjekësore, të cilat nuk po lejohen të jepen nga institucionet publike. Prandaj, po e pres përgjigjen në seancën e ardhshme. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Mimoza Kusari-Lila, pyetje për ministrin Bajram Hasani.

MIMOZA KUSARI-LILA: Faleminderit, kryesues!

Ministri ishte këtu, por nuk është më. Pyetja është deponuar më 10 shkurt, ka të bëjë me raportimin e ministrit pranë Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Tregti dhe Industri, të datës 7 shkurt dhe në pyetjen e deputetëve, gjegjësisht në pyetjen time për procesin e përzgjedhjes së sekretarit jashtë standardit, ministri ka deklaruar se përzgjedhja ka qenë në rregull, por ndoshta kjo përzgjedhje na pengon për shkak se personi i përfolur do t'ia prishte çerdhen dikujt dhe për këtë arsye kemi edhe reagime të pabaza.

Në vazhdimin e pyetjes sime, për cilën çerdhe po flet, ministri është përgjigjur "në çerdhen tuaj, gjegjësisht në çerdhen time", faktikisht. Pyetja për ministrin është: kush janë personat e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, të cilët i identifikon ai si të "çerdhes sime" nga koha sa isha ministre? A i ka verifikuar përgatitjet profesionale, politike apo ka bërë verifikim të procesit të përzgjedhjes së tyre? Si dhe, çfarë masash ka ndërmarrë ministri për të prishur këtë "çerdhe" dhe a është i vetëdijshëm për kompetencat e tij politike në raport me stafin civil? Kjo pyetje le të mbetet në publik, njëjtë sikurse edhe një pyetje tjetër që është bërë për ministrin Lekaj, që tri seanca radhazi nuk është këtu dhe ta shohim kur do të kthehen në seancë t'u përgjigjen. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Avdullah Hoti, pyetje për ministrin Bejtush Gashi. Ministri është këtu, a është Avdullah Hoti? Deputeti Ismajl Kurteshi, pyetje për ministrin Shyqiri Bytyqi.

ISMAJL KURTESHI: Duhet të jetë ministri këtu, sepse ka të bëjë drejtpërdrejt me ministrin. Faleminderit!

Zoti ministër, bazuar në Vendimin nr. 89/01B të datës 31 gusht të vitit 2016, të nënshkruar nga ish-ministri i Arsimit, Arsim Bajrami, ka ndodhur lidhja zyrtare në mes të Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve me Kornizën Evropiane të Kualifikimeve. Ky proces është zyrtarizuar në dhjetorin e vitit 2016. Marrëveshja në fjalë e obligon Autoritetin Kombëtar të Kualifikimeve të raportojë në lidhje me progresin e arritur deri në fund të vitit 2018, kjo marrëveshje i obligon të gjitha institucionet e arsimit dhe aftësimin profesional në vend që t'i nënshtrohen procesit të vlerësimit të kualifikimeve dhe akreditimit institucional brenda tre vjetëve.

Ky vendim sipas Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve deri tani nuk është zbatuar nga shkollat profesionale dhe qendrat e kompetencës. Moszbatimi i vendimit do të thotë përjashtim i Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve nga Korniza Evropiane e Kualifikimeve. Kjo neglizhencë institucioneve të arsimit do të ketë pasoja për të rinjtë tanë që pas përfundimit të shkollimit të lartpërmendur, të dështojnë të vazhdojnë studimet kudo qoftë jashtë vendit. Zoti ministër, çka ka ndërmarrë Ministria e Arsimit, e cila e ka nënshkruar marrëveshjen, në përmbushjen e obligimeve që dalin nga kjo marrëveshje e që është interes i veçantë për të rinjtë e Kosovës?

KRYESUESI: Zoti ministër Bytyqi, e keni fjalën.

MINISTRI SHYQIRI BYTYQI: I nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra,

I nderuar deputet Kurteshi,

Së pari dua të sqaroj se Vendimi në fjalë, nr. 180/01B i datës 31 gusht 2016, i nënshkruar nga ish-ministri i Arsimit ka të bëjë me validitetin e kualifikimeve dhe akreditimit të institucionit të arsimit dhe aftësimin profesional në Kosovë brenda një periudhe trevjeçare. Ky vendim është nënshkruar katër muaj para se të përmbylej referencimi, pra në dhjetor të vitit 2016 është bërë referencimi ndërmjet Kornizës Kombëtare të Kualifikimit dhe Kornizës Evropiane të Kualifikimeve. Duke e renditur vendin tonë në listën e disa vendeve të tjera të Evropës, të cilat tashmë kanë bërë referencimin me Kornizën Evropiane të Kualifikimeve.

Përmbyllja e referencimit nuk ka qenë në konsistencë me gjendjen e arsimit dhe aftësimin profesional në Kosovë. Pra, jo të gjitha vendet e Evropës, të cilat kanë një synim drejt këtij anëtarësimi, janë anëtarë të Kornizës Evropiane të Kualifikimeve, sepse një anëtarësim i tillë

kërkon ndryshime dhe investime të mëdha. Bartësit e autoritetit të kualifikimeve kombëtare dhe të MASHT-it, të cilët kanë qenë të përfshirë në këtë proces, kanë qenë në dijeni për kërkesat dhe obligimet që dalin nga ky referencim dhe gjithashtu ka qenë në dijeni për sfidat, të cilat ekzistojnë dhe vështirësitë që lidhen me çështjen e anëtarësimit të institucioneve të arsimit dhe aftësimin profesional.

Duke qenë se kjo është një pikë e rëndësishme për arsimin dhe aftësimin profesional, është e çuditshme që nuk i është dhënë prioritet që nga momenti kur kjo marrëveshje është nënshkruar dhe deri në momentin kur flasim sot. Për çudi, si prioritet i rëndësishëm nuk është futur fare as në PSAK 2017-2021. Megjithatë, që në momentin kur ne e kemi marrë ministrinë, kemi filluar të identifikojmë problemet dhe sanimet e gjendjes në arsim në përgjithësi, e në veçanti për arsimin dhe aftësimin profesional. Është synimi im dhe i dikasterit që unë drejtoj që të marrim hapa konkretë për reformat e ndryshme që kanë nevojë në arsim, e në veçanti për arsimin dhe aftësimin profesional, për të cilin ne kemi shpallur edhe vit nacional.

Megjithatë, ne si ministri kemi marrë hapa konkretë për t'i zbatuar obligimet që dalin nga kjo marrëveshje, përkundër vështirësive që ekzistojnë në shkollat profesionale, gjegjësisht në arsimin dhe aftësimin profesional. Ne tanimë e kemi kontaktuar disa herë Këshillin drejtues të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve, kemi pas takime me këtë Këshill drejtues dhe kemi diskutuar për sfidat dhe problemet që paraqiten në raportimin në Këshillin Evropian të Kualifikimeve. Nga ky diskutim kemi rënë dakord që të kemi një takim, një tryezë të rrumbullakët me të gjitha shkollat profesionale dhe kompetencën profesionale dhe me këtë tryezë të rrumbullakët kanë dalë konkluzione konkrete, të cilat ne do të marrim hapa në mënyrë që të fillojë anëtarësimi dhe validitimi i profileve të shkollave të mesme...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Vazhdojani fjalën, sa të sqarojë ministri!

MINISTRI SHYQIRI BYTYQI: Deri në fundin e vitit 2018 ne do të presim anëtarësim dhe validitim të profileve të shkollave profesionale dhe të qendrave të kompetencës. Kështu që do të jemi të gatshëm për raportim në fund të vitit në Kornizën e Kualifikimeve Evropiane. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë, zoti Kurteshi? Po!

ISMAJL KURTESHI: Faleminderit!

Zoti ministër, ajo që duhet ta deklaroni para opinionit është se a do t'i përmbushni të gjitha obligimet që dalin nga kjo marrëveshje e nënshkruar nga ministri i kaluar i Arsimit me Kornizën Evropiane të Kualifikimeve, sepse nëse nuk përmbushen të gjitha ato që janë paraparë në

marrëveshje, Kosova prapë do të përjashtohet nga një institucion shumë i rëndësishëm i arsimit dhe natyrisht që përgjegjësia do të bie mbi ju si ministri dhe konkretisht mbi ju si ministër, që keni trashëguar çdo gjë që kanë nënshkruar ministrat paraprakë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti ministër, e keni fjalën.

MINISTRI SHYQIRI BYTYQI: Deputet i nderuar, e them që anëtarësimi është bërë pa qenë të përgatitur arsimit dhe aftësimi profesional në Kosovë, megjithatë ne jemi duke marrë masa konkrete dhe rekomandime konkrete që deri në fundin e vitit ne t'i plotësojmë këto kritere që të mos përjashtohemi nga Korniza Evropiane dhe jam i sigurt që me këtë angazhim të përgjithshëm, ne do të kemi raportim dhe nuk do të përjashtohemi nga Korniza Evropiane.

KRYESUESI: Faleminderit! Deputetja Ganimete Musliu, pyetje për ministren Albena Reshitaj.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Po e shoh që ministrja nuk është këtu, unë i kam drejtuar dy pyetje parlamentare, mirëpo është bërë njëfarë shprehie e keqe që po mungojnë ministrat dhe shumë herë pyetjet parlamentare po shterohen pa marrë ndonjë përgjigje dhe thjesht pa e marrë edhe ne, po edhe opinionin përgjigjen e duhur. Kështu që po e shtyj për javën tjetër ose në seancën e tjetër, nëse vjen.

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Baftiu, pyetje për ministrin e Shëndetësisë, Uran Ismajli.

BESA BAFTIU: Po e lë për javën tjetër, meqenëse ministri nuk është këtu.

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë, konstatoj se është shteruar pika e dytë e rendit të ditës që ka të bëjë me pyetjet parlamentare.

A ka ndonjë vërejtje për procesverbalin nga seanca e mëparshme?

Atëherë, po vazhdojmë me një pikë që na ka ngelur pa përfunduar. Në sallë janë 65 deputetë. Është kërkesë edhe e propozuesve, edhe e kryetarit të Kuvendit, që të bëhet votimi i propozim-rezolutës për personat e pagjetur, që kemi diskutuar.

Të nderuar, ju kisha lutur ju që jeni paraqitur më herët për të diskutuar në pikën - Të ndryshme, t'i tërhiqni kërkesat. I keni lënë të shtypur emrat në tabelë dhe s'po di nëse jeni paraqitur të diskutoni për këtë çështje apo për çështjet që kanë kaluar. Janë Mexhide Mjaku, Bekim Haxhiu, që i kanë akoma në tabelë. Hiqni emrat!

3. Miratimi i procesverbaleve nga seancat e mëparshme

Pas kësaj pike, zoti kryeministër Ramush Haradinaj e ka kërkuar fjalën për një çështje.

Të nderuar deputetë,

Ju njoftoj se seancat e filluara më 16, 20 dhe 27 prill 2018 akoma nuk kanë përfunduar, andaj procesverbalet nuk janë gati... Kur të përfundojnë procesverbalet i sjellim. Kështu që, në rregull është.

Zoti Haradinaj, e ke fjalën.

DAUT HARADINAJ: S'ke faj, kryeses! Ke pasur debat të nxehtë, bile ky debati juaj dhe i Antonit po tingëllon sikur ajo legjenda "Kush e solli Doruntinën". Uroj që ta gjejmë!

Më 27 dhjetor 2017, kryetari i Grupit Parlamentar të Aleancës, i mbështetur edhe nga 11 deputetë tjerë, ka marrë një nismë legislative për Projektligjin për amnistinë e veprimeve opozitare të asaj kohe. Kryesues, mos u bëj nervoz tash, e të na e përmendësh fill gazin.

Në emër të Aleancës, kërkoj mirëkuptimin e kolegëve të mi deputetë, për shkak se na duhen akoma disa konsultime dhe këtë pikë të rendit të ditës ta shtyjmë për një seancë tjetër. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Unë, gazin do t'jua përmend gjithnjë. Gjithkush e ka një argument për ta luftuar kundërshtarin, por ata që e kanë bërë, e kanë bërë.

Atëherë, e hedh në votim propozimin e zotit Haradinaj. Në qoftë se doni kryetarët e grupeve parlamentare, mund ta merrni fjalën, në qoftë se jo, e votojmë menjëherë propozimin e tij. Zoti Hoti, e dëshironi fjalën? Memli Krasniqi, e dëshiron fjalën? Atëherë, e hedh në votim propozimin e zotit Haradinaj për ta tërhequr ligjin.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Kush është për ta tërhequr ligjin? Atëherë, kërkojmë me kartelë. Edhe një herë, pra po e përsëris, sepse nuk funksionoi kjo... Në sallë janë 81 deputetë.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Me 65 vota për, 7 abstenime, 72 veta kanë votuar, miratohet propozimi i zotit Haradinaj për t'u tërhequr projektligji.

Për ta shtyrë a bëni çfarë të doni, se nuk bëhet kiameti, në daçi shtyjeni, në daçi mbajeni, se nam të madh jeni kah bëni!

4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-062 për ratifikimin e traktatit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Hungarisë për ekstradim

S'kemi kuorum të duhur për ta futur në votim.

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve

Komisioni Funkcional për Legjislacion e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij.

E ftoj ministrin e Drejtësisë, zotin Tahiri, që para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë dhe arsyetojë projektligjin.

MINISTRI ABELARD TAHIRI: I nderuar zoti kryesues,

Të nderuar deputetë,

Një kohë të gjatë kemi punuar që ta sjellim para jush për shqyrtim Projektligjin për përgjegjësi disiplinore të gjykatësve dhe prokurorëve. Ky projektligj është pjesë e pakos së projektligjeve për Gjyqësorin, pra tre nga të cilët tashmë janë miratuar në Kuvend në shqyrtim të parë.

Të gjithë e dimë se për një kohë të gjatë diskursin publik rreth drejtësisë në Republikën e Kosovës e kanë karakterizuar tema si efikasiteti apo mungesa e tij, pavarësia apo ndikimi në të, barazia para ligjit apo favorizim i caktuar. Se sa kanë qenë të drejta këto vlerësime është çështje që s'mund ta përcaktojmë, sepse ne jemi në politikë dhe përfaqësojmë këndvështrime të ndryshme. Por, megjithatë, ne bashkërisht mund dhe duhet të bëjmë të mundur që sistemi i drejtësisë në vend, Gjyqësori në veçanti, ta tejkalojë secilin prej etiketimeve që i janë veshur, pikërisht duke vendosur legjislacion që siguron pavarësinë e plotë, balancon lirinë dhe përgjegjësinë, rrit efikasitetin e punës dhe shërbimeve ndaj qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Jam shumë i lumtur që Projektligji mbi Gjyqësorin, që e kam sjellë para jush, dhe ato të cilat tashmë i kemi miratuar në lexim të parë, janë projektligje që mundësojnë pavarësinë e plotë të shtyllës së Gjyqësorit dhe Prokurorisë dhe i kanë dhënë formë tipike të një pushteti të tretë të pavarur dhe të organizuar siç duhet, siç e keni përcaktuar në rendin demokratik dhe kushtetues të vendit tonë.

Sot jam optimist se bashkërisht do ta kalojmë tutje edhe këtë projektligj, i cili Gjyqësorin dhe Prokurorinë i vendos në rrugë të shëndoshë, që krahas pavarësisë së këtij pushteti të sigurohet

përgjegjësia dhe transparenca, si dhe llogaridhënia, duke mundësuar kështu ngritjen e shtetit të së drejtës në parimin themelor të tij, ligji mbi të gjithë dhe i barabartë për të gjithë, përfshirë ata që nuk e zbatojnë.

Ky projektligj është hartuar në mbështetje të plotë të Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Prokurorial, si dhe me mbështetjen e partnerëve tanë zhvillimor, Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Zyrës së Bashkimit Evropian.

Të nderuar deputetë,

Ky projektligj është në harmoni të plotë me atë të Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit Prokurorial, të cilin tashmë e kemi miratuar në shqyrtim të parë, prandaj miratimi i tij është shprehje e përkushtimit tuaj për ta kompletuar reformën e nisur. Në fakt, ky projektligj paraqet reformë të vërtetë për sistemin e drejtësisë, i cili çështjen e llogaridhënies dhe përgjegjësisë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve e sjell në një dimension të ri, përtej kodeve të etikës. Për herë të parë, me ligj të veçantë rregullohet disiplinimi i aktorëve kyçë të Gjyqësorit dhe Prokurorisë. Ky projektligj ka për qëllim përcaktimin e shkeljeve disiplinore, procedurave për fillimin e hetimeve për dyshimet për shkelje disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve, procedurave disiplinore në Këshillin Gjyqësor dhe Këshillin Prokurorial, sanksionet disiplinore dhe mjetet juridike, që lidhen me shkelje disiplinore në Gjykatën Supreme.

Dëshiroj të sjell në vëmendjen tuaj edhe faktin se i njëjti është hartuar në konsultim të plotë me burimet e së drejtës së Bashkimit Evropian, si dhe parimet e përgjithshme të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit.

Kërkesa për një rregullim të tillë ka qenë kërkesë direkte e Bashkimit Evropian, e shprehur edhe në Raportin e Progresit 2016, edhe në këtë të fundit, që u publikua një javë më parë.

Të nderuar deputetë,

Me këtë projektligj, siç mund ta kuptoni, do të shuhet zyra aktuale e prokurorit disiplinor si organ administrativ, për të cilin ka një konsensus të përgjithshëm, se nuk e ka ushtruar plotësisht mandatin dhe nuk ka pasur efikasitet në punën e vet. Këtë e dëshmojnë edhe raportet e ndryshme vendore e ndërkombëtare.

Të nderuar deputetë,

Do ta veçoja raportin e Departamentit Amerikan të Shtetit 2017 për Republikën e Kosovës, ndërmjet të cilave thekson: “Mekanizmi për procedurën disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve ekziston, por është joefikas”, si dhe raportin e vendit të Komisionit Evropian të këtij viti, i cili thekson: “Procedurat disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve ekzistojnë, por karakterizohen nga vonesa të theksuara dhe rrjedhimisht janë joefikase”.

Kjo zyrë deri më tani ka vepruar si organ që e trajton disiplinimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, por hetimi dhe mbledhja e provave është bërë vetëm nga 4 zyrtarë administrativë, të cilët janë emëruar si inspektorë në Gjyqësor për përgjegjësi disiplinore. Prandaj, nëpërmjet këtij projektligji përgjegjësia për disiplinimin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve do të jetë në duart e këshillave përkatës, pra Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit Prokurorial.

Një gjë e tillë siguron pavarësi më të madhe, transparencë, por edhe përgjegjësi. Vetë këshillat do të jenë përgjegjës për ngritjen e kualitetit brenda sistemit gjyqësor, respektivisht prokurorial, politikat e të cilave udhëheqin. Për korrektësi, më lejoni të ju njoftoj se megjithatë parashihet që me hyrjen në fuqi të këtij projektligji askush nuk do të mbetet pa punë dhe se personeli i zyrës aktuale të Prokurorit Disiplinor do të bartet në Këshillin Gjyqësor dhe Këshillin Prokurorial të Kosovës.

Më tutje, Projektligji për përgjegjësinë disiplinore u ofron të gjitha subjekteve, personave fizikë dhe atyre juridikë, mundësinë e parashtrimit të ankesave ndaj një gjyqtari apo prokurori me pretendimin për shkeljet disiplinore.

Të nderuar deputetë,

Ju ftoj ta përkrahni këtë projektligj dhe ta përmbushim edhe një prej të gjeturave të Raportit të Progresit për Republikën e Kosovës, që u publikua një javë më parë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! E ftoj kryetaren e Komisionit Funkcional, zonjën Albulena Haxhiu, që ta paraqesë dhe arsyetojë raportin e komisionit.

ALBULENA HAXHIU: Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, duke u bazuar në nenin 56, paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 10. 4. 2018 e shqyrtoi Projektligjin nr. 06/L-057 për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Ne si Komision për Legjislacion e kemi diskutuar dhe analizuar goxha në detaje këtë projektligj dhe në fund i kemi rekomanduar seancës që të mos miratohet Projektligji nr. 06/L-057 për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Sigurisht se shumë prej vërejtjeve do t'i them në emër të grupit parlamentar, pra kur të më vijë radha, mirëpo tani vetëm dy prej shqetësimeve të anëtarëve të komisionit kanë qenë që me këtë projektligj, në sistemin e drejtësisë t'i fusë duart Ekzekutivi, në këtë rast Ministria e Drejtësisë. Për shembull, raporti i Ministrisë së Drejtësisë me ankesat në Gjykatën Supreme, pra bëhet palë në procedurat disiplinore. Po ashtu, personat fizikë apo personat juridikë ankesat që i kanë për gjyqtarët dhe prokurorët duhet t'i dërgojnë në Ministrinë e Drejtësisë. Pse është menduar kështu?

Pra, ky është një ndikim i drejtpërdrejtë në sistemin e drejtësisë dhe nuk është e vërtetë që do t'i ndihmojë sistemit të drejtësisë, përkundrazi do ta dëmtojë atë. Po ashtu, më duhet ta theksoj faktin se ministri i Drejtësisë tha se është punuar një kohë të gjatë sa i përket këtij projektligji. Kjo nuk qëndron, për faktin se ideja fillestare ka qenë që ta kemi një ligj të veçantë për Zyrën e Prokurorit Disiplinor, sepse siç e dini, Zyra e Prokurorit disiplinor tash e 16 vjet funksionon pa një ligj të veçantë. Pra, kompetencat i ka në kuadër të ligjeve të tjera, KGJK dhe atë për Këshillin Prokurorial të Kosovës. Pra, ideja ka qenë që të ketë një ligj të veçantë për Zyrën e Prokurorit Disiplinor, pastaj ka qenë ideja tjetër, është hequr dorë pa arsyetim nga kjo ide, sepse ka qenë ide më e mirë. Pastaj, qëllimi ka qenë që me të gjitha shkeljet disiplinore të merret Ministria e Drejtësisë si organ i veçantë. Kjo është kundërshtuar fuqishëm nga shoqëria civile dhe nga opozita. Pastaj, është hequr dorë nga kjo ide dhe tani po na sillni diçka tjetër, që e keni bërë njëfarë mish-mashi, që po ashtu është problem për sistemin e drejtësisë, e rrënon sistemin e drejtësisë.

Po ashtu, ministri i Drejtësisë tha që Zyra e Prokurorit Disiplinor nuk është vlerësuar as në raportet ndërkombëtare dhe vendore, por as KGJK-ja, as KPK-ja, as Akademia e Drejtësisë, tash së voni e ke pasur raportin për vendin, nuk janë vlerësuar nga raportet, qoftë vendore, por edhe ndërkombëtare, në këtë rast po flas për raportin për vendin. A do të thotë kjo se duhet shuar Këshillin Gjyqësor dhe Këshillin Prokurorial, apo do të thotë që duhet fuqizuar me mekanizma të tjerë, në këtë rast për Zyrën e Prokurorit Disiplinor me ligj të veçantë? Pra, arsytimi nuk është i qëndrueshëm, prandaj shumë çështje që janë diskutuar në projektligj i kemi adresuar. Unë besoj se do të luajnë rol edhe anëtarët e komisionit sot në këtë seancë për t'i dhënë qëndrimet e tyre në raport me këtë projektligj dhe unë i ftoj deputetët në emër të komisionit që të mos miratohet Projektligji për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Radha është e përfaqësuesve të grupeve parlamentare. Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, fjalën e ka zoti Avdullah Hoti.

AVDULLAH HOTI: I nderuar kryesues!

Në emër të Grupit Parlamentar për këtë pikë do të flasë deputeti Korab Sejdiu, por unë do ta ngre një çështje që mendoj se është urgjente dhe ju personalisht mendoj se duhet të jepni sqarime.

Në seancën e fundit dhe në këtë seancë ju e keni zhvilluar një debat me deputetin Quni. Tani në të gjitha mediet po përflitet reagimi juaj dhe fjala e deputetit Quni. Në medie gjithandej është citati juaj dhe po e lexoj këtu, thotë: "Po i referohemi diskutimit në vijim nga ish-kryeministri yt, ne do të organizohemi në atë mënyrë, sepse komandantët e UÇK-së do të fillojnë vrasjen e njëri-tjetrit dhe ne do të marrim drejtimin e pushtetit, thotë Haliti". Kështu citohet nëpër medie. Unë kërkoj që të jepni sqarim nëse e keni thënë këtë, ose ta përgënjeshtroini. Ndryshe, kjo është një akuzë shumë e rëndë dhe besoj se nuk e ka vendin as në këtë seancë dhe asnjëherë të thuhet kështu. Faleminderit!

KRYESUESI: Unë kam thënë dhe qëndroj prapa kësaj që kam thënë, por jo për Isa Mustafën, por për Bujar Bukoshin. A jeni të kënaqur? Unë kam dëshmi dhe kam argumente të mjaftueshme për këtë punë. Nuk e thashë për Isa Mustafën. Mediet e kanë interpretuar me qëllim. Po, thashë se qëllimi i dashakëqijve, atyre që nuk e duan këtë vend dhe atyre që s'e duan kurrkënd në dynja, në Kosovë, është të fusin konflikte sa më të mëdha ndërmjet vete. Në saje të kësaj kanë ndodhur probleme, por janë tejkaluar dhe mirë është bërë që janë tejkaluar. Ne duam të ecim përpara. Unë e kam thënë dhe nuk i bie pishman që e kam thënë.

Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, fjalën e ka zoti Korab Sejdiu.

KORAB SEJDIU: Të dashur qytetarë,
Kryetar dhe kolegë të nderuar,
Grupi Parlamentar më ka ngarkuar me përgjegjësinë që ta prezantoj qëndrimin e grupit tonë lidhur me Projektligjin për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Më duhet të ju them se Grupi ynë Parlamentar ka shqetësime serioze lidhur me këtë projektligj. Ky ligj, përveç problemeve të zakonshme që paraqiten pothuajse në të gjitha projektligjet që vijnë nga Qeveria, ka edhe disa probleme që i konsideron të jenë fatale për këtë ligj.

Sistemi ynë kushtetues është i dizajnuar në aso mënyre që bën ndarje të qartë ndërmjet pushteteve, në veçanti bëhet ndarje e qartë ndërmjet shtyllës së Ekzekutivit dhe asaj të Gjyqësorit, apo edhe Prokurorisë. Dhe, kjo ndarje bëhet me qëllim të parandalimit të ndërhyrjeve nga Ekzekutivi në Gjyqësor dhe të sigurimit të pavarësisë së nevojshme për Gjyqësorin, që Gjyqësori të ndajë drejtësi vetëm bazuar në ligj, e jo në bazë të ndërhyrjeve politike nga Ekzekutivi.

Gjatë diskutimeve brenda grupit janë prezantuar shqetësime serioze lidhur me përfshirjen e Ekzekutivit në këtë projektligj lidhur me procedurat për adresimin e shkeljeve eventuale disiplinore nga gjyqtarët dhe prokurorët. Deputetët tanë e kuptojnë se Gjyqësori dhe Prokuroria kanë problem serioz sa i përket mungesës së kërkimit dhe dhënies së përgjegjësisë për shkeljet etike dhe ligjore, që bëjnë pjesëtarët e këtyre institucioneve.

Fakti se Zyra e Prokurorit Disiplinor ka dështuar, ka qenë pothuajse tërësisht jofunksionale, e ka krijuar një problem që duhet ta adresojmë domosdoshmërisht, mirëpo mendimi i deputetëve tanë është se përfshirja e Ekzekutivit në procedurën e disiplinimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve nuk është zgjidhje e këtij problemi. Përkundrazi, me këtë projektligj, duke tentuar ta shuajmë një problem serioz, e krijojmë një problem shumë më të madh, ndërhyrjet politike në gjyqësor që ekzistojnë de facto tani i bëjmë dhe de jure. Pra, në këtë pikëpamje deputetët e Grupit tonë Parlamentar e konsiderojnë këtë sulm të drejtpërdrejtë në pavarësinë e garantuar me Kushtetutë për Gjyqësorin dhe Prokurorinë.

Deputetët tanë kanë drojë se kjo përfshirje e Ekzekutivit në këtë projektligj mund të jetë edhe cenim i drejtpërdrejtë i neneve 108, paragrafi 3 dhe nenit 110, paragrafi 2 të Kushtetutës, që japin kompetencë ekskluzive për disiplinim të gjyqtarëve dhe prokurorëve te Këshilli Gjyqësor dhe Këshilli Prokurorial dhe si i tillë nuk guxon të lejohet të kalojë.

Rrjedhimisht, grupi ynë parlamentar nuk pajtohet me këtë projektligj, me shpresë që çështjen e disiplinimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, si çështje tepër të rëndësishme, ta trajtojmë me seriozitetin e merituar, por gjithmonë duke pasur respektim të plotë të Kushtetutës së vendit. Faleminderit!

KRYESUESI: Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, zoti Hajdar Beqa.

HAJDAR BEQA: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Në mbledhjen e Komisionit për Legjislacion, të mbajtur më 10. 4. 2018 është shqyrtuar Projektligji nr. 06/L-057 për përgjegjësitë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Desha të bëj vetëm një sqarim, kështu u debatua shumë në Komision, kemi pasur debate ndoshta më shumë edhe politike sesa përmbajtjesore. Pesë deputetë kemi votuar pro për të proceduar dhe për të shkuar ligji për t'u votuar në seancë dhe pesë deputetë kanë qenë kundër. Do të thotë, mund ta bëj një sqarim për opinionin publik: Hajdar Beqa, Nezir Çoçaj, Bilall Sherifi, Barim Shabani dhe Shkumbim Demalijaj kanë votuar për, kurse Korab Sejdiu, Arben Gashi, Albulena Haxhiu, Sami Kurteshi dhe Igor Simiq kanë votuar kundër. Ky ishte vetëm një sqarim për opinionin publik.

Kurse e para, ky projektligj bënë pjesë në pakon e ligjeve që prekin sistemin e drejtësisë dhe të gjitha projektligjet që aktualisht i kemi në shqyrtim në komision janë pjesë e kësaj pakoje.

Ajo që është me rëndësi të theksohet është se Kuvendi më 14. 3. 2018 e ka miratuar në parim Projektligjin për Këshillin Gjyqësor, Këshillin Prokurorial dhe gjykatat, tani ne jemi në proces të amendamentimit të këtyre ligjeve dhe si Kuvend jemi pajtuar në parim për këtë formë të ndryshimit.

Ky ndryshim nuk është i ri dhe nuk ka ndodhur rastësisht për faktin se lidhur me statusin e Zyrës së Prokurorit Disiplinor është diskutuar edhe në legjislaturën e kaluar, kur me planin legjislativ të vitit 2017 të Legjislaturës V ishte paraparë ligji i veçantë për Zyrën e Prokurorit Disiplinor, mirëpo mbi bazën e analizave që ka bërë Ministria e Drejtësisë me aktorët relevantë, veçmas me

qëllim të krijimit të një sistemi efikas që e mbulon përgjegjësinë e gjyqtarëve dhe prokurorëve, e ka hartuar këtë projektligj dhe e ka sjellë në Kuvend.

Këtë e bërë në sqarimin edhe zoti Tahiri, ministër i Drejtësisë.

Pa dashur ta nënvlerësoj punën që ka bërë Zyra e Prokurorit Disiplinor për këto vitet e ekzistimit dhe funksionimit, është vlerësuar se është e nevojshme të ndryshohet procedura e ankesave dhe hetimeve disiplinore për gjyqtarët dhe prokurorët.

Pa dashur të hyj në detaje për procedurat hetimore, ajo që është risi është fakti se edhe Avokatit të Popullit i është dhënë një rol i veçantë në ankesat e parashtruara nga qytetarët dhe roli i tij në procesin e hetimeve, do të thotë për ta përcjellë si proces.

Pra, përveç hetimeve të brendshme që bëhen për sjellje të pahijshme, në këtë rast të gjyqtarëve dhe prokurorëve, personat fizikë dhe juridikë mund të ushtrojnë ankesë ndaj një gjyqtari ose prokurori edhe te ministri i Drejtësisë ose Avokati i Popullit, do të thotë u mundësohen edhe disa dyer më shumë se me ligjin aktual.

Pra, palët e pakënaqur mund të shfrytëzojnë edhe mekanizma tjerë të jashtëm për t'i hetuar këto sjellje të pahijshme të gjyqtarëve dhe prokurorëve, nëse ndodhin eventualisht.

Për vëmendjen tuaj, po jua rikujtoj rekomandimet që i ka miratuar ky Kuvend në mandatin e kaluar për këto projektligje.

1. Brenda vitit 2017 hartohen ligje të reja për Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe Këshillin Prokurorial të Kosovës për shkak të ndryshimeve të shpeshta të ligjit në fuqi, duke marrë për bazë të gjeturat nga ky raport.
2. të ketë bashkëpunim ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë, Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit Prokurorial të Kosovës gjatë hartimit të ligjeve të theksuara.
3. Të ketë harmonizim ndërmjet ligjeve, ajo që ndryshon në Ligjin për Këshillin Gjyqësor të përfshihet edhe në Ligjin për Këshillin Prokurorial kur bëhet fjalë për çështje të njëjta: rekrutimi, kompensimi, vlerësimi, parashkrimi e të tjera.
4. Të ndahet buxhet shtesë për rritjen e numrit të gjyqtarëve, prokurorëve dhe bashkëpunëtorëve profesionalë.

Këto kanë qenë rekomandimet e vitit 2017 nga legjislatura e kaluar, të cilat janë inkorporuar shumë mirë nga ministri aktual.

Konsideroj se ministri i Drejtësisë me pakon e propozuar ka zbatuar edhe rekomandime që kanë dalë nga Kuvendi në vitin 2017 dhe në kuadër të kësaj nëse nuk e miratojmë sot në parim humbim konsistencën për ta adresuar reformën e drejtësisë, për të cilën të gjithë po flasim tërë ditën që jemi për reformë të drejtësisë, por duhet edhe ta përkrahim.

Unë ju falënderoj, ndërsa konsideroj që deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës duhet ta përkrahin në këtë fazë ligjin në fjalë të propozuar nga Ministria e Drejtësisë, kurse ndërmjet dy leximeve t'i japin komentet e tyre, t'i japin propozimet nëpërmjet amendamenteve. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Kujtim Shala.)

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, fjalën e ka deputetja Albulena Haxhiu.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit, zoti kryesues!

Para se të nis me vërejtjet në emër të Grupit Parlamentar, më lejoni vetëm dy sqarime.

Komisioni për Legjislacion në kohën kur është votuar kanë qenë pesë vota për dhe pesë vota kundër dhe sipas Rregullores së Punës së Kuvendit nuk miratohet. Prandaj, rekomandimi i Komisionit është i tillë.

Po ashtu, zoti Beqa iu referua Projektligjit për Këshillin Gjyqësor dhe Këshillin Prokurorial. Tha që tashmë i kemi miratuar ato dy projektligje. Kjo është e vërtetë dhe dje ka përfunduar afati kohor për procedimin e amendamenteve nga deputetët nga këto dy projektligje.

Por, këto dy projektligje e kanë vetëm një nen, pra është neni 39, Kapitulli VI - përgjegjësia disiplinore dhe trajnimi gjyqësor. Pra, thuhet që përgjegjësia disiplinore e gjyqtarëve, si dhe e drejta në ankesë zhvillohet sipas procedurave përkatëse të përcaktuara me ligj përkatës për përgjegjësinë disiplinore dhe akteve përkatëse, të nxjerra nga këshilli.

Pra, grupet e punës së Komisionit për Legjislacion ende nuk kanë nisur me punën në këto dy projektligje dhe në qoftë se sot seanca vendos që të mos përkrahet ky projektligj, unë uroj që të jetë kështu për shkak se është i rrezikshëm, do t'i them edhe argumentet tona në raport me këtë, atëherë lehtësisht grupet e punës në Komisionin për Legjislacion do të bëjnë amendament që heq nenin 39 dhe e lë siç është aktualisht në fuqi.

E thashë edhe në emër të Grupit Parlamentar që Zyra e Prokurorit Disiplinor funksionon tani e 16 vjet dhe është e vërtetë që ka pasur jashtëzakonisht shumë probleme në funksionimin e kësaj zyre dhe ka pasur po ashtu mungesë të kapaciteteve, siç e përmendi ministri i Drejtësisë në fjalën e tij hyrëse.

Ne si grup parlamentar konsiderojmë që ka qenë e rëndësishme që Zyra e Prokurorit Disiplinor të ketë ligj të veçantë, pra të funksionojë në bazë të një ligji të veçantë, e jo në bazë të dy-tri neneve që janë në Këshillin Gjyqësor apo Këshillin Prokurorial.

Dhe, sigurisht që një ligj i veçantë do ta fuqizonte tej mase Zyrën e Prokurorit Disiplinor edhe me buxhet pastaj, ndoshta të ketë edhe pavarësi financiare, por po ashtu edhe me staf, sepse stafi me të cilin ka operuar Zyra e Prokurorit Disiplinor ka qenë jashtëzakonisht i vogël që të mund t'i mbulojë problemet apo shkeljet e gjyqtarëve dhe prokurorëve. Pra, as nuk është mbështetur me buxhet, ndonëse ka pasur shumë kërkesa, e as nuk është mbështetur me staf, ndonëse po ashtu ka pasur shumë kërkesa.

Tash së fundi, pra pikërisht sot, po e diskutojmë Projektligjin për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe për ne si grup parlamentar është i papranueshëm.

Me këtë draftligj është paraparë që kompetencat aktuale të Zyrës së Prokurorit Disiplinor të kalojnë tek autoritet kompetente dhe këshillat përkatës.

Sipas këtij draftligji është përcaktuar që personat fizikë dhe juridikë të mund ushtrojnë ankesë ndaj gjyqtarit apo prokurorit për shkelje disiplinore tek autoriteti kompetent, që në këtë rast janë Ministria e Drejtësisë dhe Avokati i Popullit, dhe ne e kundërshtojmë Ministrinë e Drejtësisë, apo përfshirjen e Ekzekutivit në këtë kompetencë.

Si autoritet kompetent është përcaktuar që të jenë: kryetari i Gjykatës Themelore për sa u përket pretendimeve për shkelje disiplinore për gjyqtarët e Gjykatës Themelore; kryetari i Gjykatës Supreme, për shkelje disiplinore të kryetarëve të gjykatave themelore; kryetarët e Gjykatës së Apelit dhe KGJK-së, sa u përket pretendimeve për shkelje disiplinore të kryetarit të Gjykatës Supreme; kryeprokurori i Shtetit sa u përket pretendimeve për shkelje disiplinore të kryeprokurorëve; kryeprokurori sa u përket pretendimeve për shkelje disiplinore dhe prokurorëve të asaj prokurorie dhe Këshilli Prokurorial sa u përket shkeljeve për kryeprokurorin e Shtetit.

Ky rregullim është i rrezikshëm dhe do ta dëmtojë edhe më shumë sistemin e drejtësisë, madje edhe do t'i shtojë raste të shkeljeve disiplinore, madje lehtësisht mund të konsiderohet edhe konflikt interesi, pra që parashtrësia për shkelje disiplinore të trajtohen nga njerëzit që i kanë mbikëqyrës, ose që punojnë çdo ditë me të.

Po e marrë një shembull që deputetët që nuk janë anëtar të Komisionit për Legjislacion ta kenë të qartë. Është e njëjta sikur unë si kryetare e Komisionit për Legjislacion të merrem me shkelje disiplinore të anëtarëve të Komisionit për Legjislacion, gjë që nuk ka logjikë. Pra, është konflikt për shkak se ne punojmë si organ dhe jemi anëtarë të një komisioni përkatës.

Pra, e përmenda se është i rrezikshëm, do ta dëmtojë jashtëzakonisht shumë sistemin e drejtësisë, por po ashtu edhe do të ndikonte negativisht në marrëdhëniet ndërmjet kryetarit të gjykatave themelore me gjyqtarët e asaj gjykate, madje do t'i shndërrojë si servilë gjyqtarët e Gjykatës Themelore karshi kryetarit të Gjykatës Themelore, vetëm me arsyetimin apo me qëllimin që të njëjtit të mos ndiqen për procedura disiplinore nga kryetari i gjykatës, apo nga të tjerët, siç i njeh projektligji.

Ky projektligj do të shndërrohet në arenë përplasjesh dhe veprimesh për inat dhe për hatër, si dhe do të abuzohet lehtësisht me këtë deri në hakmarrje, por edhe në anën tjetër deri në amnistim të njerëzve që bëjnë shkelje disiplinore.

Pra, një kryetar i gjykatës, ta zëmë, mund ta amnistojë lehtësisht një gjyqtar për shkelje disiplinore, por në anën tjetër mund ta ndëshkojë padrejtësisht vetëm pse ia ka inat dikujt, p.sh. një kolegu të tij, a po do që nëpërmjet shkeljeve disiplinore ta diskreditojë atë.

Dhe, unë kam pasur kontakte edhe me përfaqësues të sistemit të drejtësisë. Ata e kundërshtojnë dhe nuk janë të vërteta pretendimet e Ministrisë së Drejtësisë që ata e përkrahin për shkak se ka pasur në vazhdimësi vërejtje sa i përket këtij rregullimi dhe kryetarët e gjykatave nuk e pranojnë një gjë të tillë edhe për faktin se janë jashtëzakonisht të ngarkuar me punë të tjera dhe ju tash po ia adresoni edhe një punë tjetër.

Problem tjetër në këtë projektligj është përfshirja e Ministrisë së Drejtësisë, që e përmenda edhe më herët.

Unë e kam parë një tendencë të vazhdueshme që ministri i Drejtësisë në forma të ndryshme të tentojë të ndikojë drejtpërdrejt në sistemin e drejtësisë, për shembull personat fizikë dhe juridikë, ankesat për gjyqtarët dhe prokurorët duhet t'i dërgojnë në Ministrinë e Drejtësisë.

Pse ka nevojë ministri i Drejtësisë ta dijë që një qytetar apo personat juridikë, cilit prokuror apo cili gjyqtar i kanë për ankesë? Pse i intereson Ministrisë së Drejtësisë se cili është gjyqtari apo prokurori për të cilin i është bërë ankesë?

Më tej, ministri i Drejtësisë mund të ushtrojë ankesë në Gjykatën Supreme ndaj vendimit të KGJK-së dhe KPK-së. Pra, ministri i Drejtësisë po bëhet palë në procedurën disiplinore, e kjo e rëndon edhe më tej sistemin e drejtësisë për shkak se nuk guxon që Ekzekutivi të përfshihet në disiplinim të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Edhe një herë, unë e thërras Ministrinë e Drejtësisë që ta procedojë në Kuvendin e Republikës së Kosovës Projektligjin për Zyrën e Prokurorit Disiplinor, e thashë edhe më herët, fare nuk jemi të kënaqur me punën që ka bërë Zyra e Prokurorit Disiplinor, të tërhiqet nga ky projektligj, ose që

Kuvendi të mos e votojë të njëjtin për shkak se vetëm sa do ta thellojë degradimin në sistemin e drejtësisë dhe do të krijojë probleme të reja.

Ne po bëjmë eksperimente në vazhdimësi, të cilat pastaj po na kushtojnë goxha shumë.

Edhe një herë, unë u bëj ftes deputetëve të Kuvendit që të mos e përkrahin këtë projektligj për shkak se ky projektligj në formën si është hartuar nuk i kontribuon fare llogaridhënies. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Hajdar Beqa ka kërkuar të replikojë, i është referuar fjalës së tij, kështu që ka të drejtë. Urdhëro, Hajdar!

HAJDAR BEQA: Nuk kisha ndonjë replikë, por siç sqaroi zonja Haxhiu, kur kemi votuar, unë nuk thashë që nuk është ajo që e tha zonja Haxhiu. Ne kemi qenë pesë deputetë për dhe pesë kundër edhe Komisioni normalisht që kur është pesë me pesë është në favor që votës të mbetet, siç tha edhe zonja Haxhiu. Nuk pata ndonjë replikë, po pasi ma dhe fjalën, mendoj që është në interes të sistemit të drejtës dhe pakos të reformave në drejtësi që sot votohet ky projektligj.

Edhe kontributi të jepet ndërmjet dy leximeve, deputetët kanë mundësi të japin, sikur edhe palët tjera të interesuara. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Ministri e ka kërkuar fjalën, Urdhëro, zoti ministër!

MINISTRI ABELARD TAHIRI: E nderuar deputete Haxhiu, Të kisha lutur, mos abuzo në emër të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Ky ligj është bërë në bashkëpunim të ngushtë me Këshillin Gjyqësor dhe Këshillin Prokurorial të Kosovës.

Në asnjë rrethanë, një ligj i cili prek punën dhe pavarësinë e Gjyqësorit nuk e sjell në Kuvend pa qenë në bashkëpunim të ngushtë me Këshillin Gjyqësor dhe Këshillin Prokurorial. Këta janë dy këshillat me të cilët unë bashkëpunoj. Nuk merrem me gjykatën veç e veç, qoftë ajo Themeloria në Prishtinë, apo e Apelit, apo Themeloria në Mitrovicë. Unë merrem me këta dy këshilla për politika që i bëjmë për sistemin e drejtësisë në Republikën e Kosovës.

Nuk e di a e dini që kjo zyrë më herë ka qenë pjesë e Ministrisë së Drejtësisë. Është provuar edhe në atë kohë, ka qenë pothuajse jofunksionale.

Edhe tani, në mënyrën qysh është e rregulluar, është komplet jofunksionale. Pra, çështja e llogaridhënies dhe e përgjegjësisë në sistemin gjyqësor dhe prokurorial mund të them që është e degraduar dhe kjo formë, ky projektligj, jam shumë i bindur që do ta ngrejë në një nivel dhe në një dimension komplet të ri.

Sa i përket Bashkimit Evropian, ne kemi pasur ekspertë të Zyrës së BE-së në këtë projektligj, që e kemi themeluar bashkërisht me ta. Nuk është një politikë e njëjtë, të cilën e ndjekin të gjitha vendet anëtare të BE-së, secili shtet e rregullon veç e veç.

Në shumë vende prej shteteve të BE-së me demokraci të konsoliduar, kjo zyrë ekziston brenda Ministrisë së Drejtësisë, mirëpo ne mendojmë që një zyrë e tillë nuk mund të funksionojë brenda Ministrisë së Drejtësisë për shkak të demokracisë të brishtë të vendit tonë.

Dhe, e rëndësishme është që të shuhet kjo zyrë dhe përgjegjësia të dalë në nivel të dy këshillave, pastaj çështjet e ministrit të Drejtësisë apo Avokatit të Popullit janë çështje që mund t'i diskutojmë, nuk është fare problem. Mirëpo, e rëndësishme është të ngrihet në nivel të dy këshillave çështja e përgjegjësive disiplinore.

Nuk mund të marrë vendim, imagjino tash një inspektor, në kuadër të kësaj zyre dhe me tre-katër vjet përvojë pune, ndoshta edhe më pak, ata sugjerojnë suspendimin e një gjyqtari në Supreme, që i ka 25 vjet përvojë punë. Imagjino çfarë disproporcion të madh kemi të bëjmë, ai që i vlerëson shkeljet dhe punën, përvojën e një gjyqtari ta zëmë në Gjykatën Supreme. Për atë arsye po them, është e nevojshme, është imediate që kjo zyrë të shuhet dhe përgjegjësia disiplinore të kalojë në nivel të dy këshillave, Këshilli Gjyqësor dhe Këshillin Prokurorial. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Albulena Haxhiu, replikë!

ALBULENA HAXHIU: Së pari është mirë që ministri i Drejtësisë të paktën një herë të jetë i sinqertë dhe të na tregojë se kush është në fakt ideatori i kësaj nisme. Për shkak se nuk është as Këshilli Gjyqësor i Kosovës, e as Këshilli Prokurorial. Në të kundërtën, unë e ftoj Këshillin Gjyqësor dhe Këshillin Prokurorial që të marrin përsipër që të thonë që po ne jemi ideatorët që të ketë një projektligj në të cilën ka ndikim të jashtëzakonshëm Ministria e Drejtësisë, por po ashtu edhe do ta dëmtojë jashtëzakonisht shumë sistemin e drejtësisë për shkak se nuk jeni i sinqertë dhe unë nuk thashë që kam pasur kontakte me KGJK-në dhe KPK-në, unë thashë “me autoritetet kompetente sipas projektligjit të caktuar” dhe i përmenda në fjalën time hyrëse se cilat janë autoritetet kompetente dhe thashë që ata e kundërshtojnë si të tillë edhe për shkak se janë të ngarkuar jashtëzakonisht shumë me punë.

Dhe tjetra, vendet për të cilat ne pretendojmë që t'i marrim si shembull e kanë të rregulluar ndryshe këtë çështje. Por, mos harroni zoti Tahiri që Kosova ka tepër shumë probleme me sistemin e drejtësisë. Vendet demokratike të zhvilluara ku funksionon rendi dhe ligji nuk i kanë problemet që i kemi ne. Nuk mund një politikan, ta zëmë, ta zgjedhë një gjyqtar me telefon në vendet demokratike ku funksionon rendi dhe ligji, as vendet të cilat shpesh i përmendni. Pra, kjo çfarë ndodh në Kosovë nuk ndodh në asnjë vend demokratik.

Prandaj, ajo çka është e rëndësishme është që ne projektligjet që i bëjmë t'ua përshtatim rrethanave tona për shkak se mënyra siç po bëjmë ligje po e dëmton edhe më shumë edhe sistemin e drejtësisë, edhe vetë shtetin e Kosovës.

KRYESUESI: Ministri ka kërkuar kundër-replikë, e pastaj vazhdojmë me përfaqësuesit e grupeve parlamentare.

MINISTRI ABELARD TAHIRI: Puna në Ministrinë e Drejtësisë as nuk ka filluar veç me mua, as nuk do të përfundojë. Unë shumë çështje i kam gjetur duke u debatuar dhe njëra prej çështjeve që është debatuar është edhe çështja e përgjegjësisë disiplinore për gjyqtarë dhe prokurorë.

Kur jam emëruar ministër, ende s'ka marrë formë si projektligj dhe si drejtim se mënyrën që do ta ndjekim qysh do ta rregullojë këtë çështje. Dhe, bashkërisht me grupet punuese, përfshirë edhe Këshillin Gjyqësor, edhe Këshillin Prokurorial, ne kemi ardhur në përfundim që ky është versioni më i mirë që ne mund ta rregullojë çështjen dhe përgjegjësinë disiplinore për gjyqtarë dhe prokurorë.

Pra, ka qenë një debat i gjatë me të cilin kemi ardhur në këtë version që ka pajtueshmërinë e plotë të Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit Prokurorial. Unë nuk besoj që ju jeni autoritet që mund t'i detyroni të deklarohen tash nëse dalin ose nuk dalin për t'i përkrahur. Mirëpo, ato janë pjesë e grupeve punuese në të gjitha ligjet për Gjyqësorin.

Pra, edhe ky ligj e prek strukturën e Gjyqësorit, ashtu qysh e prekin edhe ato që i kemi miratua në seancën e kaluar në lexim të parë.

Pra, është tepër e rëndësishme...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Jo, s'ke të drejtë Albulenë. Fjalën e ka deputeti Frashër Krasniqi, në emër të Grupit Parlamentar të Deputetëve të Pavarur.

FRASHËR KRASNIQI: Faleminderit!

Grupi i Deputetëve të Pavarur i ka po ashtu vërejtjet e veta në lidhje me këtë ligj, mirëpo në parim do ta votojmë në mënyrë që në leximin e dytë, në shqyrtim të dytë, t'i japim pastaj të gjitha komentet dhe kontributin tonë përmbajtjesor në lidhje me këtë ligj. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit z. Xhavit Haliti.)

KRYESUESI: Faleminderit! Shkubin Demalijaj e ka fjalën.

SHKUBIN DEMALIJAJ: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Si Grup Parlamentar e mbështetim Projektligjin për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Meqenëse ligji është në procedim në lexim të parë, ne kemi pasur edhe vërejtje edhe vetë, jo vetëm opozita, që po hidhet kaq shumë lidhur me projektligjin edhe pjesën normative brenda atij. Mirëpo, kur është bashkëpunimi me Ministrinë e Drejtësisë, në këtë rast i Këshillit Prokurorial edhe Këshillit Gjyqësor, çka e cenon brenda kësaj nomenklature të këtyre neneve në këtë projektligj ligjshmërinë dhe kushtetutshmërinë e vendit?

Çka na intereson neve a ia ka inati kryetari i gjykatës një gjykatësi tjetër aty në gjykatë? Çështjet janë të rregulluar me ligj, dihet kush i emëron gjyqtarët dhe prokurorët në Kosovë.

Munden të mos na bjerë tamam diku-diku po kur pyetja te projektligjet, nuk duhet që gjithmonë ta nxjerrim atë aspektin e kundërshtimit opozitar lidhur me diçka që e rregullon çështjen e ligjshmërinë në sistemin tonë gjyqësor, edhe në këtë pako ligjore që është duke u kërkuar që të forcohet në Kosovë.

Meqenëse ligji është në lexim të parë dhe kolegët e mi nga Komisioni, pavarësisht votimit që ka ndodhur në Komision, të miratohen apo të mos miratohen rekomandimet për të ardhur në seancë, do të thotë aty kemi dalë të barabartë, mirëpo unë do t'i kisha lutur edhe kolegët nga Komisioni se ne jemi më të thirrur për ta rregulluar këtë çështje.

Gjatë leximit të dytë le t'i sjellin vërejtjet e veta dhe mundësinë për ta amendamentuar këtë projektligj sa më mirë edhe ta bëjmë ligj për të ardhmen. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zoti Sherifi.

BILALL SHERIFI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë,

Rreth këtij projektligji dhe sidomos rreth këtij neni është debatuar mjaft në Komisionin për Legjislacion dhe mendoj që aty e kemi shtrë debatit bukur shumë si përfaqësues të grupeve parlamentare dhe si deputet në kuadër të këtij komisioni.

Unë thjesht po e them edhe atë që e kam thënë atje, po e them edhe në seancë, se ka dilema rreth kësaj nëse bëhet më mirë apo bëhet më keq në rast se një përfaqësues i ministrisë do të ishte në këtë Komision, por reforma kjo është, reforma do të thotë ndryshim.

Nëse i themi reformë, nuk mund të insistojmë ta mbajmë formën siç ka qenë.

Dhe, argumenti tjetër të cilin aty e kam thënë, po e përsëris këtu se nuk ka mundësi që një person apo një individ, apo një përfaqësues i ministrisë, të debalancojë në ato përmasa sa thuhet punën e këtij Komisioni.

Argumenti tjetër që vazhdoj të mendoj se është i qëndrueshëm për ta votuar këtë projektligj, së bashku me këtë nen, ka të bëjë edhe me faktin se e tërë përgjegjësia për mosfunksionim të duhur apo për çdo keqfunksionim të sistemit të drejtësisë i hidhet politikës, përfaqësuesve politikë, duke filluar nga deputetët, ministrat, kryeministri, ndërsa asnjë instrument nuk e ka në dorë, përmes të cilit do të mund të mbahej nesër përgjegjës për mbarëvajtjen, për përmirësimin e cilësisë dhe për ngritjen e performancës së sistemit të drejtësisë në përgjegjësi.

Duke pasur parasysh se deri më tani politika në përgjithësi përmes ligjeve në fuqi ka qenë totalisht jashtë çdo ndikimi në sistemin e drejtësisë, unë në emër të Nismës kam mbështetur këtë ide që në këtë nivel të ketë të drejtë ministria të jetë e pranishme në mbikëqyrjen e punës, performancës dhe procesit të disiplinës, jodetyrimisht kjo të përkthehet në disiplinim të individëve, qoftë gjykatës, qoftë prokurorë. Pra, duke pasur parasysh se e tërë përgjegjësia hidhet mbi politikën, ndërsa asnjë instrument nuk i lihet në dorë, ne kemi parë të arsyeshme që në këtë fazë, në fund të fundit, këto janë reforma, shihet një periudhë dyvjeçare, trevjeçare, katërvjeçare, ku ta di unë, nëse ajo nuk jep rezultatet e pritura, atëherë ne jemi këtu, nuk është një ligj që kërkon 80 vota dhe do të ishte i pandryshueshëm, siç është Kushtetuta, ta zëmë. Është një ligj, i cili ndryshohet me procedura të zakonshme në Parlament të Kosovës, që do të thotë nga 61 të pranishëm, mjafton të votojnë 31 për.

Le të mbështesim këtë frymë të reformave, të cilat kjo Qeveri po i ndërmerret dhe në kuadër të kësaj, edhe këtë amendament Nisma Social Demokrate, deputetët e saj, do të votojnë për edhe në lexim të parë, edhe në lexim të dytë, duke u bazuar në të gjitha këto argumente që i thashë. Reforma nënkupton ndryshim dhe ndryshimi jodetyrimisht mund të jetë i mirë, le ta shohim, le të provojmë. Por, ajo që e kemi pasur deri tani, e dimë cilat kanë qenë rezultatet. Duke bërë reformë në një çështje ne gjithmonë kemi për qëllim ta bëjmë më mirë dhe nëse nuk bëhet më mirë, jemi këtu, e ndryshojmë ose e bëjmë pak më ndryshe, ose e kthejmë në gjendjen siç ka qenë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka Bahrim Shabani.

BAHRIM ŠABANI: Zahvaljujem se predsedavajući!

I Parlamentarna grupa "6+" razmatrala je nacrt zakona o disciplinskoj odgovornosti sudija i tužioca, i mi čemu kao grupa podržati u načelo ovaj nacrt zakona i naravno da čemo svoj doprinos dati između dva čitanja ovog nacrt zakona. Zahvaljujem se!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Kurteshi e ka fjalën!

SAMI KURTESHI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuara kolege,

Të nderuar kolegë deputetë,

Ne sot po diskutojmë për një projektligj që ka ardhur këtu në shqyrtim të parë, i dëgjuam edhe qëndrimet e grupeve parlamentare, të gjithë. E dëgjuam edhe ekspozenë e ministrit dhe unë mendoj që kjo është një detyrë shumë e mirë, mirëpo u dëgjuan edhe votimet në komision dhe diskutimet që kanë ngjarë.

Unë megjithatë, pa marrë parasysh se do të replikojnë edhe ministri, edhe kolegët, unë po i përmend disa çështje. Një çështje që ishte shumë e rëndësishme, po reagojnë tash, po i dëgjoj edhe të tjerët, por s'ka lidhje. Ministri i Drejtësisë e pranoi vetë, domethënë e tha edhe kjo është e drejtë çka e tha, është degraduar çështja e përgjegjësisë disiplinore edhe e drejtësisë, në përgjithësi. Pajtohem plotësisht, vetëm duhet të tregohet, pse edhe nga kush? Ky është problemi, nuk janë të gjithë përgjegjës për këtë ngjarje.

Çështja e dytë që e thotë ministri se është punuar me ekspertët ndërkombëtarë edhe nga BE-ja, pastaj thotë se ligji është në përputhje me normat e BE-së dhe është rregulluar në bazë të atyre normave. Unë po them jo, megjithatë. Unë tash e marr këtu, para vetes e kam deklaratën e përputhshmërisë me normat e BE-së, edhe kështu thuhet: “Përputhshmëria e legjislacionit me ‘acquis communautaire’ të BE-së nuk zbatohet, lista e burimeve primare të së drejtës së BE-së nuk zbatohet, lista e burimeve sekondare nuk zbatohet, lista e burimeve të tjera, nuk zbatohet, arsyet në përputhje të pjesshme apo mospërputhje nuk zbatohet”. Në bazë të cilave norma të BE-së është bërë kjo?

Cili ekspert i BE-së, le ta thotë me emër, i drejtësisë, guxon të vijë në Kosovë dhe të thotë unë pajtohem me parimet themelore të këtij projektligji. Unë po them nuk guxon asnjë. Tash po e them, nuk guxon asnjë, sepse ky ligj, në të vërtetë, prek thelbin, themelin e filozofisë së ndarjes së pushteteve, që në të vërtetë na kanë lindur në Evropë, prej Monteskie e këndeje dhe po ardhka një ekspert evropian që po e dërguakan shtetet e Evropës Perëndimore dhe na thotë neve ‘ju mund ta bëni një ligj të tillë’. Nuk guxon. Le ta thotë me emër, ne jemi në gjendje për të diskutuar sa të duam me të, por nuk guxon ta pranojë një parim të tillë. Natyrisht, kjo është një reformë, dhe reforma në drejtësi ka nevojë, Kosova kurrë s'ka pasur nevojë më shumë, por ky projektligj, besoni, është reformë në drejtimin negativ, në drejtimin e kundërt nga ajo që e synojmë ne. Ne kemi bërë një kompleksitet shoqëror dhe institucional, edhe askush askujt të mos i besojë, prandaj ka ardhur çështja këtu.

Unë ligjin, përkundër disa kolegëve, jam përpjekur ta studioj shumë mirë dhe prej qëllimit e në përkufizime, e në pjesë të tjera konceptuale ka mangësi dhe ka gjëra që nuk janë të sakta dhe nuk janë punuar ashtu si duhet. Kemi nenet 2, 3, 5 pikat 1.2, 2.1, 2.6, 2.7, 2.12, krejt këto janë me mangësi parimore, me mangësi konceptuale që nuk përkojnë me një ligj të tillë dhe e bëjnë ligjin

me dy kuptime ose e lënë, domethënë ikin nga përgjegjësia. Një çështje që është për t'u shqetësuar, për shembull, në krejt ligjin dhe në ligjet e tjera që kanë të bëjnë me reformën e drejtësisë bëhet një koncentrim i tillë në nëntekst i fokusimit dhe i bartjes së kompetencave te kryeprokurori. Thotë “do të merret prokurori në përgjegjësi nëse nuk punon sipas rekomandimeve apo urdhrave të kryeprokurorit”, këtë s'e kemi askund. Kjo është e rregulluar me ligj, pse të futet me një ligj të tillë, çka ka të bëjë këtu kryeprokurori, kur kryeprokurori mund të jetë pjesë e përgjegjësive disiplinore. Këtu është problemi që e kemi nxjerrë.

Këtu kemi, për shembull, çështje konceptuale, thotë “parimi i proporcionalitetit”, cilit proporcionalitet? Në të gjitha ligjet e tjera, kur kemi të bëjmë me parimin e proporcionalitetit dhe zbatimin e tij në raport gjyqësor-shtet me personat fizikë që shkojnë aty, nuk përmendet, merrini vendimet e gjykatave të Republikës së Kosovës, askund nuk punohen në përputhje me parimin e proporcionalitetit. Po, kur është te përgjegjësia e gjyqtarëve, ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve e thotë këtu vjen në pyetje parimi i proporcionalitetit. Këtë nuk duan ta kuptojnë, e lëshojnë kështu hajt se po shkon, e rregullojmë në leximin e dytë. Në leximin e dytë nuk rregullohet kjo, ne kemi mundësi në leximin e parë ta kthejmë këtë ligj.

Kemi çështjen tjetër, domethënë, të përzierjes së Ministrisë së Drejtësisë. Vërtet është kjo përzierje e kompetencave të pushtetit. Ndarja e pushteteve është e rregulluar me Kushtetutë, nuk ka ekspert ndërkombëtar që mund të vijë dhe të thotë “po, kjo është e lejueshme në një vend demokratik”. Le të vijnë ta sqarojnë, ne jemi këtu, pse jo, marrim pjesë edhe në diskutime, por nuk ka ekspert të tillë që guxon të bëjë përzierje të tillë të pushteteve, këtë po e them hapur. Unë kam jetuar 15 vjet, merrem me këtë fushë dhe e di çka guxojnë ata dhe çka s'guxojnë zyrtarisht të thonë.

Është çështja tjetër, dalëngadalë po vij edhe te fundi. Ne kemi pasur një organ të vetëm që është marrë me çështjen e disiplinës së gjyqtarëve dhe prokurorëve, ajo ka qenë Zyra e Prokurorit Disiplinor. Kjo përputhet plotësisht me thënien e ministrit, thotë: “Çështja e përgjegjësive disiplinore është degraduar, ka dështuar”, kjo është e vërtetë, këtu pajtohemi. Mirëpo, pse nuk po pyetet pse ka dështuar Zyra e Prokurorit Disiplinor? Kjo është çështja thelbësore, ajo ka dështuar pikërisht për shkak të përzierjes së politikës dhe ngufatjes së kësaj zyre nga vetë politika që 18 vjet, që 15 apo 16 vjet. Kjo zyrë nuk ka pas as mjete të mjaftueshme, as kuadër të mjaftueshëm, as zyrë të veçantë, e kanë detyruar të qëndrojnë në zyrat ku janë personat, ndaj të cilëve duhet të bëhen veprime të marrjes në përgjegjësi disiplinore. Natyrisht, kolegët e kanë parë, shantazhi, kërcënimet, ndikimet, kanë qenë të jashtëzakonshme. Po të bisedoni me ish-udhëheqësin e kësaj zyre, vetë do t'ju tregojë çfarë shantazhesh ka pasur nga politika, nga kolegët e vet. Ne jemi njerëz dhe krejt kemi raporte njerëzore, merreni një herë, pyeteni pse ka dështuar ajo? Kjo është çështja.

Ndarja e kësaj zyre, largimi, fshirja e kësaj zyre, në të vërtetë është kthimi kryesor mbrapa në reformën e drejtësisë. Natyrisht që ne kemi një problem të madh me sigurimin e organeve për përgjegjësinë disiplinore të prokurorëve dhe gjyqtarëve, por këtë e kemi, sepse sistemi i drejtësisë është degraduar, edhe kur sot nuk mund ta ndërtojmë një organ, të cilit i besohet. Po këtu ka dorë politika dhe me këtë ligj politika në të vërtetë futet shumë më thellë se sa që është menduar në sistemin e drejtësisë. Edhe krejt është e thjeshtë, nëse politika, ekzekutivi, por edhe Parlamenti e kanë në dorë sistemin e drejtësisë, duke i ndarë mjete aq sa duan dhe qysh duan, natyrisht që e shantazhojnë duke ia zgjedhur personat në vendet udhëheqëse, natyrisht që e kanë në dorë. Kjo është ndryshim i një sistemi të tërë, nuk ka të bëjë me këtë ligj. Ky është një ligj që është kthim prapa, ky është një degradim i vetë kërkesës për një dukuri që në të vërtetë te ne ka degraduar shumë, e ajo është përgjegjësia disiplinore.

Me këtë ligj do të bëhet një kthim mbrapa, prandaj unë edhe një herë u bëj apel të gjithëve që të mos votohet tutje ky projektligj, të bëhet përpjekje të kërkohet nga Ministria e Drejtësisë që të përpunohet, të bëhet një organ, të forcohet organi i Zyrës së Prokurorit Disiplinor dhe që ai të jetë organ që i merr këto vendime. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Osmani e ka fjalën.

VJOSA OSMANI: Faleminderit, zoti kryesues!

Unë, në fakt, kisha një pyetje për ministrin e Drejtësisë, për të sqaruar më tej çështjen që po diskutohet këtu nga grupet parlamentare dhe po kundërshtohet nga disa. Siç e dini, Kuvendi i Kosovës e ka ndërtuar një praktikë të mirë, sidomos nga viti 2010 e këndej që të marrë parasysh mendimet e Komisionit të Venecias lidhur me pavarësinë e gjyqësorit, dhe këto i kemi marrë parasysh sidomos në aspektet e rolit të Ministrisë së Drejtësisë, madje kemi shkuar deri në atë shkallë sa që e kemi ndryshuar Kushtetutën me propozimin e ish-ministrit të Drejtësisë, zoti Kuçi, por në atë kohë me përkrahjen e të gjithëve, pushtet e opozitë, që të hiqet roli i Ministrisë së Drejtësisë në emërimin e anëtarëve të Këshillit Gjyqësor.

Kemi bërë edhe ndryshime të shumta në ligje, të cilat në tërësi eliminojnë rolin e ministrisë, për t'u siguruar që nuk ka ndërhyrje të Qeverisë në punën e gjyqësorit. Tani nga mendimet e Komisionit të Venecias që i kam këtu para vetes dhe ai më i rëndësishmi, i cili i përfshin shumicën e çështjeve, përfshirë edhe çështjen e disiplinës, thuhet ndër të tjera që “çështja e disiplinës duhet të rregullohet nëpërmjet intervenimeve të organeve të pavarura”. Tash, Qeveria, siç e dini, në asnjë definim nuk bie tek ‘organet e pavarura’.

Pra, pyetja ime është pse keni vendosur që të shkoni tash me një pozicion ndryshe nga ai që e kemi ndërtuar si praktikë në këto 7-8 vjetët e fundit dhe deri në çfarë mase i keni marrë parasysh opinionet e Komisionit të Venecias. Kjo ka rëndësi edhe në një aspekt tjetër, meqenëse Kosova po përgatitet të aplikojë në Këshillin e Evropës së shpejti, një nga zëvendëskryeministrat e

Qeverisë suaj ka deklaruar në Komisionin për Punë të Jashtme që kur të vlerësohen kriteret, një nga çështjet që do të vlerësohet dhe për të cilën vazhdimisht Kosova po merr kritika është fakti që nuk po e shfrytëzon Komisionin e Venecias, ku jemi anëtarë, sa duhet, nuk po kërkohen opinione, por edhe ato që tashmë janë, që janë ndërtuar për t'i ndihmuar shtetet anëtare, në qoftë se dhe ato sot i shkelim, mendoj se do të jepet një argument për shtetet që mund ta kundërshtojnë anëtarësimin e Kosovës në Këshillin e Evropës.

Pavarësia e gjyqësorit do të jetë një prej çështjeve që me shumë ngulm do të vlerësohet nga ana e delegacioneve që caktohen nga ana e Asamblesë Parlamentare, në qoftë se avancojmë në fazat e anëtarësimit. Prandaj, duke miratuar nenet që po diskutohet këtu, mendoj që mund të ndikojmë negativisht jo vetëm në aspektin e pavarësisë së gjyqësorit, por edhe në një proces komplet tjetër paralel, ku ky ligj mund të jetë ndër ato që po vlerësohen. Pra, në qoftë se i keni shikuar opinionet e Komisionit të Venecias, ndoshta mund të na tregoni se cilat janë ato që ju kanë ndihmuar juve të vini deri te ky konkluzion dhe jo te praktikat që deri tani i kemi ndjekur që të eliminohet roli i Ministrisë së Drejtësisë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Milaim Zeka e ka fjalën, i fundit.

MILAIM ZEKA: Edhe unë vetëm një pyetje e kam për ministrin. E kam një shqetësim si deputet, e mos edhe këta ndërkombëtarët që na ndihmojnë në përpilimin e ligjeve, unë po e shoh dhe jo që po e shoh, por po e ndjej edhe jam shumë i bindur që Prokuroria Speciale e Kosovës për momentin, për t'i kënaqur orekset e disa burokratëve të Brukselit janë duke shkuar me norma, në kohën e Titos ka qenë njëfarë norme sa tulla i qet mbi mur, të të rritet rroga.

Këta janë duke shkuar me normë, sa peshq të mëdhenj të njollosen dhe të ngrihen aktakuza, qoftë ndaj personaliteteve të ndryshme, qoftë ndaj deputetëve. Kemi plot deputetë që lidhje e pa lidhje akuzohen, prandaj kjo infrastrukturë ligjore a krijon një hapësirë që në të ardhmen prokurorët, të cilët dështojnë në tri raste, për shembull, në qoftë se një prokuror dështon në tri raste, këtu po dështojnë vazhdimisht, prokuror në Perëndim s'mund të punosh kur ti rastet i humb një pas një.

E ne këtu i kritikojmë gjykatësit, pse gjykatësi i kthen rastet e prokurorëve, që në të shumtën e rasteve ngrenë aktakuza ose hapin hetime për shkak se një portal shkruan çka t'i teket atje dhe nuk mund të jetë bazë për nisjen e hetimeve shkrimi në një portal. Kisha pasur dëshirë pak të na hiqet kjo frikë se mbaruam. Ne po e ndryshojmë ligjin, por qysh t'u operohet këtyre prokurorëve truri, po të mund t'u riprogramohet pak, se gjysmën i ke të kohës së ish-komunizmit, këta juristët e rinj s'dinë pas lufte, edhe ne pak si shpejt i kemi kryer, kemi problem me ndërtimin e infrastrukturës njerëzore, në qoftë se pajtohet ministri.

KRYESUESI: Faleminderit! Bilall, a po e do fjalën? Bilall Sherifi, e keni fjalën!

BILALL SHERIFI: Faleminderit, kryesues!

Tash në cilësinë e deputetit po e marr fjalën, jo të kryetarit të grupit. Desha ta ndaj me publikun një informatë shumë interesante. Ishim në Kroaci në kuadër të një vizite të Prokurorisë Speciale të Kroacisë dhe, nuk do ta zgjas shumë, do ta tregoj vetëm përgjigjen e një pyetjeje që e shtrova, më kujtohet unë. Kanë shtruar edhe disa nga kolegët e tjerë pyetje, unë po e tregoj pyetjen time, thashë: Sa për qind të rasteve Prokuroria Speciale në Zagreb i ka fituar dhe sa për qind i ka humbur?

Dhe, përgjigjja ishte shumë interesante, tha: “Zakonisht, në 97% të rasteve, të cilat policia i fillon hetimet, përfundojnë me aktakuza, por nuk hapim hetime pa bazë të mjaftueshme dhe 97% e rasteve që fillojnë hetimet përfundojnë me ngritjen e aktakuzave, 97% të aktakuzave konfirmohen nga gjykatat dhe diku 97-98% e aktakuzave në shkallë të parë gjykata i shpall fajtorë”. Pra, imagjinoni çfarë përqindje e lartë e luftës kundër krimit dhe korrupsionit atje. Tha “çka ndodh pastaj në shkallë të dytë, është çështje tjetër, por puna e policisë hetimore, puna e prokurorisë dhe puna e gjykatave në shkallë të parë në Kroaci sa u përket rasteve të Prokurorisë Speciale kishte përqindjen prej 97% deri 98%.

Në këtë kuadër unë pres që këto reforma të shkojnë në atë drejtim që të forcojnë institucionin edhe të hetuesisë, edhe të akuzës, edhe të gjykatave, që të kryejnë punën e tyre ashtu siç parashihet me ligj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti ministër Tahiri, e keni fjalën.

MINISTRI ABELARD TAHIRI: I nderuar zoti Kurteshi,

Ta them me përgjegjësi të plotë se jo vetëm këtë ligj, mirëpo komplet pakon e ligjeve gjyqësorit i kemi pasur të involvuar ekspertët nga Bashkimi Evropian. Është e pandershme prej anës time të flas me emra, sot në publik të dal me emrat e tyre, mirëpo mund të diskutojmë dhe për secilin në leximin e dytë, për secilin nen ne mund të japim argumentet tona dhe i qëndrojmë mbrapa këtij projektligji.

Ne kemi bashkëpunim të ngushtë me ta, në asnjë rrethanë, pra e konsideroj që e kam adresuar një prej të gjeturave të Raportit të Progresit që po theksohet që dy herë, edhe në vitin 2016, edhe para një jave. Dhe, unë mendoj që këtu kemi bërë një hap para dhe miratimi i tij në lexim të parë është një hap përpara i Republikës së Kosovës. Sa i përket çështjes që e ngriti zonja Osmani, unë konsideroj që këtu nuk kemi të bëjmë me ndërhyrje të ministrit, ajo ankesë që vjen nga qytetarët tek ministri, apo tek Avokati i Popullit mund të hidhet poshtë nga organet kompetente, pra përkatëse që i parashihet ky ligj dhe në asnjë rrethanë nuk shihet si një ndërhyrje e politikës apo e ministrit. Mirëpo, kjo është çështje më së paku e rëndësishme, si e Avokatit të Popullit, si e ministrit. E rëndësishme, po e them edhe një herë, mund ta diskutojmë dhe mund ta heqim, e rëndësishme është që të shuhet kjo zyre dhe kur thashë nuk është degraduar sistemi i drejtësisë

në vend, thashë kjo zyre disiplinore, puna e kësaj ka degraduar dhe nuk mund të vazhdohet më tutje. Tash e 16 vjet e kemi të njëjtën gjendje, tash e 16 vjet ankohe mi për mosefikasitet të punës së gjyqtarëve dhe mosefikasitet të punës së prokurorëve.

Në shumë vende të botës, një prej tyre Gjermani, që është një demokraci shumë e konsoliduar, Zyra e Prokurorit Disiplinor ekziston në Ministrinë e Drejtësisë, domethënë është pjesë e politikës, jo për gjyqtarët, të merremi vesh, vetëm për prokurorët, ekziston në Ministrinë e Drejtësisë. Pra, secili vend e ka të rregulluar veç e veç dhe për këtë çështje pra e kemi përkrahjen e Bashkimit Evropian që ta adresojmë në këtë formë, në këtë mënyrë qysh kemi ardhur me këtë projektligj. E kemi menduar edhe mundësinë që t'i drejtohem i edhe Komisionit të Venecias, mirëpo nëse për shkak të kohës dhe nevojës imediate që të intervenojmë në këtë, nëse e dërgojmë tani, mendim do të marrim diku nga fundi i shtatorit apo tetorit, flas për projektligjin në fjalë dhe është shumë e nevojshme që ta trajtojmë sa më shpejt që është e mundur dhe ta shuajmë këtë zyre. Në anën tjetër, njerëzit që punojnë këtu nuk do të mbesin pa punë, do të shpërndahen nëpër të dy këshillat, të gjithë ata që janë pjesë e kësaj zyre dhe përgjegjësia disiplinore u kalon në nivel të këshillave, Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit Prokurorial.

Çështjen e ministrit, jam i gatshëm ta diskutojmë dhe i heqim, vetëm çështja e përgjegjësisë të kalojë në nivel të këshillave. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Sami Kurteshi ka replikë.

SAMI KURTESHI: Faleminderit, zoti kryesues!

Nuk e kam në formën e replikës, e kam më shumë në formën e sqarimeve. Megjithatë, zoti ministër e përmendi një fakt, por nuk e sqaroi se Zyra e Prokurorit Disiplinor në Gjermani, që është një sistem jashtëzakonisht i fortë, është brenda Ministrisë së Drejtësisë, kjo është e vërtetë, por kjo është vetëm gjysma e të vërtetës.

Gjysma tjetër e së vërtetës është se Prokuroria është pjesë e Ministrisë së Drejtësisë për çështjet e rasteve ex officio. Ky është problemi. Në këtë problem s'e kemi ndjekur. Në nuk e kemi në legjislacionin tonë kështu. Çështja tjetër është që në mund të diskutojmë edhe me ekspertët ndërkombëtarë, nuk e kemi problem. Le të vijmë, le të thonë se kjo përzierje është e drejtë. Bile aq më tepër unë mendoj që nuk e bëjnë ata, sepse do të kemi zyrtarë të ndryshëm të shteteve të ndryshme, që disa do të thonë "Po, involvim më i madh i Ministrisë së Drejtësisë", e disa kanë për të thënë "Është krejtësisht e papranueshme". Prandaj, ky përgjithësim është i rrezikshëm. Në po e bëjmë për nevojat tona.

Sa i përket çështjes së dërgimit në Komisionin e Venecias, s'kemi nevojë të ngutemi kaq shumë. Ta dërgojmë, le të na japë një mendim dhe mendimin që ne e jep e integrojmë në ligj, ose e bëjmë ligjin sipas vlerësimeve të Komisionit të Venecias. Në po bëjmë ligj për dhjetëra vjet, pse

të mos presim dy, tre, ose pesë muaj. Kjo nuk është diçka problematike. Unë këtu e kam çështjen. Domethënë, këto duhet të trajtohen në këtë mënyrë. Nuk është çështja e refuzimit të ligjit si të tillë, “ters”. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka të tjerë të paraqitur. Edhe ministri e tha fjalën e vet. Tani është radha që të votojmë. Përgatitemi për votim. Votojmë tani! Faleminderit!

Kanë votuar 85 deputetë me kartelë, një është pa kartelë, 86 deputetë. 55 vota me kartelë janë për, 1 pa kartelë, gjithsej 56 vota për. 30 vota janë kundër, asnjë abstenim.

Konstatohet që Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin nr. 06/L-057 për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Ngarkohet Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

Pika e gjashtë është shtyrë për një seancë tjetër.

7. Emërimi i drejtorit dhe zëvendës drejtorit të Sekretariatit Ekzekutiv të Agjencisë për Krahasim dhe Verifikim të Pronës

Rregullat e dritës, votimi do të jetë i fshehtë, por unë propozoj që të dy votimet të kryhen njëherësh, me qëllim që të mos e përsëritim votimin dhe të mos humbim shumë kohë. Votohet për kandidatin e propozuar për emërim të drejtorit të Sekretariatit Organizativ të Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës.

Kandidatë janë Florije Kika dhe Naser Shala, ndërsa kandidatë për emërimin e zëvendës drejtorit të Sekretariatit Ekzekutiv të Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës janë: Milaim Çekaj dhe Mark Buzhala.

Rregullat e votimit i dimë të gjithë. Administrata, njerëzit që janë të caktuar le ta sjellin dokumentacionin dhe kutitë e votimit. Fletëvotimet i keni me dy ngjyra të dallueshme dhe vendet e votimit do të jenë të tilla. Kështu që nuk do të ketë ndonjë problem që të na shqetësojë.

Tani i ftoj përfaqësuesit e grupeve parlamentare që ta propozojnë nga një anëtar të Komisionit votues. Zoti Hoti, kë e keni për kandidat?

AVDULLAH HOTI: Fidan Rekaliu.

KRYESUESI: Faleminderit! PDK-ja, zoti Memli Krasniqi, kë e keni për komision?

MEMLI KRASNIQI: E propozoj Luljeta Veselaj-Gutajn për komision.

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar Vetëvendosje, zonja Haxhiu e ka fjalën.

ALBULENA HAXHIU: Ne e propozojmë deputetin Sali Zyba, por së pari është dashur të lexohet rekomandimi i Komisionit për Legjislacion.

KRYESUESI: Në rregull, po i zgjedhim këta dhe pastaj e merr fjalën. Ishte lapsus imi.

Grupi i Deputetëve të Pavarur, kë e keni? Zoti Sejdiu.

DARDAN SEJDIU: Ne e propozojmë doktor Driton Çaushin.

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar i AAK-së. Zoti Nitaj e ka fjalën.

MUHARREM NITAJ: Grupi Parlamentar i AAK-së e propozon Teuta Haxhiun.

KRYESUESI: Faleminderit! Lista serbe, kë e ka? Sasha Milosavljeviq e ka fjalën, apo Slavko Simiq? Cili e doni?

SAŠA MILOSAVLJEVIĆ: Hvala predsedavajući!
Srpska lista predlaže za člana ove komisije Adema Hodžu.

KRYESUESI: Faleminderit! Nisma, kë e ka, zoti Zafir?

ZAFIR BERISHA: Nisma Socialdemokrate e propozon shokun Enver Hoti.

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar “6+”, kë e ka, zoti Kinolli?

ALBERT KINOLLI: Faleminderit, i nderuari kryesues!
Grupi Parlamentar “6+” e delegon deputetin Bahrim Shabani. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Ju lus që me ngritje dore ta miratojmë komisionin. Tani ia jap fjalën kryetares së komisionit, zonjës Haxhiu.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Po vazhdoj ta lexoj rekomandimin e Komisionit për Legjislacion në raport me emërimin e drejtorit dhe zëvendësdrejtorit të Sekretariatit Ekzekutiv të Agjencisë për Krahasim dhe Verifikim të Pronës.

Komisioni për Legjislacion, në mbështetje të nenit 7 të Ligjit nr. 05/L-010 për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, në mbledhjen e mbajtur më 10 prill 2018, e shqyrtoi propozim-vendimin e Qeverisë së Kosovës me kandidatët e propozuar për drejtor dhe zëvendësdrejtor të Sekretariatit Ekzekutiv të Agjencisë për Krahasim dhe Verifikim të Pronës dhe vendosi që Kuvendit t'i rekomandojë që të mos emërohen për drejtor të Sekretariatit Ekzekutiv të Agjencisë për Krahasim dhe Verifikim të Pronës kandidatët e propozuar Florie Kika dhe Naser Shala, por po ashtu edhe kandidatët për zëvendësdrejtorë të Sekretariatit Ekzekutiv në Agjencinë për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, që janë propozuar nga Qeveria, Milaim Çekaj dhe Mark Buzhala.

Komisioni për Legjislacion i ka shqyrtuar CV-të e kandidatëve. Vërejtjet e anëtarëve që nuk i kanë përkrahur propozimet e tilla kanë qenë në fakt vetëm për një kandidat. Por, që sugjerimet e Zyrës Ligjore, në fakt Komisionit për Legjislacion, zyrtarëve ligjorë në Komisionin për Legjislacion, kanë qenë që nuk mund t'i ndajmë njërin me tjetrin, për shkak se është vendim i Qeverisë dhe duhet të procedohet si i tillë, pa mundur të bëjmë ndonjë dallim. Mendoj se kjo ka qenë jokorrekte në raport me kandidatët tjerë. Unë po e them se cila ka qenë vërejtja jonë, ka qenë kandidati Naser Shala, që është propozuar nga Qeveria. Unë kam thënë se i njëjti nuk ka integritet dhe nuk është profesionist që të merret me këtë. Arsyet i kam bazuar, sepse është njëri prej njerëzve që e kemi dëgjuar edhe në aferën e përgjimeve, "Pronto". Prandaj, edhe kam konsideruar që një njeri i tillë nuk mund të jetë, apo nuk mund të propozohet për drejtor të Agjencisë për Krahasim dhe Verifikim të Pronës.

Andaj, ky është rekomandimi i komisionit, por i mbetet seancës që të marrë vendim në raport me këtë. Faleminderit!

KRYESUESI: Atëherë, lus anëtarët e komisionit që t'i zënë vendet e tyre. LDK, PDK, Vetëvendosje, të pavarurit, Nisma, AAK-ja, Lista serbe, "6+"-i. Ju lus t'i zini vendet tuaja.

Abdyl Salihu, Adem Hoxha, Adem Mikullovc, Ahmet Isufi, Aida Dërguti, Albin Kurti, Albulena Balaj-Halimaj, Albulena Haxhiu, Ali Lajçi, Allbert Kinolli, Andin Hoti, Anton Quni, Arban Abrashi, Arben Gashi, Arbër Rexhaj, Arbërie Nagavci, Armend Zemaj, Avdullah Hoti, Bahrim Shabani, Bekë Berisha, Bekim Haxhiu, Besa Baftiu, Besa Gaxherri, Bilall Sherifi, Blerim Kuçi, Blerta Deliu-Kodra, Danush Ademi, Dardan Molliqaj, Dardan Sejdiu, Daut Haradinaj,...

Në qoftë se, përderisa s'keni votuar, dëshironi të mos marrim pauzë, ne mund ta vazhdojmë prapë seancën, në qoftë se doni pauzë, atëherë e marrim edhe pauzën.

Donika Kadaj-Bujupi, Doruntinë Maloku-Kastrati, Drita Millaku, Driton Çausi, Driton Selmanaj, Duda Balje, Dukagjin Gorani, Elmi Reçica, Emilija Rexhepi, Enver Hoti, Etem Arifi, Evgjëni Thaçi-Drăgusha, Fadil Beka, Fatmir Xhelili, Fatmire Kollçaku, Faton Topalli, Fidan Rekalio, Fikrim Damka, Fisnik Ismaili, Fitore Pacolli-Dalipi, Flora Brovina, Frashër Krasniqi, Gani Dreshaj, Ganimete Musliu, Glauk Konjufca, Hajdar Beqa, Haxhi Shala, Haxhi Avdyli, Hykmete Bajrami, Igor Simiq, Ilir Deda, Imet Rrahmani, Islam Pacolli, Ismajl Kurteshi, Ismet Beqiri, Jasmina Zhivkoviç, Jelena Bontiq, Kadri Veseli, Korab Sejdiu, Kujtim Shala, Labinot Tahiri, Liburn Aliu, Lirije Kajtazi, Luljeta Veselaj-Gutaj, Lumir Abdixhiku, Lutfi Zharku, Memli Krasniqi, Mërgim Lushtaku, Mexhide Mjaku-Topalli, Milaim Zeka, Miljana Nikoliç, Mimoza Kusari-Lila, Mirjeta Kalludra, Mufera Srbica-Shinik, Muharrem Nitaj, Nait Hasani, Naser Rugova, Naser Osmani, Nezir Çoçaj, Ramiz Kelmendi, Rasim Selmanaj, Rexhep Selimi, Safete Hadërgjonaj, Sala Berisha-Shala, Salih Salihu, Sali Zyba, Sami Kurteshi, Saranda Bogujevci, Sasha Milosavljeviç, Shëmsi Syla, Shkumbin Demaliaj, Shqipe Pantina, Slavko Simiq, Slobodan Petroviç, Sërgjan Mitroviç, Teuta Haxhiu, Teuta Rugova, Time Kadrijaj, Valentina Bunjaku-Rexhepi, Valon Ramadani, Verica Qeraniç, Veton Berisha, Visar Ymeri, Vjosa Osmani-Sadriu, Xhavit Haliti, Xhelal Sveçla, Xhevahire Izmaku, Zafir Berisha, Zenun Pajaziti, Zoran Mojsiloviç.

* * *

KRYESUESI: Në qoftë se dikush ka mbetur pa votuar, ju lus që ta merrni fletëvotimin për të votuar, nëse jo konsideroj që votimi ka përfunduar. Tani komisioni do të merret me numërimin e votave dhe shpalljen e rezultatit të tyre. Faleminderit!

LULJETA VESELAJ-GUTAJ:

Florije Kikaj,
Mark Buzhala,
Florije Kikaj,
Milaim Çekaj,
E pavlefshme,
Naser Shala,
Milaim Çekaj,
Naser Shala,
Milaim Çekaj,
Naser Shala,

E pavlefshme për zëvendës drejtor,
Florije Kikaj,
Naser Shala,
Mark Buzhala,
Naser Shala,
Milaim Çekaj,
Naser Shala,
Mark Buzhala,
Naser Shala,
Milaim Çekaj,
Florije Kikaj,
Mark Buzhala,
Naser Shala,
Mark Buzhala,
Florije Kikaj,
Mark Buzhala,
Naser Shala,
Mark Buzhala,
Naser Shala,
Mark Buzhala,
Naser Shala,
Mark Buzhala,
Naser Shala,
Mark Buzhala,
Naser Shala,
Mark Buzhala,
Naser Shala,
Milaim Çekaj,
Florije Kikaj,
Mark Buzhala,
Florije Kikaj,
Mark Buzhala,
Florije Kikaj,
Mark Buzhala,
Florije Kikaj,
Mark Buzhala,
Naser Shala,
Milaim Çekaj,
Florije Kikaj,
Milaim Çekaj,

Florije Kikaj,
Milaim Çekaj,
Milaim Çekaj,
E pavlefshme,
Naser Shala,
Milaim Çekaj,
Florije Kikaj,
Milaim Çekaj,
Florije Kikaj,
Mark Buzhala,
Florije Kikaj,
Milaim Çekaj,
Florije Kikaj,
Mark Buzhala,
Naser Shala,
Milaim Çekaj,
Naser Shala,
Milaim Çekaj,
Naser Shala,
Milaim Çekaj,
Naser Shala,
Milaim Çekaj,
Florije Kikaj,
Mark Buzhala,
Florije Kikaj,
Mark Buzhala,
E pavlefshme,
Florije Kikaj,
Milaim Çekaj,
Naser Shala,
Milaim Çekaj,
Naser Shala,
Milaim Çekaj,
Florije Kikaj,
Mark Buzhala,
Florije Kikaj,
Milaim Çekaj,
Naser Shala,
Milaim Çekaj,
Naser Shala,

Milaim Çekaj,
Florije Kika,
Mark Buzhala,
Florije Kikaj,
Mark Buzhala,
Florije Kikaj,
Mark Buzhala,
Florije Kikaj,
Mark Buzhala,
E pavlefshme,
Florije Kikaj,
Milaim Çekaj,
Florije Kikaj,
Mark Buzhala,
Florie Kikaj,
Milaim Çekaj
E pavlefshme,
E pavlefshme,
E pavlefshme,
E pavlefshme,
Naser Shala,
Milaim Çekaj,
Naser Shala,
E pavlefshme,
Naser Shala,
Naser Shala,
Mark Buzhala,
Naser Shala,
Milaim Çekaj,
Florije Kikaj,
Milaim Çekaj,
Florije Kikaj,
Milaim Çekaj,
Florije Kikaj,
Milaim Çekaj,
Naser Shala,
Milaim Çekaj,
Florije Kikaj,
Milaim Çekaj,
Florije Kikaj,

Naser Shala,
Mark Buzhala,
Naser Shala,
Mark Buzhala,
Naser Shala,
Milaim Çekaj,
Naser Shala,
Milaim Çekaj,
Florie Kikaj,
Milaim Çekaj,
Naser Shala,
Mark Buzhala,
Naser Shala,
Mark Buzhala,
Naser Shala,
Milaim Çekaj,
Florie Kikaj,
Mark Buzhala,
Naser Shala,
Milaim Çekaj,
Naser Shala,
Milaim Çekaj,
Florie Kika,
Mark Buzhala,
Florie Kika,
Milaim Çekaj,
Mark Buzhala,
Naser Shala,
Milaim Çekaj,
Florie Kika,
Milaim Çekaj,
Naser Shala,
Milaim Çekaj,
Milaim Çekaj,
Naser Shala,
Naser Shala,
Florie Kika,
Milaim Çekaj,
Florie Kika,
Mark Buzhala,

E pavlefshme,
Naser Shala,
Milaim Çekaj,
Florije Kika,
Milaim Çekaj,
Naser Shala,
Milaim Çekaj,
Naser Shala,
Milaim Çekaj,
Florie Kika,
Mark Buzhala,
E pavlefshme.

KRYESUESI: Regjia, fjalën komisionit, ju lutem!

LULJETA VESELAJ-GUTAJ: Komisioni votues për emërimin e drejtorit dhe zëvendës drejtorit të Sekretariatit Ekzekutiv të Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës paraqet këtë:

R a p o r t

Për rezultatin e votimit për emërimin e drejtorit dhe zëvendës drejtorit të Sekretariatit Ekzekutiv të Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës

Në mbështetje të neneve 65 dhe 142 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7 të Ligjit nr. 05/L-010 për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, si dhe të nenit 51 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni Votues i formuar me vendim të Kuvendit më 3 maj 2018, në përbërje nga një përfaqësues të secilit grup parlamentar, Fidan Rekalju, LDK; Luljeta Veselaj-Gutaj, PDK; Sali Zyba, Vetëvendosje; Driton Çausi, Grupi i Deputetëve të Pavarur; Teuta Haxhiu, AAK; Adem Hoxha, Lista serbe; Enver Hoti, Nisma; dhe Bahrim Shabani, Grupi Parlamentar “6+”.

Komisioni votues, pas procedurës së votimit të fshehtë dhe numërimit të votave të deputetëve të Kuvendit për emërimin e drejtorit dhe zëvendës drejtorit të Sekretariatit Ekzekutiv të Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, në seancën plenare të mbajtur më 3 maj 2018, konstaton se:

- në votim kanë marrë pjesë 98 deputetë;
- të pavlefshme janë 9 fletëvotime;
- votat e fituara për kandidatët e propozuara për emërimin e drejtorit të Sekretariatit Ekzekutiv të Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës janë:

1. Florie Kika i ka fituar 40 vota dhe
2. Naser Shala i ka fituar 46 vota.

Votat e fituara për kandidatët e propozuar për emërimin e zëvendës drejtorit të Sekretariatit Ekzekutiv të Agjencisë Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të pronës janë:

1. Milaim Çekaj i ka fituar 47 vota dhe
2. Mark Buzhala i ka fituar 35 vota.

Komisioni konstaton se asnjë nga kandidatët nuk ka dalë fitues dhe se konkursi përsëritet nga fillimi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë, konsideroj se është mbyllur votimi. Konkursi duhet të përsëritet.

Si duket, ne duhet të shkojmë në pauzë, sepse s'ka deputetë për ta vazhduar seancën. Shkojmë në pauzë deri në orën 15:30 minuta.

* * *

Vazhdimi i mbledhjes, pas pauzës

Mbledhjen e drejton nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.

KRYESUESI: Të nderuara zonja dhe zotërinj,
Po vazhdojmë me rendin e ditës:

8. Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për një anëtar të Bordit të Radio Televizionit të Kosovës nga komuniteti shqiptar

Kryesia e Kuvendit në mbledhjen e mbajtur më 19 prill 2018 ka kërkuar nga grupet parlamentare të Kuvendit që të propozojnë deputetët për kryetar, zëvendëskryetar dhe anëtarë të Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për një anëtar të Bordit të Radio Televizionit të Kosovës nga komuniteti shqiptar. Ftoj kryetarët e grupeve parlamentare që të propozojnë deputetët për formimin e këtij komisioni.

Ftoj kryetarin e Grupit Parlamentar të LDK-së, ose kush mund ta paraqesë propozimin për dy deputetë anëtarë të komisionit nga Grupi Parlamentar i LDK-së.

ARBEN GASHI: Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Armend Zemaj dhe Doruntina Maloku. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar i PDK-së ka një zëvendëskryetar të parë dhe një anëtar.

MEMLI KRASNIQI: Në emër të Grupit Parlamentar së Partisë Demokratike të Kosovës për Komisionin ad hoc ne propozojmë pozitën e zëvendëskryetarit të parë, deputetin Nait Hasani, ndërsa si anëtar deputetin Mërgim Lushtaku.

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje ka propozuar dy deputetë për anëtarë të komisionit. Valon Ramadanin, zëvendëskryetar të dytë dhe Adem Mikullovcin, anëtar.

Grupi Parlamentar i Deputetëve të Pavarur ka propozuar për anëtarë të komisionit deputeten Shqipe Pantina.

Ftoj kryetarin e Grupit Parlamentar të AAK-së që të propozojë një deputet për anëtar të komisionit. Zonja Haxhiu e ka fjalën.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, nënkryetar!
E propozojmë zotin Rasim Selmanaj.

KRYESUESI: Faleminderit! Ftoj përfaqësuesin e Grupit Parlamentar të Listës serbe që ta propozojë një deputet për kryetar të komisionit. Zoti Hoxha, a mund ta propozosh dikë ti ose po ju lë që të konsultoheni.

rupi Parlamentar Nisma të propozojë një deputet për anëtar të komisionit, zoti Sherifi.

BILALL SHERIFI: Faleminderit, kryesues!
Nisma e propozon deputetin Milaim Zeka.

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar “6+”.

ALBERT KINOLLI: Albert Kinolli.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Kinolli!
Zoti Hoxha, a mund ta propozoni? Jo!

Grupi Parlamentar i Listës serbe nuk janë të gjithë prezentë, kryetari i grupit nuk është. Kryetarin e komisionit e paskan, po e udhëheqkan këta, po e presim edhe Listën serbe që ta kandidojë njërin nga deputetët, por duhet t’ju komunikoj që ne kemi edhe dy pika të tjera të rendit të ditës, në të cilat nuk mund të futemi për shkak se nuk kemi numër të mjaftueshëm të deputetëve në sallë.

Çështja e propozimit të Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje duhet t’i ketë 2/3 e deputetëve në sallë për të votuar, gjithashtu edhe formimi i Komisionit Hetimor që është propozuar në lidhje me shpenzimet për lobim nga Presidenti dhe Qeveria e Republikës së Kosovës, s’e di a jemi të përgatitur për ta kryer si pikë të rendit të ditës.

Atëherë, sipas interpretimit të Rregullores, në qoftë se Grupi Parlamentar i Listës serbe nuk e dorëzon sot anëtarin e komisionit, komisionin e udhëheq zëvendëskryetari i parë. Kjo është rregull.

Atëherë, po kalojmë në pikën e dhjetë të rendit të ditës, duke e anashkaluar pikën e 9-të për shkak të numrit të deputetëve. Besoj që ose sot ose në seancat e ardhshme të radhës mund të bëhet numri i mjaftueshëm.

10. Formimi i Komisionit Hetimor Parlamentar në lidhje me shpenzimet për lobim nga Presidenca dhe Qeveria e Republikës së Kosovës

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, mbështetur nga 41 deputetë nënshkrues, në bazë të nenit 4, paragrafi 1 të Ligjit për hetim parlamentar i ka propozuar Kuvendit formimin e Komisionit Hetimor Parlamentar lidhur me shpenzimet për lobim nga Presidenca dhe Qeveria e Republikës së Kosovës.

Kryesia e Kuvendit në mbledhjen e mbajtur më 19 prill 2018 ka kërkuar nga grupet parlamentare t'i propozojë deputetët dhe anëtarët e Komisionit Hetimor sipas propozimit të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës. Përbërja e komisionit do të jetë me 15 anëtarë, grupet parlamentare të Lidhjes Demokratike, të Lëvizjes Vetëvendosje dhe Deputetët e Pavarur i propozojnë shtatë anëtarë, në mesin e tyre e propozojnë kryesuesin dhe zëvendëskryesuesin, si dhe grupet parlamentare të PDK-së, AAK-së, Listës serbe, Nisma Socialdemokrate dhe 6+ i propozojnë tetë anëtarë të komisionit.

Ftoj kryetarin e Grupit Parlamentar të LDK-së, zotin Hoti, që në cilësinë e propozuesit ta paraqesë propozimin për formimin e Komisionit Hetimor Parlamentar. Zoti Hoti, e keni fjalën.

AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryesues i seancës!

Ne pas diskutimit në grupin parlamentar dhe në konsultim me deputetë të tjerë të grupeve parlamentare kemi propozuar në Kryesinë e Kuvendit dhe seancës formimin e Komisionit Hetimor Parlamentar në lidhje me shpenzimet për lobim nga Presidenca dhe Qeveria e Kosovës. Baza ligjore për formimin e këtij komisioni është dhënë në nenin 77 të Kushtetutës, nenin 71 të Rregullores së Punës së Kuvendit dhe neni 4 të Ligjit për hetim parlamentar nr. 03/L-176. Kemi marrë mbështetje edhe nga grupet tjera parlamentare.

Çështjet për hetim të këtij komisioni janë dy: e para, përputhshmërinë me ligjin në fuqi të mjeteve të shpenzuara për aktivitete lobuese nga Presidenca dhe Qeveria e Republikës së Kosovës nga vitit 2010 deri më tani dhe, e dyta, efektet e arritura nga këto shpenzimet për Republikën e Kosovës.

Arsyetimi për formimin e këtij komisioni parlamentar është dhënë në shkresën që kemi dorëzuar për të maksimizuar transparencën dhe lidhshmërinë në shfrytëzimin e parasë publike, sepse ka pasur plot publikime nëpër media të ndryshme, të personave të ndryshëm, ku tregonin për përdorimin jo në përputhje me ligjet dhe me qëllim për të cilin janë ndarë këto mjete të lobimit, ku janë përmendur edhe persona specifikë, prandaj bazuar në këtë, ne kemi iniciuar themelimin e këtij Komisioni Hetimor Parlamentar për të zbardhur të gjitha këto pretendime.

Ashtu si e cekët ju lidhur me përbërjen e këtij Komisioni Hetimor Parlamentar, ne propozojmë që t'i ketë 15 anëtarë që përfaqësojnë proporcionalisht grupet parlamentare. Kryetari i komisionit të jetë anëtari që propozohet në këtë komision nga opozita, gjegjësisht në këtë rast me Grupin Parlamentar Grupi i Deputetëve të Pavarur, të cilët nuk janë nënshkruar të kësaj kërkesë. Zëvendëskryesues të jetë një nga anëtarët e komisionit që vjen nga Grupi Parlamentar i LDK-së, si iniciues i këtij komisioni. Për afatin kohor propozojmë që ky komision t'i paraqesë seancës raport në afat prej një muaj nga data e themelimit. Faleminderit, kryesues! Ky është i gjithë arsyetimi për themelimin e këtij Komisioni Hetimor Parlamentar, nëse pajtoheni ju mund të propozoj edhe emrat që vijnë nga Lidhja Demokratike e Kosovës.

Deputeti Lumir Abdixhiku propozojmë të jetë edhe zëvendëskryesues, deputetja Vjosa Osmani dhe Deputeti Ilir Deda. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Radha është e diskutuesve të përfaqësuesve të grupeve parlamentare. Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike besoj që s'doni të flisni prapë apo është dikush tjetër në emër të grupit. Në rregull.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike, kush do të flasë? Zoti Krasniqi!

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Fillimisht më lejoni të them që këto iniciativat për të filluar krijimin e komisioneve hetimore për çështje vend e pavend, për të cilat ka dyshime në janë në pajtim me Kushtetutën, në këtë rastin konkret, sepse ekziston një ndarje e pushteteve dhe po ashtu e përgjegjësive të disa prej institucioneve. Sidoqoftë, mendoj që mund të na fusin në një cikël të iniciativave për themelimin e komisioneve hetimore, të cilat pastaj nuk e dimë a do ta kthejnë këtë Kuvend në një lloj prokurorie apo do të mbetemi për të kryer detyrat, të cilat i kemi.

Gjithsesi ne si Parti Demokratike e Kosovës sot nuk jemi të gatshëm t'i japim emrat, na duhet që të konsultohemi edhe pak si grup parlamentar dhe pastaj, nëse vazhdon iniciativa për këtë komision, atëherë edhe mund t'ju njoftojmë me kohë për katër emrat, të cilët do të duhej t'i kishim në këtë komision. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi Parlamentar Vetëvendosje?

GLAUK KONJUFCA: Unë me vesh të mi e kam dëgjuar presidentin duke thënë që nuk është partiak, nuk i përket asnjë partie politike. Tash unë nuk besoj që asnjë parti ka arsye për t'u frikësuar që Hashim Thaçi të hetohet lidhur me mënyrën se si i shpenzon paratë publike. Kështu që edhe ne jemi për t'u krijuar ky Komision Hetimor dhe propozojmë që deputetet Arbërie Nagavci dhe Drita Millaku të jenë pjesë e këtij komisioni.

KRYESUESI: Faleminderit! Bën replikë, dy minuta, ka të drejtë edhe ai në kundër-replikë. Memli Krasniqi, e ka fjalën për replikë.

MEMLI KRASNIQI: Si edhe shpeshherë, më duket, zoti Konjufca ishte paragjykuar, sepse unë e pata shqetësimin më shumë për Isa Mustafën edhe Ramush Haradinaj, sepse kjo kërkesë ka të bëjë me Qeverinë edhe me Presidencën, jo me presidentin dhe kjo është arsyeja e cila neve na ka shkaktuar pak më shumë shqetësim, sepse po flitet për Qeverinë dhe këtë Qeveri e udhëheq kryetari i AAK-së, e atë qeverinë e kaluar, e cila edhe ajo besoj është pjesë e këtij hetimi, nëse nuk e ka menduar LDK-ja, unë e propozoj që të përfshihet, është udhëhequr prej kryetarit të LDK-së, kjo është çështja. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Konjufca ka kundër-replikë.

GLAUK KONJUFCA: Thënë të drejtën, krejt këta që i përmendi Memli, nuk bëj shumë dallime te ta. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Grupi i Deputetëve të Pavarur, kush është paraqitur? Zoti Molliqaj!

DARDAN MOLLIQAJ: Faleminderit, kryesues!

Është e qartë që cilësdo prej partive që nuk po i konvenon për t'u krijuar komisionet, kanë gjetur një mekanizëm të bllokimit, sepse pa dërgimin e përfaqësuesve të njërës nga subjektet politike parlamentare, komisionet edhe nuk po funksionalizohen. Besoj që nisma e nënkryetares së Kuvendit Aida për ta përmirësuar këtë pjesë të adresimit të komisioneve është e drejtë dhe ndërkohë, Memli, është e qartë që edhe te rasti i hetimit për deportimin e shtetasve turq, edhe në këtë rast, PDK-ja po e bllokoi me qëllim formimin e komisioneve.

Atë ditë u arsyetuar që për shkak se LDK-ja nuk e votoi një marrëveshje ndërkombëtare mes Kosovës dhe Hungarisë, nuk e votuar as ju, që po del se s'ka qenë ashtu. Dhe sa herë që ka tendenca për t'u hetuar Presidenti Thaçi ose veprimtaria e tij, ose ato që lidhen me të, PDK është duke e bllokuar dhe mendoj që nuk është e drejtë, sepse ju të gjithë thirreni që jeni të gatshëm të bëjmë hetime. Komisionet hetimore parlamentare, a mund të na mësojnë, pra, cilat janë, se the po i keqkuptojmë. Ndoshta, ti di të na tregosh për të cilat lejojnë, ose duhet nxjerr një nen aty që gjithmonë duhet të pyetet PDK-ja para se të nisë komisioni hetimor, pra çka mendon PDK-ja?

Përndryshe, propozojmë Dardan Sejdiun si anëtar të komisionit, meqenëse edhe na takon e drejta për të kryesuar, do të jetë edhe kryetar i këtij Komisioni Hetimor.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Krasniqi, replikë!

MEMLI KRASNIQI: Dardan, e pyetni apo nuk e pyetni PDK-në, është e drejtë juaja, por po ta dëgjonit PDK-në, më mirë do t'ju binte. Atë ditë nuk është ajo çka the ti, s'është aspak e saktë. Unë sot ju bëj ftesë, mund ta shtimë në rend ditës, nëse do LDK-ja ta kthejë Komisionin Hetimor. Kam kërkuar dhe e ripërsëris që pa kaluar ato dyja, as ne s'do ta votonim, sepse nuk është fer, së paku fer, s'po shprehem me ndonjë shprehje më të rëndë, të kërkosh standard të dyfishtë në njëjtën seancë. Një herë të bojkotohet votimi për të pamundësuar kalimin qoftë të Bordit të Agjencisë së Privatizimit të Kosovës, i cili është i domosdoshëm që ta dini, sepse edhe buxheti i Kosovës varet pak a shumë nga kalimi edhe i atij bordi, edhe i Ligjit për AKP-në, të cilin e kemi votuar këtu.

Dhe, po ashtu edhe traktati që ishte ndërmjet dy shteteve, Kosovës dhe Hungarisë. Sidoqoftë, vendimi ka qenë i LDK-së që ta tërheqë prej rendit të ditës dhe jo i PDK-së. Nëse kthehet në

rend të ditës, ju e shihni votimin tonë, sepse në fund të fundit me vota tona është miratuar rekomandimi që të themelohet komisioni. Atë ditë deputetët e opozitës nuk kanë qenë shumica këtu, por ka qenë koalicioni ynë dhe votat më së shumti të Partisë Demokratike të Kosovës që e kanë themeluar atë komision. Sido që të jetë, ka qenë qëndrimi ynë shumë konsistent dhe shumë i qartë për atë komisionin tjetër dhe atë kemi mbështet 100%.

Ky komision, ky është për të bërë politika ditore, ne s'mund t'ia heqim, si thuhet, vesvesin kurrkujt, as për presidentin, as për kryeministrin, por që nëse themelohet komisioni, ne mund të marrim pjesë, po sot s'i kemi emrat gati.

KRYESUESI: Faleminderit! Kundër-replikë, zoti Molliqaj!

DARDAN MOLLIQAJ: Faleminderit, kryesues!

A është mirë të dëgjojmë ose jo PDK-në, tregon gjendja në Kosovë, Memli, edhe në institucione, edhe në të gjitha ato që po flasim përditë. PDK-ja e ka dëmtuar shumë me qeverisjen e saj Kosovën dhe besoj që nuk pajtohem, sigurisht, por janë faktet që flasin. Nuk isha duke folur për dëgjim të PDK-së, por isha duke thënë që PDK-ja po do të drejtë veto këtu dhe është bërë subversive, sa herë që mund të bllokojë diçka, për shkak se ia lejojnë instrumentet, po e ndal.

Unë i ftoj LDK-në, normalisht që ata janë subjekt i pavarur, për shkak se kanë qenë iniciues të asaj, që ta kthejnë në votim edhe Komisionin Hetimor për rastin e deportimit të turqve dhe të shohim se apo voton sot ose jo PDK-ja. Jam shumë i interesuar, jo, jo tash nuk e the kështu. Mund ta kemi transkriptin dhe ta shohim, pra prapë po them që është lojë fjalësh.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Hoti e ka fjalën, për replikë.

AVDULLAH HOTI: Tash, në seancën e fundit Grupi ynë Parlamentar e ka mbështetur Traktatin që ishte në mes të Kosovës dhe Hungarisë, sepse ajo kërkon 2/3 të votave, është çështje e rëndësisë nacionale. Po, as zoti Krasniqi dhe askush nuk mund të presë nga opozita që të votojë bordet tuaja që doni t'i dërgoni nëpër agjenci të ndryshme, ajo është çështje e pozitës.

Nëse keni fuqi t'i shtyni përpara, shtyjini përpara, nëse nuk keni fuqi, duhet të dorëzoheni dhe besoj që shpejt do të dorëzoheni. Sa i përket Komisionit Hetimor për dëbimin e gjashtë shtetasve turq, unë ju njoftoj që sot është protokolluar me 40 nënshkrime dhe sikurse edhe ky komision, nuk është diskrecion as i zotit Krasniqi dhe askujt tjetër për t'u themeluar, por është çështje ligji dhe besoj që në seancën e ardhshme do ta kemi në rend dite. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Kundër-replikë, zoti Krasniqi.

MEMLI KRASNIQI: Zoti Hoti, unë nuk po ju ftoj juve që të votoni pro Bordit të AKP-së në këtë rast, ose të asnjë ligji tjetër. Unë po ju ftoj të votoni, kur jeni në seancë, është së paku e papërgjegjshme për secilin prej neve që jemi deputetë dhe kemi mandat qytetar të jesh fizikisht këtu, të nënshkruash e t'i marrësh mëditjet e të mos votoni. Ju votoni kundër, nëse ka më shumë vota kundër, ai nuk kalon, nuk po ju them unë votoni pro. Unë po ju them ju votoni për atë çka thirrëmi, për çka vijmë ne në këtë Kuvend të Kosovës. Ndërsa, për atë tjetrën, ne kemi respektuar të drejtën tuaj, keni gabuar sipas mendimit tim, ka mundur të votohet menjëherë pas votimit të asaj që e thashë, tash prapë po e sillni në seancë. Ju e keni hequr prej seancës për të na e sjellë prapë në seancë për t'u votuar prapë.

Nuk po më duket që është bërë ndonjë zgjidhje kush e di çka, sepse prapë edhe për ato secili duhet t'i dorëzojmë emrat, por sidoqoftë, është e drejtë juaja. Unë juve s'po ju përzihem, edhe ju neve mos na u përzieni, po veç kryeni të drejtën tuaj të votoni.

KRYESUESI: Të drejtë s'ke: replikë, kundër-replikë dhe kryhet. Zonja Haxhiu e ka fjalën në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Temat që po vijnë në Kuvend, formimet e komisioneve hetimore ndonjëherë po duket sikur po bëhen sa për të thënë, por megjithatë transparenca e Qeverisë ekziston dhe ne jemi shumë të bindur që do të informohet çdo deputet me kohë për çdo gjë, por megjithatë se sa është kushtetuese, është çështje tjetër, por ne i kemi emrat. E kemi zotin Muharrem Nitaj dhe zotin Blerim Kuçi.

KRYESUESI: Faleminderit! Lista serbe nuk është këtu. Nisma për Kosovën, zoti Sherifi!

BILALL SHERIFI: Faleminderit, kryesues!

Besoje që ky komision, mandati i tij nuk është për të hetuar, por thjesht për t'i shikuar disa letra, përmes të cilave dëshmohet çka, kur është paguar, çka është kontraktuar, çka nuk është kontraktuar, por është paguar, pra askush nuk ka ndonjë arsye për t'iu shmangur materies, të cilën do ta trajtojë ky komision. Prandaj, ne Nisma e kemi edhe nënshkruar zotin Zafir Berisha dhe do ta dërgojmë zotin Zafir Berisha në këtë komision, i cili është edhe anëtar i Komisionit për Mbikëqyrje të Financave. Nëse është një për Nismën, ai do të jetë zoti Zafir Berisha.

KRYESUESI: Faleminderit! "6+?"

ALBERT KINOLLI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Pa dashur të përsëris atë që e thanë kolegët e mi të nderuar, mbi të gjitha është de facto dhe qëndron që paraja publike është e shenjtë dhe përderisa ekziston vullneti që të formohet një

komision i tillë parlamentar hetimor, Grupi Parlamentar 6+ propozon deputetin Fikrim Damka. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Qeveria nuk është këtu për ta marrë fjalën. Deputetët sipas radhës kanë të drejtë të flasin, edhe në emër personal, të tyre. Po mendoj që nëse doni të debatoni, nëse jo, atëherë presim derisa t'i sjellë PDK-ja emrat.

A po e mbyllim kështu, sepse as Lista serbe s'është që të propozojë, as PDK-ja s'i ka propozuar. S'kemi si ta hedhim në votim, por para se ta analizojmë dhe të mendoni edhe ju, respektivisht të më ndihmoni të dal prej situatës.

Ne diskutuam për formimin e Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e një kandidati për një anëtar të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës nga komuniteti shqiptar.

Unë dëshiroj që ta votojmë këtë komision, sepse kemi kuorum të mjaftueshëm për ta votuar dhe meqenëse Lista serbe nuk e di a ka hapësirë ligjore që ta sjellë nesër emrin, s'e di, por nga sot zëvendësuesi i ka kompetencat e plota për të filluar punën si kryesues i këtij komisioni. A jeni dakord?

Votojmë tash, pra komisionin e propozuar.

Atëherë, po e përsëris edhe një herë titullin që po e doni: është pika e tetë e rendit të ditës: Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për një anëtar të Bordit të Radio Televizionit të Kosovës nga komuniteti shqiptar.

Ky është votimi. Sipas rregullave, të drejtë për të kryesuar komisionin e ka Lista serbe, zëvendëskryetari i parë i takon Partisë Demokratike të Kosovës, nëse kandidati i Listës serbe nuk paraqitet ose kryetari ose grupi parlamentar nuk e prezanton kryesuesin, atëherë zëvendëskryetari i parë duhet ta udhëheqë këtë komision. A jeni dakord?

Votojmë tash!

Kanë votuar 67 deputetë. 65 për. Asnjë kundërshtim, 2 abstenime, një me dorë, do të thotë 68 deputetë kanë votuar. 66 janë për, asnjë kundër, 2 abstenime.

Konstatohet që Kuvendi i emëroi anëtarët e Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për një anëtar të Bordit të Radio Televizionit të Kosovës nga komuniteti shqiptar.

Sa i përket çështjes tjetër që mbetëm për ta diskutuar, thashë Qeveria s'është këtu të diskutojë ose ta japë mendimin e vet që do të ishte shumë e arsyeshme për ta dëgjuar të paktën kryeministrin dhe ministrin e Financave, por s'janë këtu, s'di a kanë pasur njoftim a jo për të qenë në sallë, por është e domosdoshme të flitet për këtë çështje dhe për diskutim është paraqitur kryetari i Grupit Parlamentar të LDK-së, zoti Hoti.

AVDULLAH HOTI: I nderuar kryesues!

Unë u paraqita veç që t'ju kërkoj që kjo çështje të nxirret me votim, të gjitha grupeve parlamentare, me përjashtim të PDK-së, i propozuan anëtarët në këtë komision, dhe në bazë të ligjit kjo në fakt është kategori kushtetuese, pavarësisht prezencës ose jo të Qeverisë. Të gjitha grupet i propozuan, përveç PDK-së, kjo duhet të dalë në votim, të konstituhet komisioni, mbesin vendet e lira për anëtarët e PDK-së kurdo që këta i dërgojnë anëtarët. Prandaj, unë ju lus që ta nxirrni në votim në seancë dhe të përmbillet kjo pikë e rendit të ditës.

KRYESUESI: Unë mendova të diskutojmë, se edhe unë kam çka të them. Megjithatë, meqenëse kështu është e rregulluar, unë e qes në votim. S'është paraqitur kurrkush, nuk duan të diskutojnë. Zoti Nitaj e ka kërkuar fjalën.

MUHARREM NITAJ: Mendoj që nuk është mirë të shtyhem në Kuvend, Partia Demokratike e Kosovës ka shprehur dyshimet e saj për kushtetutshmërinë e këtij komisioni. Ka kërkuar që anëtarët e vet t'i dërgojë ndërkohë. Nuk po besoj që është mirë që ne të shtyhem në Kuvend dhe ta nxjerrim në votim formimin e këtij komisioni.

Aleanca e ka vullnetin e mirë, për shembull, që krijohet një komision nëse është i domosdoshëm për hetimin e kujt do qoftë dhe në parim i kemi dhënë mbështetje. Por, nëse do të votohet sot dhe nuk do të përfilllet kërkesa e PDK-së që katër anëtarët e saj të propozohen ndërkohë, ne nuk do ta votojmë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë unë e nxjerr në votim propozimin, pa marrë parasysh që unë mendoj që është e vështirë kushtetutshmërisht të hyjë Komisioni Hetimor i Kuvendit në Presidencë. Besoj që ata çështjet e financave i kanë të vetat. Megjithatë, unë nuk kam asgjë, detyra ime është, meqenëse s'po doni të debatoni, ta qes në votim, edhe nëse e votoni, në rregull. Fatmir Xhelili e ka kërkuar fjalën.

FATMIR XHELILI: Faleminderit, nënkryetar!

Përshëndetje, të nderuar deputetë,

Besoj që dyshimet edhe shkrimet nëpër gazeta dhe gazetata si burim të keqpërdorimeve nuk duhet të merren shumë si serioze për të shkuar drejtpërdrejt në formimin e një komisioni hetimor, kjo është e para. Së paku si institucione serioze, posaçërisht Kuvendi si institucion serioz, së paku ishte dashur të bazohej në të dhënat e auditorit dhe në qoftë se në të dhënat e auditorit për menaxhimin e financave të Presidencës dhe Qeverisë kanë dyshime, atëherë është një bazë e arsyeshme për të formuar ndonjë komision hetimor.

E treta, Zyra Ligjore e Kuvendit duhet të interpretojë kushtetutshmërinë e kësaj kërkesë për hetimin e punës së Presidencës. Unë besoj që pa e dhënë Zyra Ligjore mendimin e vet, nuk do të ishte serioze ta dalë në votim. Faleminderit!

KRYESUESI: Po bëhem i tepërt, ndoshta, por unë s'kam qenë në mbledhjen e fundit të Kryesisë dhe nuk e di si ka ndodhur, por këto 40 nënshkrimet neve na detyrojnë ta fusim në diskutim dhe të respektohet kërkesa e 40 nënshkruesve. Tani, për secilin variant unë nuk kam kompetenca as ta ndal, as ta shtyj. Ndoshta, zgjidhjen më të mirë e bëjmë së bashku. Tash janë paraqitur mjaft deputetë për të diskutuar dhe mirë është të diskutojmë pak rreth kësaj çështjeje dhe pastaj po e votojmë ose e shtyjmë për një ditë tjetër. Fjalën e ka zoti Ilir Deda!

ILIR DEDA: Faleminderit!

Mendoj që është e qartë që edhe me Kushtetutën e Kosovës Kuvendi ka të drejtë të themelojë komision hetimor për çdo çështje, e cila është në interes publik. Shpenzimi i parave publike nga Qeveria dhe nga Zyra e Presidentit është në interes publik dhe nuk ka nevojë këtu të ketë debat, sepse asnjë hap nuk është kundër Kushtetutës, nuk është sulm, ashtu qysh po e përjetojnë disa miq të kryetarit të Kosovës. Thjesht, është një iniciativë e 40 deputetëve në përputhje me Kushtetutën që të themelohet komisioni parlamentar dhe nuk ka çka të fshihet këtu. Prolongimi i krijimit të këtij komisioni hetimor na bënë të dyshojmë a ka dikush të fshehtë diçka.

Nëse janë dhënë miliona euro për lobim të Kosovës, ne duhet të dimë a janë mbërritur qëllimet e shpenzimit të parave të qytetarëve të Kosovës. Edhe, zoti Xhelili, nuk ka nevojë fare Zyra Ligjore e Kuvendit të japë mendim, sepse Kuvendi e mbikëqyr çdo institucion i cili shpenzon paratë publik dhe ju kisha lutur, kolegë nga PDK, që të mos bëni obstrukcion në këtë rast, njëjtë si po bëni obstrukcion në lidhje me themelimin e Komisionit Hetimor Parlamentar për çështjen e grabitjes dhe përzënies të gjashtë qytetarëve turq që kanë qenë në Kosovë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Hadërgjonaj e ka fjalën.
Fatmir Xhelili, replikë!

FATMIR XHELILI: Faleminderit, nënkryetar!

Nuk është çështja te obstrukcioni, është çështja te serioziteti. Ne jemi duke hyrë në një fazë shumë të rëndësishme të bisedimeve me Serbinë, edhe propaganda e Serbisë, e mbështetur prej financave të Serbisë, ju keni lexuar nëpër shtyp çfarë financa përdor Serbia për lobim, gjegjësisht kundërlobim për Kosovën, e ju tash po doni të hyni të shpalosni diçka që ato janë minore në krahasim me financat që i shpenzon Serbia dhe shtetet e tjera.

Me këto isha pajtuar lehtë me juve sikur këto t'i kishim trajtuar pas përfundimit të këtij procesi. Unë nuk e di edhe sot a kemi ne të drejtë të bëjmë një hetim të tillë apo jo, se megjithatë institucioni i Presidentit dhe i Qeverisë, në këtë drejtim që po e cekni, veç për lobim, është pak më e ndjeshme dhe pak më delikate se sa që ju me lehtësi po e përshkruani dhe po mundoheni çdo gjë që ta devalvoni dhe ta sillni në pika të dyshimit për të mos munden njerëzit të funksionojnë si duhet.

Edhe unë jam personalisht, por edhe grupi parlamentar shumë adhures i asaj që të hetojmë diçka kur ka elemente të dyshimit të bazuara që po keqpërdoren, mirëpo vetëm për marketing të brendshëm politik, për ta krijuar një komision të tillë në këtë periudhë kohore, besoj që është e dëmshme për Kosovën, e më së shumti për këto dy institucione që kanë për të funksionuar në këtë bazë dhe kurrë Kosova nuk ka pasur nevojë më shumë për lobim se sa në këtë periudhë kohore.

KRYESUESI: Faleminderit! Mirë, zoti Deda, kundër-replikë!

ILIR DEDA: Ne, zoti Xhelili, nuk po e prejudikojmë keqpërdorimin, ne duhet të shohim 5,10, sa para milionë janë dhënë në emër të lobimit nga Ministria e Jashtme e Kosovës, të cilat janë bartur në Presidencën e Kosovës. Duhet të shohim a i kanë mbërritur rezultatet, sepse janë para të Kosovës. Edhe nuk ka të bëjë fare kjo me Serbinë, sepse dialogu me Serbinë nuk i ka mbetur një njeriu. Dialogun me Serbinë do ta udhëheqë shteti i Kosovës dhe është e ndarë çështja e hetimit të shpenzimit të parave publike nga Ministria e Punëve të Jashtme, Qeveria e Kosovës dhe Presidenca prej dialogut me Serbinë, gjë të cilën ne po mundohemi të mbërrijmë konsensus dhe është proces i ndarë arritja e konsensusit për dialog me Serbinë prej kësaj çka po flasim ne sot. Në emër të asgjëje nuk mund të prejudikohet një konkluzion i caktuar dhe të thuhet ai deputet...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Hadërgjonaj e ka fjalën!

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar deputetë,

Për mua si anëtare e Komisionit për Buxhet që nga viti 2004 dhe si deputete për pesë mandate në këtë Parlament më duket shumë absurde një kërkesë e tillë për formimin e një komisioni të tillë hetimor, në këtë mënyrë qysh është kërkuar në këtë rast.

Grupi Parlamentar i LDK-së ka mundur të kërkojë një debat parlamentar dhe të debatohej për shpenzimet e bëra në fushën e tillë për lobim për Republikën e Kosovës. Ne në vazhdimësi nga Qeveria, që nga viti 2010, siç është në kërkesë, ne kemi pasur këtu raportet financiare dhe i kemi parë në detaje të gjitha shpenzimet, çka është shpenzuar në të gjitha programet, të cilat janë paraparë në buxhet. Ne i kemi pasur edhe të gjitha raportet e auditorit dhe nuk kam parë në raportet e auditorit ndonjë shkelje, e cila ka kërkuar një hetim të veçantë në këtë fushë. Unë jam shumë për transparencë dhe llogaridhënie, nuk ka mundësi asgjë që të fshihet në kuadër të buxhetit të Republikës së Kosovës, për arsye se ka ligje, ka rregulla, në bazë të të cilave bëhen shpenzimet e buxhetit.

Do të isha e pajtimit dhe unë që të shkojmë në formimin e komisionit sikur të kishim material përpara, sikur të kishim mundësi t'i kishim, ne kemi mundësi të kërkojmë raport të shpenzimeve, kemi mundësi t'i shqyrtojmë raportet e auditorit dhe kemi mundësi të kërkojmë nga auditori një herë ta bëjë një raport të performansës për programet e tilla, të cilat kanë shkuar në drejtim të lobimit për Republikën e Kosovës, dhe kur të shohim raportin e performansës në këtë drejtim, atëherë ne mund ndoshta të vijmë deri te një përfundim që duhet të bëhet një komision hetimor, mirëpo ndoshta edhe në bazë të atij raporti të performansës së auditorit, atëherë vijmë në përfundim që s'ia vlen të bëhet një komision i tillë hetimor, sepse ndoshta nuk ka të gjetura. Kush do të hetojë efektshmërinë e shpenzimit të mjeteve në këtë komision hetimor që po u caktuara tash, pa e bërë një raport të performansës nga Auditori i Përgjithshëm, që është institucion shumë kredibil në Kosovë. Nëse ne duam të bëjmë raport hetimor, thjesht sa për të thënë që e bëmë një raport dhe nëse duam që aty t'i dërgojmë disa njerëz dhe të marrin mëditje, ndoshta administrata mund të na tregojnë edhe sa kushtojnë këto komisione hetimore, sa shpenzime marrin këto komisione hetimore? Sepse, këtu njerëzit për ta marrë një mëditje janë në gjendje dhjetë komisione hetimore t'i formojnë.

Prandaj, të jeni të kujdesshëm që të qartësohen gjërat paraprakisht, të kemi shënime të nevojshme paraprakisht, t'i kemi të dhënat nga institucionet përkatëse, të cilat e kanë pasur fondin për lobim në Republikën e Kosovës dhe tek pastaj, në bazë të këtyre, të ngremë edhe komisione hetimore, në rast se ka nevojë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Më lejoni, që në emër tuajin edhe timin ta përshëndes një mik të veçantë, që është sot i pranishëm me neve, zotin Zhan Klod Bartolome, ish-kryetar i Asamblesë Nationale të Republikës së Francës, mikun e madh të Kosovës.

(Duartrokitje në sallë)

Faleminderit për vizitën dhe ju urojmë ditë të mbara dhe suksese në misionin tuaj në Kosovë. Zenun, edhe ty të përshëndes! Mirë se ke ardhur!

Fjalën e ka Arbër Rexhaj nga Vetëvendosje.

ARBËR REXHAJ: Faleminderit, kryesues!

Këtu çka munda të vërej në fillim ishte që deputetët e Partisë Demokratike të Kosovës thirreshin në votimin e çështjeve të tjera për ta votuar këtë çështje. Ndërsa, pas këtyre debateve po del që ata janë bllokuesit kryesorë që të mos votohet Komisioni Hetimor Parlamentar në lidhje me shpenzimin për lobimin e Presidencës dhe Qeverisë.

Në fakt, shpenzimi i parasë publike është çështje publike, është çështje që i intereson edhe publikut dhe nëse ka vullnet Kuvendi për ta hetuar, këtu nuk ka asgjë të keqe, sepse ne përherë

thirremi në transparencë. Me sa e di unë, presidenti i Republikës së Kosovës, ne e dimë edhe mënyrën se si është zgjedhur dhe se megjithatë është zgjedhur në këtë Kuvend. Kosova është Republikë parlamentare, presidenti është zgjedhur me votat e PDK-së dhe me votat e LDK-së, me shumicën e votave të dy partive. Në fakt, duke pasur parasysh që Hashim Thaçi ka qenë njëri prej aktorëve kryesorë deri vonë në politikën kosovare, ka qenë kryetar partie, në njëfarë forme PDK-ja duhet të thotë “Po, ne po e bllokojmë këtë proces, sepse nuk po dëshirojmë të hetohet presidenti”. E ne si parti opozitare pastaj mund ta kuptojmë në njëfarë forme kauzën e tyre.

Por, është oportunitizëm të thuhet “ne duam të hetohet, në emër të demokracisë dhe transparencës po e lejojmë këtë gjë”, por duke iu drejtuar një subjekti politik me kërkesën që duhet votuar një pikë tjetër.

U tha këtu që ditët në vazhdim do të jenë ditë të dialogut në mes Kosovës dhe Serbisë dhe u përmend edhe imazhi i presidentit dhe i kryeministrit. Sa herë që këtu deputetët flasin në lidhje me keqpërdorime, menjëherë ekziston ky diskursi që në emër të Serbisë të mbulohen edhe keqpërdorimet eventuale. Po flasin, sepse ky komision do ta bënte në njëfarë forme edhe një raport që do t’ia prezantonte këtij Parlamenti. Prandaj, nuk ka asgjë të keqe, derisa AAK-ja i dha emrat, sepse këtu po parashihet që të hetohet edhe Qeveria e Republikës së Kosovës, edhe pse po mungon këtu, nuk ka asgjë të keqe që në këtë mes të hetohet edhe presidenti. Pse të mos hetohet presidenti dhe pse po ka një hezitim dhe një bllokadë nga ana e deputetëve të PDK-së?

Çështja kryesore, ose pyetja themelore, në fakt pyetja retorike që duhet shtruar është kjo: Pse PDK-ja po e bllokon krijimin e këtij komisioni hetimor për presidentin dhe Qeverinë e Kosovës, në fakt, me thelbin kryesor të saj, për presidentin? Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Rexhaj! Fjalën e ka zoti Muharrem Nitaj.

MUHARREM NITAJ: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Kam përshtypjen që dikush qëllimisht po do ta komplikojë situatën më shumë se sa që është e komplikuar.

Nuk po dua të flas për arsyet e krijimit të këtij komisioni hetimor, ose jo. Unë personalisht vlerësoj se nuk ka asgjë të keqe, nëse shtrohet domosdoja e krijimit të një komisioni hetimor. Unë e dëgjova shefin e Grupit Parlamentar të PDK-së, zotin Krasniqi, i cili kërkoi kohë për të parë nëse do t’i hiqen atij dilemat se ky komision mund të jetë në kundërshtim me Kushtetutën dhe për të propozuar katër kandidatë. Tani unë ju kërktoj juve, nuk është çështje e lobimit të presidentit, ose të Qeverisë a kryeministrit dhe e javës së fundit, ka shumë vjet, për shembull, që, nëse mund të shprehem figurativisht, gropohet në këtë plan, prandaj pritni edhe një javë dhe të shohim nëse Partia Demokratike e Kosovës po e bllokon krijimin e këtij komisioni, ose jo. Insistimi që me çdo kusht të votohet sot, unë po shoh që nuk do të prodhojë rezultat.

Prandaj, të mos humbim kohë sot, ta presim javën tjetër nëse PDK-ja do t'i dërgojë anëtarët e vet në këtë komision dhe të shohim nëse edhe Lista serbe do të jetë pjesë e tij, ose jo. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Sherifi e ka fjalën.

BILALL SHERIFI: Faleminderit, kryesues!

Mendoj se është mirë ta shohim këtë si një qasje në dokumente zyrtare si komision, jo si deputetë veç e veç, sepse në këto dokumente secili deputet mund, ka të drejtë ligjore, të shkojë dhe të kërkojë që t'i shikojë. Mos e shihni këtë si, së paku unë kam dëshirë të mos e shohim, ashtu si një hetim, por si një veprim të përbashkët të të gjitha partive përmes një komisioni, ku do t'u qasemi atyre dokumenteve bashkërisht dhe në vend të një konkludimi të secilit deputet veç e veç, se çfarë paska ndodhur, do të shohim së bashku të gjithë dhe ta bëjmë një interpretim të përbashkët, se a janë përdorur ato para konform ligjit, a kanë shkuar në destinimin për të cilin janë kontraktuar dhe nuk po besoj se ka ndonjë arsye dikush më shumë e dikush më pak të shqetësohet.

Unë nuk do të hyj në motivet, arsyet, e cilësdo parti tjetër që nuk dëshiron të votojë, nuk dëshiron të japë emrat. Është në të drejtën e tyre të japin sqarime, herë kontradiktore, herë koherente, sepse përderisa një herë na u tha "ende s'i kemi emrat", tash po del se janë kundër. Është në rregull, secila parti ka të drejtë edhe të jetë kundër, të ketë argumentin e vet, të ketë pozicionin e vet, asgjë s'ka të keqe. Por, po, këtu kemi problem kushtetues. Nëse në njërin anë Kushtetuta të ofron të drejtën që me automatizëm të krijosh një komision hetimor për të hetuar një çështje, në anën tjetër ajo e drejtë menjëherë të merret përmes vetëm një aktori të vetëm, i cili do të zgjidhte që të mos i dërgojë emrat në komision dhe komisioni nuk funksionalizohet. Pra, çfarë vlen një e drejtë kushtetuese, kur përmes një procedure tjetër të merret, duke mos i dërguar emrat.

Mendoj se këtu kemi problem, kemi telashe. Unë nuk di si zgjidhet kjo. Ndoshta, këta konstitucionalistët, nëse ka ndonjë në Kuvend, do të mund të na ndihmonin se si të dalim nga kjo situatë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka Vjosa Osmani.

VJOSA OSMANI: Faleminderit!

Lidhur me çështjen që tash e ngriti zoti Sherifi, po pak a shumë edhe ju, zoti kryesues, përveç faktit që kjo është kategori kushtetuese, në fakt kur e kemi hartuar Kushtetutën, kjo më së shumti ka qenë insistim i PDK-së, e cila atë kohë ishte para zgjedhjeve, ishte opozitë, madje në mënyrë specifike, insistim i zotit Jakup Krasniqi, që të futej një dispozitë e tillë... Urdhëro! Në atë kohë ka qenë PDK, ka insistuar në mënyrë që opozitës në të ardhmen të mos i mohohet e drejta për formimin e komisioneve parlamentare, përderisa të bëhen 40 nënshkrime.

Tani, neni 4 i Ligjit për hetime parlamentare sqaron se kur janë këto 40 nënshkrime, Kuvendi detyrimisht e formon këtë komision, por për ta sqaruar më tej, neni 7, pika 3, tregon se çka ndodh në rastet, kur ndonjë nga grupet parlamentare nuk i dërgon emrat. Pikërisht situata në të cilën jemi tani. Sipas këtij paragrafi, Kryesia i propozon Kuvendit përbërjen e komisionit në bazë të nominimeve të grupeve parlamentare, mirëpo në rast se një grup parlamentar nuk i përgjigjet kërkesës për të nominuar anëtarët e vet, atëherë Kryesia i propozon Kuvendit përbërjen nga nominimet e bëra nga grupet parlamentare dhe pozitat e panominuara mbeten të zbrazëta. Pra, kurdo që PDK-ja i bie pishman dhe vendos t'i bashkohet komisionit, mund t'i dërgojë emrat e tyre, përndryshe përderisa komisioni ka kuorum, neni 7, pika 3, e sqaron që Kuvendi detyrimisht duhet ta formojë atë në bazë të vullnetit të 40 nënshkruesve. Kjo sa i përket procedurës.

Lidhur me përmbajtjen e kërkesës sonë, çfarë dëgjuam sot nga anëtarë të Grupit Parlamentar të PDK-së është saktësisht shpërfaqje e frikës dhe e pasigurisë së ish-partisë të presidentit Thaçi, që de facto po bie të jetë edhe parti aktuale e tij dhe çfarë dëgjuam tjetër, është që pikërisht në Ditën Botërore të Lirisë së Shtypit bëhen akuza për mediet kosovare, se kinse po financohen nga Serbia. Pse? Për shkak se ato medie thjesht kryejnë punën e vet duke publikuar një letër nga zoti Xhefri Najs, ish-prokuror, emrin e të cilit e dini të gjithë, i cili tregonte se ishte paguar nga zoti Thaçi për punë të cilat, në fakt, nuk do të duhej të shpenzohej Buxheti i Republikës së Kosovës.

Pra, këtu nuk është qëllimi të definohen vetëm shifrat, ku shkuan ato shifra, por qëllimi është të definohet dhe të vendoset të hetohet si duhet nga ky komision në qoftë se ka pasur devijim të qëllimit të atyre mjeteve të lobimit. Askush në Republikën e Kosovës, duke e njohur rëndësinë e fuqizimit të subjektivitetit ndërkombëtar të shtetit tonë, sidomos në këtë periudhë, nuk është kundër që të shpenzohen mjete për lobimin për Kosovën, por jo për lobim për individë të caktuar, të cilët dëshirojnë një imazh të cilin në fakt nuk e kanë ndërkombëtarisht. Dhe, ne edhe në qoftë se një mijë komisione i formojmë sot, nuk mund t'ia prishim presidentit imazhin aq sa ia ka prishur ai vetvete me veprimet e tij.

Kështu që, mos keni frikë! E vetmja gjë që ky komision do ta bëjë, do të hetojë se ku shkuan këto lobime, duke i mbajtur informatat e ndjeshme lidhur me lobimin në raport me shtetet e tjera të klasifikuara. Komisioni ka të drejtë të mbajë edhe takime me dyer të mbyllura, në qoftë se kjo është në interes të Republikës së Kosovës, por assesi për të mbrojtur interesat individuale të njerëzve, të cilët, ndoshta, pra vetëm është supozim në këtë moment, por do ta vërtetojmë, kanë shfrytëzuar mjetet nga buxheti i Republikës së Kosovës për të mbrojtur apo për të ndërtuar profile politike dhe për të rishkruar historinë. Edhe vetë kryeministri i Kosovës, zoti Haradinaj, i ka quajtur para disa ditësh në këtë Kuvend këto “para në të zezën”. Tash ka ardhur koha që “të zezën” ta bëjmë “të bardhë” para publikut kosovar, para këtij Parlamenti dhe të dihet në qoftë se vërtet ka pasur keqpërdorim të këtyre mjeteve të lobimit, apo janë shfrytëzuar sipas destinimit të tyre fillestar, pra për atë që Kuvendi i Kosovës në fakt i ka miratuar, për të mbrojtur interesat e Kosovës dhe për të fuqizuar subjektivitetin ndërkombëtar të shtetit tonë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Krasniqi e ka fjalën.

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit, zoti kryesues!

Unë pak po habitem! Ndoshta, disa prej parafolësve i ka munduar buka, se hëngrëm drekë pak vonë dhe s'janë të koncentruar, nuk po dëgjojnë çka po flas.

Mirë është nëse mund t'ua jepni transkriptin e fjalës sime, ndoshta duke lexuar do të jenë më të koncentruar dhe do të shohin se unë thjesht shpreha rezervat e mia për përputhshmërinë me Kushtetutën të këtij komisioni. Dhashë arsyet pse dhe nuk thashë “mos e votoni”, ju s'e nxorët në votim. Votoni, votat i keni. Shpreha qëndrimin tim dhe thashë që sot s'i kemi emrat. Unë e di ligjin dhe për atë arsye thashë që emrat mund t'i dërgojmë në ndërkohë. Transkriptin merreni, lexojeni, e nëse doni kështu të merreni me manipulim, është tjetër.

Tjetra, sa i përket presidentit të Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, ai ka qenë kryetar i partisë sonë dhe ne mburremi me periudhën që ai e ka udhëhequr PDK-në dhe Kosovën dhe në asnjë rast, në asnjë formë, as nuk distancohemi, as Zoti na ruajt, të kemi ndonjë rezervë ndaj tij. Ne kemi moral politik, nuk jemi, zonja Osmani, sikur ju, e lëshoni Fatmir Sejdiun, siç ia keni bërë për Isa Mustafën, e tashti e lëshoni edhe Isa Mustafën për çka di unë çka. Ju mundeni, liderët tuaj, që keni pasur të kaluarën e që keni bërë “gjithçka” për ta, më vonë edhe t'i tradhtoni, edhe të dilni kundër tyre, është e drejtë juaja. Unë e kam dertin që ju më shumë realisht këtë komision e keni për ta dëmtuar Isa Mustafën, sepse presidenti Thaçi është bërë president qe nja një vit dhe Presidenca nuk merr vendime për këto çështje, i merr Qeveria. Dhe, ju dertin e keni se plus Qeveria e zotit Haradinaj i ka shtatë-tetë muaj, nuk besoj as që kanë pasur kohë të merren me këtë pjesë. Në fakt, nëse bash doni të merreni me këtë punë, ju keni punë me kryetarin e partisë suaj, atë që s'e ke votuar as për kryeministër. Domethënë, atë që ia keni prishur edhe Qeverinë duke mos ia votuar demarkacionin e faleminderit, sot e keni votuar.

Kështu që, lëreni demagogjinë, se jeni të tejdukshëm, të tejdukshëm. As këta njerëz që u mundove t'u flasësh më nuk të besojnë. Thoni po duam të bëjmë për këtë arsye, ose atë arsye, është e drejtë juaja, po jua jep Kushtetuta, po jua jep ligji, votoni pro. Unë krejt çka ju thashë, thashë veç të votojmë pro – kundër. Edhe deputetët e PDK-së disa do ta votojnë pro, disa kundër, dikush abstenon, është e drejtë e tyre. Mendimet disa prej tyre i thanë, unë flas në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së dhe unë në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së jua dhashë rezervat dhe ju thashë se sot s'i kam emrat. Duhet të diskutojmë, të shihet kush ka më shumë interesim prej deputetëve tanë të jetë pjesë e këtij komisioni dhe pikërisht, s'ke nevojë të na i citosh ligjet, ne i lexojmë nganjëherë, nganjëherë më shumë, nganjëherë më pak, e di që kam të drejtë t'i dorëzoj emrat përmes sekretarisë në Kryesi edhe nesër, edhe të hënën. Edhe nëse e votoni, ky s'fillon punën sot, as nesër, besoj javën tjetër mund të mblidhet. Para se të mblidhet, ne edhe mund t'i dërgojmë emrat, në asnjë rast s'ju thashë se po e bllokojmë, as se po e bojkotojmë. Faleminderit, që prapë kjo trauma e PDK-së nuk ju paska lëshuar.

Ne vërtet jemi bërë veç 23 deputetë, ju ende po na shihni si të ishim 40. Po thoni “po e bojkoton”, “po e bllokun”, “po e bllokun”, s’po mund ta bllokojmë, t’i kishim 40 është pak më lehtë, me 23 s’ma merr mendja që bash mund ta bllokojmë. Por, juve po e di që kjo trauma e PDK-së s’ju ka lëshuar dhe s’keni faj. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Replikë, zonja Osmani.

VJOSA OSMANI: Tash ky diskutuesi paraparak vetëm e dëshmoi atë që e thashë edhe më herët, që de facto akoma Hashim Thaçin e keni kryetar partie. Besoj që çka fole, të dëgjojë edhe kryetari yt aktual, që është ulur aty prapa, për momentin. Kurse, sa i përket respektit që ne e tregojmë ndaj Fatmir Sejdiut e ndaj Isa Mustafës, mos na e mbaj asnjë dert, zoti Krasniqi, ne jemi më të bashkuar se kurrë, edhe me Fatmir Sejdiun, edhe me Isa Mustafën, pavarësisht faktit që ju po investoni goxha shumë që të na shihni ndryshe, nuk do ta shihni një situatë të tillë, as me logjikën dhe me gjuhën që ju po e përdorni, e që nuk i takon këtij Parlamenti. Kurse, lidhur me hetimet që do të bëhen, ju besoj se mburreni me veprimet e zotit Thaçi, mirëpo në qoftë se del që ato shpenzime janë përdorur për profilin e tij politik, për ta ngritur profilin e tij personal, e jo për të mbrojtur interesat e Republikës së Kosovës, atëherë do të dëgjojmë nga ju se sa mburreni ju për keqpërdorime, për shkelje të ligjit e për shkelje të tjera.

Sa u përket citimeve që i bëra, i bëra me kërkesë të deputetëve të tjerë, sepse kishte kërkesa për të sqaruar se çka saktësisht parasheh ligji në rastet kur një grup parlamentar nuk ka dërguar emrin.

Edhe, e fundit, shpresoj që e dëgjoni mirë një herë e përgjithmonë, nuk ka moment në karrierën time politike me të cilin ndihem më mirë se sa kur e kam kundërshtuar bashkimin me një parti si ju. Kurrë, kurrën e kurrës nuk do të dëgjoni pendim nga ana ime që kam votuar kundër bashkimit me PDK-në, mbaje në mend këtë. E ti, në çdo seancë mund të thuash “keni votuar kundër këtij e atij...”, por në fund të fundit u dëshmuva se...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Kundër-replikë, zoti Krasniqi.

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit! Unë besoj, do të kisha besuar sikur të kishe pasur konsistencë, ke mundur të mos jesh në kabinetin e Fatmir Sejdiut, kur po ashtu kemi qenë bashkërisht PDK-ja dhe LDK-ja, por ke qenë, edhe ke qenë bash bashkëpunuese. Mua më kujtohet, se edhe po e tregon atë, kur e kemi shkruar Kushtetutën, thuajse ti përnjëmend e ke shkruar ti Kushtetutën. E dimë ne kush e ka shkruar Kushtetutën.

Sido që të jetë, ne mburremi bre thashë me Hashim Thaçin dhe jemi shumë krenarë që ish-kryetari i PDK-së është kryetar i Kosovës sot dhe më vjen aq më mirë që e kemi votuar bashkë me LDK-në. Kemi pasur një koalicion të mirë, funksional, ka zgjatur sa ka zgjatur, ne e kemi bërë kryetarin tuaj kryeministër, ju e keni bërë kryetarin tonë president, presidenti tash është i krejt Kosovës, është edhe yti, është edhe imi, është i krejt qytetarëve, pavarësisht a e ke votuar apo jo, ai e përfaqëson unitetin e këtij vendi, ndërsa bindjet politike i ruajmë secili për vete. Por, veç bëhuni të sinqertë në ato që i thoni, mos manipuloni me opinionin.

(Ndërprerje e incizimit)

KRYESUESI: Fjalën e ka zoti Milaim Zeka.

MILAIM ZEKA: Faleminderit!

Unë s'po dua t'ia përmend emrin Vjosa Osmanit, po lëri, bre, le të shfryhen!

Së pari, unë s'po ju kuptoj, nuk po ju kuptoj PDK-në edhe LDK-në, jeni rrokur dy palët për pejgamberin tuaj, që është Hashim Thaçi. Hashim Thaçin qysh s'e ka ndalur bir nëne Skënderbeun që ka ardhur me kali deri në Krujë, hiç s'e keni ndalur ju. Ju keni qenë ata që e keni flladitur PDK-në me peshqir tërë kohën. Sa herë janë lodhur PDK-ja, kanë dashur të dhënë shpirti, ju e keni flladitur, ia keni kthyer shpirtin. Ju e keni zgjedhur Hashim Thaçin kryetar të këtij vendi edhe njerëzit, po e them këtu, e kam informacionin prej kolegëve të mi deputetë të Lidhjes Demokratike të Kosovës, kam nganjëherë përshtypjen që ata që e shajnë më së shumti Hashim Thaçin, si ai Bajram Geci, ata kanë qenë argatët më të mëdhenj, lobuesi më i mirë për t'u zgjedhur Hashim Thaçi president i këtij vendi, ndër lobuesit më të mëdhenj ka qenë pikërisht Bajram Geci, e para.

E dyta, duke përjashtuar deputetët e rinj të Parlamentit, të Lidhjes Demokratike të Kosovës, edhe disa të tjerë, që unë nuk i di, por disa që i di me emra e mbiemra, krejt këto procese ju i keni sjellë bashkërisht. Unë ju them vetëm diçka, po flas për një kundërshtar timin politik, jo kombëtar, që është Hashim Thaçi. Po atij, bash palla s'i ha a i ulet imazhi a jo, se ai krejt karrierën e vet e ka çuar në majë të qiellit. Çka ka dashur ka bërë, ju ka "dribluar" juve bash qysh ka dashur. U bë kryeministër, e ka shpallur pavarësinë, e ka lexuar Deklaratën e Pavarësisë këtu, hiç... krejt i 'ka dribluar' në Parlament. Fliste, veç i qitke duart kështu, ju bënte sehire, ju hipnotizonte. U bë president.

Krejt ato paratë, gjashtë milionë, me 'Saçi, Taçi', çka kanë qenë ato për lobim, gjashtë milionë që ia kanë dhënë një firme të Izraelit, krejt kanë qenë përgjegjësitë e Qeverive të kaluara. Unë dyshoj dhe dijeni që finalja, rezultati i këtij hetimi s' do të dalë kurrkah hiç, për arsye se ndërkombëtarët e kanë krijuar një ligj, i cili të lejon të vjedhësh ty, por veç të mos nënshkruash. E tash, në qoftë se dikush 'do ta hajë', siç e 'ka hëngër' drejtori i AKI-së dhe Shpend Maxhuni,

për deportimin e turqve, unë jam shumë i bindur që ata s'kishin guxuar në mënyrë absolute të bënin kurrjë pa u konsultuar me presidentin, po pa marrë parasysh, kjo është supozim dhe mbi bazën e supozimit ti s'mund ta dënosh kurrkënd.

Unë jam i bindur që kur të vijmë në fund të fundit, ndodh që më përpara 'do ta hajë' Behxhet Pacolli për ato para se Hashim Thaçi. Kështu që, unë po them edhe një herë, e ftoj Partinë Demokratike të Kosovës, sillni edhe ju kandidatët, ta bëjmë këtë farë hetimi, sepse puna nuk do të dalë kurrkund. Pse? Për arsye se ne kemi punë më të mëdha për t'i hetuar. Edhe një herë po them, kemi procesin e privatizimit ta hetojmë, e kemi procesin e Postë-Telekomit, procesin e KEDS-it ta hetojmë, kemi një milion skandale të tjera, kompanitë e sigurimeve t'i hetojmë, ato që po i plaçkitin mërgimtarët tanë kur vijnë nëpër kufij.

Kështu që, e dashur Vjosë, dy herë ta kam përmendur emrin, 4 minuta i fitove. Dil tash këtu në foltore dhe 'mshoi' zotit Krasniqi lirisht, dhe ky s'mërzitet fare për imazh, as unë s'mërzitem. Veç ta përfundoj fjalimin tim. Po të ishit ju të më bëni president si Hashim Thaçin me vota, gjithë ditën më shani, veç do të trashesha, hiç s'isha mërzitur, absolutisht.

KRYESUESI: Vjosa Osmani, replikë me Milaimin.

VJOSA OSMANI: Faleminderit, Milaim, për këtë mundësi që proceduralisht të përgjigjem në gënjeshtër të kulluara, që u përmendën më herët. Nuk më befason aspak, sepse e kam thënë në këtë Kuvend disa herë që PDK-ja e ka gënjeshtërën në gjen, sidomos individë të caktuar që sot thonë se kinse unë paskam bashkëpunuar me ta, e vërteta është që kurrë asnjëherë s'kam pasur bashkëpunim me ta, as kur kam punuar në zyrën e Presidentit, kur kam pasur pozitë këshilluese dhe jo pozitë vendimmarrëse në parti. Mirëpo, në momentin që e kam pasur atë pozitë vendimmarrëse dhe kam pasur votë këtu në Kuvend për ta përfaqësuar elektoratin e LDK-së e kam ngrehur, besoj drejt, zërin e tyre që të mos bëhemi bashkë me njerëz mashtrues sikur ju.

Tash këtë gjenin mashtrues dhe gënjeshtar, ju po e dëshmoni çdo ditë, por po ashtu më vjen mirë që e pranuat se me këtë logjikë mashtrimi e gënjeshtare keni arritur nga 40 deputetë në 23, e në mandatin e ardhshëm do ta keni pikëpyetje edhe kalimin e kuotës prej 5%, por atë që do ta keni edhe më të sigurt është se nuk do të gjeni partner. Pra, ajo që po ju ndodh vazhdimisht - nuk po gjeni partner. Askush nuk ju do. Askush nuk do të bashkëpunojë me ju. Prandaj, shikoni çfarë qeverie keni sot me 52 vota dhe çfarë po dëgjojmë këto ditë është zëri i pasigurisë, është zëri i frikës. E, tash këtë zë të frikës, ne do ta zbulojmë këtë frikë deri në fund, edhe me komisione hetimore, edhe me mjete tjera demokratike, që na e lejon Kushtetuta e Kosovës. Do t'u vijë fundi këtyre keqpërdorimeve për secilin cent që shtetit të Kosovës ia keni keqpërdorur për ta mbrojtur ju lëkurën tuaj. Ka marrë fund!

KRYESUESI: Faleminderit! Ajo e ka marrë replikën me Milaimin, e ka sulmuar Partinë Demokratike. Memli me Milaimin po duan replikë.

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit, zoti Milaim Zeka! Unë po të them faleminderit që ti s'the kurrë keq për partinë time, e çka s'the për partinë e Vjosës dhe ajo të falënderoi. Mirë, po e di edhe ajo që çfarë the edhe mund të jetë e vërtetë. Të kisha ftuar, zonja Osmani, unë ta përmend normal, të kisha ftuar për gjuhë parlamentare, nuk është fushata elektorale brenda LDK-së në Kuvendin e Kosovës, mund të dëshmoresh në ato tubimet tuaja të elektoratit tuaj, besoj edhe ata të njohin mirë. Ata të njohin mirë, e ke dëshmuar, është e vërtetë, e ke dëshmuar, s'të kanë lënë të hysh as në Kuvend, e ke dëshmuar, s'të kanë lënë as të kandidosh, ishalla të lënë herën e ardhshme, të paktën e provon. Por, është çështje e juaja e brendshme ajo. Se çka do të bëhet në mandatin e ardhshëm, ishalla e kemi shëndetin, e do ta marrësh vesh edhe ti, a kemi partner a s'kemi partner. Përndryshe, ju jeni e njëjta LDK, nuk keni ndryshuar shumë, keni me qenë LDK-ja e njëjtë, gjithmonë keni me qenë të dytët. Mos mendo që do të jeni të parët, gjithmonë do të keni qejf të lidheni me PDK-në, ne do ta shqyrtojmë kur të vijë koha edhe për herën e tretë mundësinë të ju marrim, ose jo. Nëse kemi përputhje programore, nëse s'kemi përputhje programore mund të vazhdojmë me partnerët që i kemi, ose e zgjerojmë. Por, sido që të jetë, asnjë gjë nuk e the. Të erdhi mërzi pse të thashë që kemi bashkëpunuar.

Unë kam qenë këshilltari Hashim Thaçi, ti ke qenë këshilltare e Fatmir Sejdiut, prandaj s'kemi pasur qare pa bashkëpunuar. A jemi takuar, a kemi ndërruar letra, a kemi çuar këtë, a atë a... s'kemi pasur qare pa bashkëpunuar, se kanë bashkëpunuar shefat tonë, Fatmir Sejdiu dhe Hashim Thaçi. Ti ke qenë këshilltare e atij, unë këshilltar i këtij, e kemi qenë edhe deputetë besa, por, sido që të jetë, bash më erdhi keq se shumë u nervozove. Mos u nervozo, mundohu t'i ruash nervat, të paktën thuaj disa argumente, jo veç “gënjeshtra”, “mashttrim”, “gënjeshtra”, “mashttrim”... Nuk m'u duk që të ka hije.

KRYESUESI: E mbyllim këtë histori. Të lutem! Zoti Naser Rugova e ka fjalën.

(Ndërprerje e incizimit)

NASER RUGOVA: Faleminderit, zoti kryesues!

Si duket, Kuvendi i Republikës së Kosovës si organi më i lartë ligjvënës i këtij shteti të ri, me mjaft sfida, me mjaft probleme, po vazhdon me një logjikë të çuditshme, po vazhdon me një kulturë të debatit që nuk është e nivelit të përfaqësuesve të popullit në Parlamentin nacional.

Tani, një kërkesë e 41 deputetëve duhet të ketë një trajtim pak më serioz, duhet të kultivojmë edhe dialog cilësor, edhe gjuhë parlamentare të pranueshme, por duhet ta respektojmë ulësen e gjithsecilit në këtë Kuvend, sepse dikush na ka zgjedhur. Unë konsideroj që ende nuk jemi në fushatë elektorale. Unë konsideroj që duhet të ruhem nga kualifikime që nuk i takojnë gjuhës

parlamentare dhe nuk përkojnë me rolin tonë si deputetë. Por, një gjë është më se e sigurt, është e drejtë kushtetuese e Kuvendit të Republikës së Kosovës që të formojë komisione hetimore, nën një. Nën dy, është ligji i cili e përcakton saktë rolin dhe kompetencat e një komisioni hetimor parlamentar. Nën tre, ky komision nuk heton individë, por heton organizata buxhetore dhe heton transparencë, njëherësh kërkon edhe llogaridhënie për shpenzimin adekuat, me vend apo jo adekuat dhe pa vend, të parasë publike. Dhe, nuk ka nevojë askush të shqetësohet, të frikohet, për epilogun e mundshëm të një komisioni hetimor parlamentar.

Unë jam shumë pro që ajo periudhë kohore 2010-2018, kur edhe Lidhja Demokratike e Kosovës ka pasur president, ka pasur ministër të Jashtëm një mandat, ka pasur dhe kryeministër, pse unë të dalë ballëhapur dhe pa kurrfarë ngarkese dhe them “po, edhe zyrtarët e lartë shtetëror nga partia ime të hetohen për punën apo mospunën e tyre dhe për shpenzimin e çdo centi, që quhet para publike dhe taksë e qytetarëve të Republikës së Kosovës”. Nuk po e kuptoj pse kjo mjegull, pse ky panik?

Dhe tani, të mos lëshohemi në interesa individuale, sepse jemi matur në zgjedhjet e fundit, jemi matur edhe në zgjedhjet lokale dhe unë ju përshtëndes nga bordi i grupit më të madh parlamentar dhe partia me votë më të madhe popullore. Prandaj, dërgoni emrat për këtë komision hetimor, të ecim bashkë edhe kur të bëjmë hetime, edhe kur formojmë komisione parlamentare, ta bëjmë bashkërisht, të mos ketë tendenca të njollosjes, së pari të institucioneve shtetërore të Republikës së Kosovës.

Për të gjeturat, për keqpërdorimet e mundshme, ju bëftë mirë atyre që i kanë destinuar dhe e kanë shpenzuar paranë publike për interesa, o individuale, o klanore a grupore. Prandaj, ne nuk jemi “poliklinikë” që ta shërojmë dikë nga kompleksi i frikës, por ejani në mënyrë transparente me një komision hetimor konform Kushtetutës dhe ligjit, ta bëjmë këtë hetim, për të cilin jo vetëm në mediet vendore, por edhe ato ndërkombëtare dhe me letra publike drejtuar edhe institucioneve kompetente të Republikës së Kosovës ka zëra për shpenzimin e miliona e miliona të taksapaguesve të varfër të Kosovës për destinime abstrakte dhe që nuk u dihet përfundimi.

Prandaj, kërkoj konsensus edhe kur formojmë komisione hetimore, sepse, shikoni, si partnerë të koalicionit qeverisës keni ngelur pak dhe kur të duam e bllokojmë punën e këtij Kuvendi. A është në interes të shtetit dhe të qytetarëve të Kosovës, të forcimit dhe të përfundimit të etapave të shtetndërtimit? A është interes që të ndërpritet puna e organit më të lartë legjislativ konform kërkesave që i kemi për proceset integruese? Jo!

Prandaj, shitja e fudullëkut ndaj grupit më të madh parlamentar rezulton me një bllokadë të institucioneve shtetërore të Republikës së Kosovës. Po bëj apel kolegial që të ecim tutje për çështje konsensuale, përndryshe gjithsecili e merr rrugën e vet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Kujtim Shala e ka fjalën.

KUJTIM SHALA: Faleminderit, zoti kryesues!

Po përpiqem të flas pak më teknikisht.

Unë besoj se gjithë ky debat po ndodh për shkak të identifikimeve politike, që s'do të duhej të bëheshin, sepse ne e kemi përpara një kërkesë kushtetuese, kemi të bëjmë me kategori kushtetuese dhe me kërkesa ndaj institucioneve kushtetuese.

Do të saktësoj që edhe Kryesia e Kuvendit e ka trajtuar këtë kërkesë. Kërkesa është në përputhje me Kushtetutën, nenin 77, me nenin 71 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe Ligjit për hetim parlamentar, neni 176.

Tani, ta kini parasysh, Qeveria dhe presidenti, ose kryeministri dhe presidenti, si funksione shumë të rëndësishme janë derivate të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Çka do të thotë kjo? Jo që Kuvendi i Republikës së Kosovës vendos për ta, por mund t'i bëjë objekt të punës, ashtu siç e përcaktojnë Kushtetuta dhe Rregullorja. Dhe, kërkesa për këtë komision ad hoc që do të ketë natyrë të përkohshme të një komisioni parlamentar funksional, që quhet hetimor, është i kësaj natyre.

Tani, shihni te Rregullorja, neni 71, pika 2, kur Kuvendi e identifikon një çështje të rëndësishme së veçantë, në këtë rast identifikim quhen firmat e deputetëve, e autorizon komisionin ad hoc për ta ftuar secilin zyrtar të Kosovës që e sheh të arsyeshme për të dëshmuar para komisionit. Do të thotë secilin zyrtar, pavarësisht funksionit që ai ka. Kërkesa që të hetohet, ose që të trajtohet kjo temë përfshin dy institucione, Presidencën dhe Qeverinë. Kjo nuk do të thotë vetëm presidentin dhe vetëm kryeministrin, por dy institucione me mekanizmat e tyre. Unë pajtohem që si objekt kështu si është formuluar është pak i gjerë, por puna e komisionit mund ta reduktojë, mund ta përqendrojë dhe të shohim pastaj çfarë do të dalë.

E çka do të ketë në fund? Një raport të këtij komisioni për Kuvendin e Kosovës, për seancën, dhe ai raport do të debatohet dhe pastaj seanca do të vendosë me votë për të gjeturat e mundshme të raportit dhe për rekomandimet e mundshme.

A e implikon kjo Qeverinë? Patjetër! Por, jo ashtu siç po thoni ju, as si emra të ish-kryeministrave, as si përfaqësues të partive politike, sepse si logjikë, e para, vendimet e Qeverisë janë kolektive dhe, e dyta, për çfarë vendos Qeveria? Për fondin, asgjë tjetër dhe gjithmonë në përputhje me mandatin që ka, në përputhje me Ligjin për Buxhetin të atij viti, edhe kur kërkohen fonde shtesë. E atëherë, nëse Qeveria vendos për fondin, çka po kërkohet këtu të hetohet? Jo fondi si i tillë dhe jo procedura e dhënies, nëse duhet edhe procedura e dhënies, por mënyra e shpenzimit të atij fondi.

Domethënë, si çështje kur e shpjegon kështu në planin ligjor është relativisht e thjeshtë dhe është normale. Në anën tjetër, ato 40 firma të deputetëve na detyrojnë që ne ta krijojmë këtë komision. Një komision, i cili do të bëjë një raport, rezultatin e të cilit nuk e dimë. Ka indice për kërkim, ose për hetim, ka edhe raportime publike, duhet të merren seriozisht. Nëse rezultati që lidhet me to s'është serioz, evidentohet, dhe ecim më tutje.

A duhet ne ta themelojmë sot këtë komision? Unë besoj që e kemi detyrim kushtetues që ta themelojmë, por nuk kanë subjektet politike detyrim kushtetues që t'i dërgojnë sot anëtarët. Mund t'i dërgojnë pastaj me shkrim, mund t'i bashkohen komisionit. Nëse ka ndonjë subjekt i cili vendos që të mos dërgojë anëtarë, domethënë s'e ka vullnetin që të përfshihet këtu, mjafton që ai komision ta ketë shumicën, të ketë kuorum dhe ai do të funksionojë edhe pa ta. Në fund, raporti i mundshëm i këtij komisioni nuk i përjashton as subjektet të cilat nuk bëhen pjesë e këtij procesi, sepse do të përfshihen në debatin dhe, në fund, në vendimmarrjen që ka të bëjë me këtë punë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Hoti, e kërkoje prapë fjalën, apo gabimisht e shtype? Atëherë, si ushtrues i kërkesës, ke të drejtë të flasësh. Po e hedhim në votim, a ka deputetë?

AVDULLAH HOTI: Faleminderit, kryesues!

Kërkesa jonë ka qenë e thjeshtë, e bazuar në Kushtetutë, në Rregulloren e Kuvendit dhe në Ligjin për hetim parlamentar.

Unë besoj që debati që u bë ishte komplet i pavend. Është e drejtë kushtetuese e 40 deputetëve të nxisin themelimin e këtij komisioni hetimor.

Dëshiroj ta citoj letrën që Xhefri Najs, ish-prokuror në Gjykatën e Hagës, ia ka dërguar zyrtarit të lartë, shefit të stafit të kryeministrit Haradinaj, ku i thotë që nuk po përmbushen kushtet e kontratës së nënshkruar ndërmjet Qeverisë së Kosovës dhe kompanisë së tij, kanë ndaluar pagesat e faturave që ky ka dërguar në Qeverinë e Kosovës dhe, ndërmjet tjerash, diku në letrën këtu që është publike, ai thotë që “më keni kërkuar të jem këshilltar i juaji, më keni ofruar kushtet, termat financiare, me të cilat unë jam dakorduar, më keni kërkuar të kryej punë për juve, kam kryer vazhdimisht punë për juve. Keni kërkuar të organizoj ligjërata në qytete të ndryshme për presidentin Thaçi dhe për ministrin e Jashtëm atëherë, Enver Hoxhaj, dhe kam organizuar”. Thotë, “Bile, me kërkesë tuaj i kam ndihmuar edhe autorët e biografisë të presidentit Thaçi”. “Me kërkesë tuaj” thotë, “i kam ndihmuar edhe autorët e biografisë me materiale dhe me gjëra tjera”. Krejt janë publike në këtë letër të Xhefri Najs drejtuar Avni Arifit në Qeveri, që është publikuar në gazetën Exspres.

A nuk janë këto dyshime të mjaftueshme për devijim të qëllimit të shfrytëzimit të parasë publike? Askush nuk është duke e kontestuar qëllimin që ne të shpenzojmë milionë për ta

konsoliduar shtetësinë e Kosovës në arenën ndërkombëtare, por nëse edhe një cent i vetëm ka devijuar nga ky qëllim, a nuk duhet t'i brengosë të gjithë deputetët e Kuvendit të Kosovës? Janë taksat e qytetarëve të vendit.

Unë kërkoj që të procedojmë në bazë të Rregullores, ta themelojmë këtë komision, le ta fillojë punën, le ta bëjë raportin. Raporti do të vijë prapë këtu në Kuvend dhe pastaj do ta debatojmë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Besoj që i fundit është Driton Selmanaj.

DRITON SELAMANAJ: Faleminderit, kryesues!

Unë po provoj t'u bashkohem pak interpretimeve teknike të neneve të Ligjit për hetim parlamentar. Mendimi im personal është që kjo çështje s'ka nevojë të shtrohet fare për votim.

Pse po e them këtë? Sepse, paragrafi 3 i nenit 4 të Ligjit për hetim parlamentar thotë kështu: "Në rastet kur kërkesa për themelim të komisionit parashtrohet nga 1/3-ta e deputetëve, Kuvendi detyrimisht në seancë plenare e themelon komisionin e kërkuar për çështjen e caktuar". Më pas, neni 4, pika 4 thotë: "Në rastet e iniciativës nga një komision i përhershëm parlamentar, ose grup deputetësh që përbëjnë më pak se 1/3-tën e anëtarëve të Kuvendit, atëherë Kuvendi vendos me shumicë të thjeshtë të votave për ngritjen e këtij komisioni".

Dhe, interpretimi im është, meqenëse thotë "detyrimisht duhet të themelohet", nuk ka nevojë të shtrohet në votim, sepse s'mund t'i detyrosh deputetët të votojnë, sepse kjo bie në kundërshtim me mandatin e lirë të deputetëve më pas. S'mund t'u thuash "dilni në votim dhe detyrimisht themeloheni këtë, detyrimisht jepeni votën pro". Nuk është kjo, sepse kjo e shkel një normë tjetër kushtetuese, që është mandati i lirë i deputetit që voton si të dojë, për, kundër, ose abstenim.

Vlerësimi im është që për këtë çështje mjaftojnë emrat që i kanë dërguar partitë politike dhe të konsiderohet i themeluar. Nëse ata nuk i kanë dërguar, konsiderohet që kurdo që janë të gatshëm ta plotësojnë këtë. Në të kundërtën, nuk ka logjikë që t'i detyrojë deputetët që ta japin votën për. S'ka mundësi kjo.

Prandaj, unë po ju lus që nëse keni paqartësi ta zgjidhni kështu, sepse nuk ka kuptim tjetër. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deri tash, të gjitha komisionet, pa marrë parasysh që kanë qenë me kërkesa të tilla, ne i kemi themeluar me votim. Ne nuk kemi në sallë kuorumin e duhur për të votuar. Besoj që në seancën e radhës do të votohet. Në qoftë se ka interpretim tjetër, ka mekanizma të tjerë, mund të bëni ankesë, nëse unë kam bërë shkelje në këtë rast. Jam koshient

në atë që e thatë edhe tani ju zoti Selmanaj, edhe në ato që u thanë më herët. Mendimi im është imi, por ajo praktika që ka qenë deri tash është kjo, dhe unë s'mund t'i ik asaj.

Kryetari qenka këtu, në qoftë se s'është dakord unë ia lëshoj vendin për ta ndryshuar praktikën, por praktika deri tash ka qenë kështu. Nëse e ndryshojmë praktikën, po e lëmë për mbledhjen e ardhshme.

Kryesia e cakton seancën e ardhshme. Konsideroj që kjo seancë ka përfunduar. Faleminderit!

* * *

E premte, 1 qershor 2018

Vazhdimi i mbledhjes plenare, e filluar më 3 maj 2018

Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI:

4. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Traktatit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Hungarisë për ekstradim

Të nderuar deputetë,

Komisioni Funkcional për Legjislacion e ka shqyrtuar Projektligjin për Ratifikimin e Traktatit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Hungarisë për ekstradim dhe Kuvendit i ka rekomanduar mos miratimin e tij. Nuk po e lexoj gabim mos miratimin e tij, kjo është. Jo tash, do të shkojmë, vetëm se më befaso! s'e kam vërejt më herët. Ftoj ministrin e Drejtësisë, zotin Abelard Tahiri që ta paraqesë dhe arsyetojë projektligjin, pastaj e ka komisioni fjalën.

MINISTRI ABELARD TAHIRI: I nderuari kryetar i Kuvendit!

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Më lejoni që të paraqes para jush kërkesën për miratim të Projektligjit për Ratifikim të Traktatit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Hungarisë për Ekstradim.

Kjo kërkesë është e bazuar në aspiratën dhe zotimin e Republikës së Kosovës që të zhvillojë partneritet evropian që të kontribuojë në afirmimin e vlerave evropiane, bashkëpunim bilateral dhe rajonal duke luftuar krimin transnacional dhe duke stabilizuar edhe më tej zonën e Evropës Juglindore. Qëllimi i kësaj marrëveshje është forcimi i mëtutjeshëm i bashkëpunimit në fushën e ndihmës juridike në çështje penale në mes të dy vendeve dhe lehtësimin e procedurës ligjore mes tyre, pra në këtë fushë. Të nderuar deputetë, marrëveshja në fjalë është e hartuar në përputhje me rregullat e përcaktuara nga Konventa Evropiane për ekstradim e vitit 1957 dhe protokollet e saja shtesa, si dhe reflekton praktikën më të mira evropiane.

Kjo marrëveshje thekson detyrimin që shtetet ndërmarrin për të ekstraduar personat që kërkohen nga shteti tjetër për të ndjekur penalisht apo për të vuajtur dënimin e shqiptuar nga organet e atij shteti. Ndër të tjera, marrëveshja përcakton për se cilën vepër penale mund të lejohet ekstradimi, personat që mund të ekstradohen, kushtet për ekstradim dhe refuzimin e ekstradimit. Po ashtu, me anë të kësaj marrëveshje rregullohet edhe procedura që duhet ndjekur prej momentit të përjashtimit të kërkesës deri te dorëzimi i personit të ekstraduar. Të nderuar deputetë, meqenëse kjo marrëveshje prek të drejtat dhe liritë themelore të njeriut nga neni 18.1 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës ratifikimi i saj bëhet nga Kuvendi andaj si i tillë ju ftoj ta përkrahni. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! E ftoj kryetaren e Komisionit FunkSIONAL për Legjislacion, zonjën Albulena Haxhiun për arsyetimin e raportit të komisionit.

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Më duhet ta theksoj rekomandimin e Komisionit, por po ashtu edhe një sqarim lidhur me këtë. Në kohën kur Komisioni për Legjislacion e ka shqyrtuar Projektligjin për Ratifikimin e traktatit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Hungarisë për ekstradim, kemi qenë gjashtë të pranishëm anëtarë të Komisionit për Legjislacion dhe të gjashtë anëtarët e kemi përkrahur këtë projektligj, sepse konsiderojmë që është projektligj i duhur. Por, në fakt pastaj na ka ardhur një këshill nga Administrata e Kuvendit, Departamenti Ligjor për shkak se me Rregulloren e Punës së Kuvendit procedurat për votimin e marrëveshjeve ndërkombëtare apo projektligjeve të tilla nuk thuhet që kalojnë me 2/3, por as nuk specifikohet saktë si është. Mirëpo, thotë që vlejné në mungesë të dispozitave të qarta vlejné rregullat për seancën plenare.

Prandaj, ne kemi menduar që është më mirë që në qoftë se një projektligj i tillë kërkon 2/3 e votave të deputetëve të Kuvendit, andaj duhet të ndiqet logjika e njëjtë 2/3 e anëtarëve të komisionit. Pra, nuk është që komisioni e ka refuzuar si dokument të tillë, por që ne e përkrahim mirëpo nuk kemi pasur 2/3 e anëtarëve të komisionit për shkak se kemi qenë vetëm gjashtë. Prandaj, në emër të Komisionit për Legjislacion unë i ftoj deputetët e Kuvendit që ta përkrahin këtë marrëveshje. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Vetëm Islam Pacolli ka kërkuar fjalën, askush nga grupet parlamentare as deputetët. A është për këtë çështje, zoti Pacolli? Jo, askush s'ka kërkuar. Atëherë, përfaqësuesi i Qeverisë nuk ka kërkuar fjalën.

Të nderuar deputetë, e dini në bazë të Rregullores duhet 2/3 të deputetëve të Kuvendit të votojnë. Në sallë aktualisht të pranishëm janë me kartela 83. Të pranishëm janë 60, nuk po e vëmë fare në votim për vetë faktin se nuk janë plotësuar kushtet.

9. Propozimi i Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje për shkarkimin e nënkryetares së Kuvendit, zonjës Aida Dërguti

Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje i ka propozuar Kuvendit shkarkimin e nënkryetares së Kuvendit të Kosovës, zonjës Aida Dërguti. E ftoj kryetarin e Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, zotin Glauk Konjufca që ta paraqes dhe arsyetojë propozimin.

GLAUK KONJUFCA: Deputetë të Kuvendit të Kosovës!

Sot nuk do të flasim aspak për gjëra le të themi personale, aspekti për të cilin do të flasim nuk ka të bëjë as me çështje private, e as me çështje thjeshtë personale. Çështja për të cilën do të flasim i ka dy dimensione shumë të rëndësishme: dimensionin e parë është rregullimi kushtetues

institucional i Kuvendit të Republikës së Kosovës, kurse aspekti i dytë është një e drejtë e mohuar e Lëvizjes Vetëvendosje, e kjo është e drejta e mohuar për tu përfaqësuar në Kryesinë e Kuvendit të Republikës së Kosovës, të cilën tash Lëvizja Vetëvendosje nuk po e ushtron si të drejtë.

Sipas nenit 67, pika 3 të Kushtetutës së Kosovës përcaktohet se kujt i takon nga grupet parlamentare ta kenë nënkryetarin në Kryesinë e Kuvendit të Republikës së Kosovës. Pra, tre nënkryetarë ju takojnë tri grupeve më të mëdha parlamentare, kurse dy të tjerë vijnë nga grupet parlamentare të pakicave. Por, problemi ka lindur atëherë kur në Kuvend është krijuar një grup i ri parlamentar. Në këtë grup ka kaluar edhe Aida Dërguti, e cila deri, më 14 mars të këtij viti në Kryesi të Kuvendit e ka përfaqësues Lëvizjen Vetëvendosje. Tash, Grupi Parlamentar i cili është krijuar dhe të cilit i takon Aida tash, është grupi i katërt më i madh parlamentar në Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe ky është Grupi Parlamentar i Partisë Socialdemokrate.

Kjo i bie që sipas nenit 67, pika 3 i bie që këtij grupi nuk i takon një nënkryetar në Kryesinë e Kuvendit të Republikës së Kosovës. Me fjalë të tjera, e vërteta është kjo, ky grup parlamentar e mban një pozitë e cila i takon Lëvizjes Vetëvendosje, kurse në anën tjetër Lëvizjes Vetëvendosje po i shkelet një e drejtë kushtetuese duke ju pamundësuar përfaqësimi në Kryesi të Kuvendit ashtu siç e kërkon Kushtetuta. Unë sot propozoj që të mos i biem rrotull e as të mos e kthejmë çështjen në një lojë të politikës ditore, por pyetja të cilës sot do të duhej t'i përgjigjeshim përmes votës tonë është e thjeshtë dhe pyetja është kjo: a i takon Vetëvendosjes një anëtarë në Kryesi apo nuk i takon Vetëvendosjes ajo pozitë?

Pra, unë mendoj që kështu do të votojmë sot. Për ta thjeshtësuar është qajo pyetje a na takon neve a nuk na takon nënkryetari i Kuvendit. Unë për vete nuk do të kisha pas dëshirë hiq me ardh deri te kjo situatë, shumë më lehtë do të kishte qenë që Grupi i Partisë Socialdemokrate të Kosovës ta lironte këtë pozitë vetë dhe me vullnet, unë kam pasur takime me përfaqësuesit e këtij grupi parlamentar dhe qëndrimi i tyre ka qenë që ata nuk do ta lirojnë me vullnetin e tyre këtë pozitë e nënkryetarit të Kuvendit të Kosovës. Por, problemi legal që ka lindur është ky: domethënë si problem në situatën në të cilën ndodhemi. Çka ndodh, shtrohet si pyetje hipotetike është kjo deri kur nuk ndodh po tash po na ndodh, çka ndodh nëse personi në fjalë nuk jep dorëheqje dhe vazhdon ta mbajë pozitën që nuk i takon?

Në botën demokratike ne e dimë që një precedent i tillë është bile edhe i paimagjinueshëm kurrkush as nuk mundet ta marr mend, ama që në Kosovë po ndodh edhe tash ne duhet ta zgjidhim. Unë personalisht nuk kam qenë në favor të shkarkimit të Aidës, logjika më thotë që Aida është shkarkuar vetë në momentin kur e ka nënshkruar që i përket Grupit të Partisë Socialdemokrate, unë mendoj që në atë moment Aidës faktikisht i ka pushuar funksioni i saj. Pra, prej kur e ka ndërruar grupin parlamentar, sepse mua më duket se logjika e Kushtetutës tonë thotë që postet nuk barten prej një grupi parlamentar, me e dërgua me një tjetër grup parlamentar.

Aktualisht, pra gjendja është kjo, grupi i katërt parlamentar ka nënkryetar, kurse grupi i tretë parlamentar nuk ka nënkryetar. Kjo mendoj që është shkelje e rëndë, por neve përpara kësaj gjendje na ka vendosur edhe Administrata e Kuvendit të Kosovës. Se ne kemi pyet Administratën e Kuvendit qysh duhet të procedojmë lidhur me këtë rast, dhe ata na kanë thënë që më së miri është procedura e shkarkimit. Për mendimin tim, logjika demokratike thotë që do të kishte pas nevojë ndoshta veç për zëvendësim, veç për ta quar Lëvizja Vetëvendosje zëvendësimin për Aidën e jo shkarkimin e Aidës.

Domethënë, më së miri do të kishte qenë që ajo të zëvendësohej, por disa interpretime të çuditshme dhe për mendimin tim jo fort të qëndrueshme na e kanë lënë vetëm këtë rrugë të mundshme, rruga të cilën e kemi ne sot përpara. Pra, unë insistoј që pozitën brenda Kuvendit, sidomos ato që janë strikte parlamentare grupe, pra kujt i takon çka, nënkryetari, sa komisione, drejtuesit e komisioneve e kështu me radhë janë pozita të grupeve parlamentare edhe nuk mundesh me dal me një grup parlamentar edhe me e marrë pozitën me veti. Kjo është domethënë kur të votoni do të ju kisha lutur pra, vetëm për një gjë: që t'i qasemi problemit prej pyetjes a i takon Lëvizjes Vetëvendosje kjo pozitë apo nuk i takon. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Tani është radha e përfaqësuesve të grupeve parlamentare. Armend Zemaj nga Lidhja Demokratike e Kosovës. Armend, pasi s'flet në emër të partisë, le të flasim këta të partisë tani deputetët.

Mirë! PDK-ja s'ka asnjë PDK-ja. Vetëvendosje a ka dikush? Foli! PSD-ja? Dardan Molliqaj e ka fjalën.

DARDAN MOLLIQAJ: Të nderuar deputetë!

I nderuar kryetar i Kuvendit,

Të dashur qytetarë të Republikës,

Proceduralisht jemi shumë në rregull që kjo çështje po diskutohet këtu, politikisht besoj që do të ishte shumë më e ndershme shumë më e drejtë, që shumë çështje të cilat kanë qenë problem i brendshëm i një subjekti politik Vetëvendosjes të trajtohen dhe të merren vesh bashkarish ashtu qysh kemi qenë për shumë kohë bashkë edhe kur jemi ndarë.

Personalisht në mbledhje të Kryesisë dhe Grupit Parlamentar të Vetëvendosjes kam kërkuar që ndarja jonë të bëhet me marrëveshje. Madje, ne e kemi pasur edhe një praktikë të tillë, një deputet i Parlamentit të Kosovës që sot është këtu po ia përmendi emrin Iliri, ka kërkuar që nuk do të jetë më pjesë e Vetëvendosjes dhe kryesia jonë e atëhershme e kemi bërë me marrëveshje një ndarje e cila mendoj që ka qenë model. Sa je bashkë je bashkë, kur ndahesh ndahesh po përshëndeten njerëzit për atë punë. Dhe, na u ka thënë tekstualisht se nuk do të ketë ndarje paqësore, në kuptimin me marrëveshje se jo në diçka tjetër. Dhe, tash po kthehem te tema Glauk, ose nuk e marrin vesh ose edhe ju intereson, ka një dallim substancial mes asaj që po thuhet dhe

asaj që e parasheh Kushtetuta dhe Rregullorja e Kuvendit. Kushtetuta dhe Rregullorja e Kuvendit thotë që tri grupet më të mëdha parlamentare kanë të drejtë për nënkryetar të Kuvendit. Pra, Vetëvendosjes i ka takuar e drejta e propozimit si grupi më i madh parlamentar ose nëse ka qenë konstituive si grupi i dytë më i madh parlamentar për shkak se PAN-i si grup burimor parlamentar ka qenë grupi më i madh.

Pra, e drejta e propozimit. Çka i bie kjo? PAN-i ka qenë grupi më i madh burimor parlamentar dhe ka pas të drejtën me propozua kandidatin për kryeministër, edhe për kryetar të Kuvendit. Sot kryeministri i Republikës së Kosovës e ndërron partinë. A i bjen tash që kjo i takon veç PAN-it? Jo! Nëse Kuvendi e rrëzon kryeministrin ai kryeministër nuk është më, por nëse nuk e rrëzon Kuvendi ai vazhdon me qenë kryeministër. E njëjta vlen edhe për kryetarin e Kuvendit, grupi më i madh parlamentar e ka të drejtën e propozimit e ndërron kryetari i Kuvendit grupin parlamentar nëse Kuvendi nuk e rrëzon dhe nëse nuk jep dorëheqje kryetari ai vazhdon se është mandat kushtetues, jo rastësisht edhe në komentarin e Kushtetutës e keni që kryetari i Kuvendit, kryeministri dhe nënkryetarët e Kuvendit zgjidhen me shumicë të thjeshtë të votave, por shkarkimi i kryetarit dhe i nënkryetarëve bëhet vetëm me 2/3, pse është kjo? Sepse, është e drejtë kushtetuese. Dhe, këtu unë po dua t'i them Vetëvendosjes se kur jemi ndarë me Vetëvendosjen unë kam bërë gabim, Glauku bile më pat bërtit atëherë, tha rregullat janë më të rëndësishme se sa konsensusi politik. Unë e pata ftuar Vetëvendosjen me bë konsensus politik, nuk u pajtuam, është zgjedhje që kemi pasur të dy anët Glauku tha më e rëndësishme është statusi e Rregullore se sa konsensusi, se sa ruajta e kësaj.

Edhe ne meqenëse kemi gabuar atëherë tash po i bëjmë thirrje Vetëvendosjes, le ta respektojë Vetëvendosje Rregulloren dhe Kushtetutën. Nëse Kuvendi i Republikës së Kosovës e shkarkon Aida Dërgutin se mendon që nuk duhet ne absolutisht e mirëpresim. Nëse Gjykata Kushtetuese e nxjerr një vendim që thotë i takon në mënyrë ekskluzive veç grupeve të treta, absolutisht ditën që del vendimi ne e respektojmë. Po tash jeni duke dashur të bëni beteja politike, urdhëroni bëjmë beteja politike. Nëse ju po thoni kështu a din qysh i bjen nuk është me zgjedh Kuvendi, nëse ju takon tri grupeve më të mëdha parlamentare qysh po thotë Glauku, atëherë nuk ka nevojë as për votim, ajo është përfaqësim ekskluziv, në mënyrë se si të jesh grupi më i madh. Dhe, e keni gabim qysh po e shtroni në media, po thoni jemi grupi i tretë parlamentar, nuk ju takon si grupi i tretë parlamentar. Fare, se sipas kësaj logjike e besoj që kolegët e mi do të ia citojnë Glaukut çka ka thënë më 2011 ose 2012, 2013 ku AAK-ja për shkak të lëvizjes së deputetëve u pat bërë me numër të deputetëve më e madhe se sa Vetëvendosja edhe e patën qar çështjen në Gjykatë Kushtetuese AAK-ja, edhe ia pat kthyer një përgjigje Gjykata Kushtetuese. Pra, nuk është çështja cili është grupi i tretë më i madh, më vonë i krijuar. Se sipas kësaj logjike edhe VLAN-i ka mundur t'i krijojë institucionet por s'na la gjykata.

Kështu që edhe brenda logjikës së juaj jeni duke e shtruar gabim. Por ajo që po dua të shtroj këtu është meqenëse Vetëvendosja po thotë që është demokratike, është institucionale dhe ne të tjerët

nuk jemi, unë e ftoj Vetëvendosjen le t'i respektojnë rregullat. Vendi është ky Kuvendi, s'e voton Kuvendi dërgoni në kushtetuese, nëse Kushtetuesja ju jep juve të drejtë keni të drejtë, nëse s'është kështu lërinë lojërat se nuk është fer me anatemua njerëz si Aidën, e si të tjerë të cilët i keni pas për 12 vjet shokë, e nëse po doni me hy në këtë lojë po ju them sot publikisht në Kuvendin e Republikës së Kosovës, atëherë i çelim krejt, krejt letrat i çelim bashkarish jo më fshehtas se s'po vini në emision e keni dërguar veç Glaukun duke e ditë që unë deri në atë ditë e kam respektuar Glaukun, sepse ka qenë njeri konkret, i mirë edhe i ndershëm...

Glauku e ka fituar debatin. Urime! Po, Glauku e ka fituar debatin për shkak të respektit tim. E, nëse po doni t'i shihni debatet e reja, prapë po them, këtu në Kuvend, se nëpër emisione nuk po vini. Këtu në Kuvend haptazi, ballë për ballë, krejt temat, cilëndo që të doni. Por, thirrja ime edhe sot këtu është, kemi qenë bashkë, 12 vjet bashkë, kemi kaluar shumë kohë bashkë, kemi bërë shumë të mira bashkë, edhe shumë të këqija bashkë, por tash jemi grupe të ndryshme politike dhe mos e vazhdoni kështu, se nuk ka kuptim. Keni të drejtë të kërkoni shkarkimin, keni të drejtë ta çoni në Gjykatë Kushtetuese, sido që të dalë ne e respektojmë.

Përndryshe, nëse vazhdoni me denigrim të personave, siç është fjala për Aida Dërgutin e cilindo tjetër, besoni që do ta merrni përgjigjen që s'e keni marrë deri tash, e ju e dini që unë e kam atë përgjigje, e ju e dini që s'mund ta përballoni atë përgjigje, kështu që ju lutem, hajde të vazhdojmë si kolegë politikë, sepse për neve vazhdon të mbetet problem Qeveria dhe pushteti, nuk vazhdon të mbetet problem Vetëvendosja, por edhe me durua më shumë nuk durojmë, Glauk. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Replikë? Urdhëro, Glauk Konjufca, replikë.

GLAUK KONJUFCA: Me thënë të drejtën, krejt paskam harruar se qysh tingëllon Hashim Thaçi në Kuvend, se moti s'ka qenë këtu, që disa vite. Me atë stilin, "Albin, për ty kam diçka, po mos më shti me ta thënë, se me bo unë me i shkua deri në fund, ke me pa ti çka të gjen." Përnjëmend, moti më paska marrë malli me ndie një kësi diskursi, shumë qesharak, me të vërtetë.

Po kështu, unë me thënë të drejtën, mendoj që kjo foltore nuk është fort adekuate, që njerëzit t'i shpalosin traumat e tyre prej debateve që i kanë pasur. E din, në kuptimin që kjo e ka një dinjitet shumë më të madh se për ato komplekse me i shpallë njeriu këtu. Unë tash nuk jemi duke folur për kurrgjë personale dhe për kurrgjë private. Kështu ia nisa diskutimit tim.

Iu përmbajta, mendoj, deri në fund Kushtetutës së Kosovës dhe asaj që unë mendoj se është interpretim i saktë. Edhe kur nënkryetarët votohen këtu në Kuvend, goxha formalisht votohen sepse dihet kujt u takojnë. Për atë edhe kur të qohen duart në Kuvend të Kosovës, kurrë nuk i kam parë duke i numëruar votat kur votohen nënkryetarët, sepse dihet faktikisht kujt u takojnë ato. Ato që e mori shembullin me AAK-në, është me të vërtetë mjerim profesional pak, për arsye

se kjo ka lidhje me grupet parlamentare, kur ato regjistrohen në fillim edhe u takojnë nënkryetarët. Në momentin kur regjistrohen dhe kuptohet se cila është forca e tyre parlamentare në fillim, qaty përcaktohen nënkryetarët dhe po ashtu, si kryetar i komisionit, më fal Donikë, që po të marr shembull...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Jo, se po kanë qejf të ju ngatërrojnë ndërmjet vete. Mjaft, mjaft, shko, se po kanë qejf! Po, jo se a po sheh, te gjithë po reagojnë. Flitni, flitni...

Dardan, kundër-replikë, një minutë e ke.

DARDAN MOLLIQAJ: Faleminderit, kryetar!

Glauk,

Besoj që ka me na ra prapë me shkua nëpër emisione. E kam pësuar një traumë, është e vërtetë. Në njeriun që e kam vlerësuar më së shumti më ka zhgënjyer, se ka mashtruar në emision. Edhe e dinë edhe shokët aty afër, i ke marrë edhe sms-at. Po ta pranoj, po e kam traumë, të vetmin emision publik e kam prej teje, prej njeriut që e kam respektuar më së shumti, se ka dinjitet. Një shok yti i ngushtë ka thënë: Glauku është i mirë, po pa dinjitet. Kjo është e vërteta që e ke kallëzua në këtë betejë, por është problem yti.

Po more, unë jam edhe si Hashimi, edhe si Kadriu, edhe si Ramushi, edhe si Albini, herë si njëri, herë si tjetri, mos ta ndien. Po, nuk i shërbej kurrkujt. E këtu ka... ja ke pas thënë njërit që je “sahanlëpirës”, por unë ty s’po të them ashtu, veç je bërë shërbëtor, Glauk. E, sa të mundesh jep shërbime.

Sa i përket çështjes së PDK-së e këto... koha ka me kallëzua, bre Glauk. Ju veç sa e bëtë një bashkëpunim në Prishtinë kundër Shpend Ahmetit me PDK-në. Urime edhe ai koalicion, edhe i ardhshmi, është e drejtë e juaja me i zgjedhë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit! Jo, do të shkojmë ë bazë të Rregullores. O, qysh kanë me u bë të gjithë bashkë me njëri-tjetrin, kemi me e çuditë edhe këtë popull. Po, mos flitni se... ha-ha-ha...

Partia Socialdemokrate, Dardan Sejdiu, se jemi te grupet parlamentare. Jo, ju edhe partia ime edhe LDK-ja mos u mundoni të përfitonit prej përçarjes.

DARDAN SEJDIU: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Lidhur me këtë aspektin juridik dhe politik unë nuk po flas, sepse mendoj se i cekti Dardan Molliqaj ato argumente. Por, dua vetëm të mundohem të imagjinoj situata të ndryshme dhe problemet praktike, që mund të rrjedhin prej një koncepti të tillë.

Nëse themi se numri i thjeshtë i deputetëve prej ndryshimit të subjektit politik duhet të prodhojë praktika të ndryshimit të menjëhershëm të pozicioneve, e kështu me radhë, mund të imagjinohen situata, kjo mund të ndodh për shembull, gjatë një legjislature të rregullt, e cila mund t'i ketë 4 vjet që ndërmjet subjekteve të cilat kanë numër të barabartë, për shembull, të deputetëve, po e zëmë i kanë nga 18 deputetë të subjekteve të ndryshme brenda legjislaturës t'u ndryshojë numri i tyre nga 7 - 8 herë, për shembull, për katër vjet.

Domethënë, del një deputet prej kësaj dhe tash krejt struktura e institucioneve duhet të ndryshohet për shkak të daljes së një deputeti. Pas tre muajve u del atyre të tjerëve dhe krejt struktura duhet të rirregullohet dhe të kthehet në gjendjen e mëparshme. Pas nja gjashtë-shtatë muajve sërish u del këtyre një deputet dhe sërish duhet të rirregullohet prej fillimit. Mendoj se kjo nuk është fryma e asaj që mund të shihet, edhe në Kushtetutë, edhe në rregullimin e përgjithshëm të institucioneve tona, sepse kjo është për t'i parandaluar transaksionet, qoftë legale, qoftë ilegale, edhe të deputetëve, për shkak se kjo do të nxiste ambicie dhe apetit shumë të madh të subjekteve politike edhe për të blerë deputetë apo qoftë edhe për t'u bërë trysni, e kështu me radhë.

Kështu që, mendoj se ky ka qenë qëllimi që është rregulluar kështu me Kushtetutë dhe me ligje të Republikës së Kosovës.

Të nderuar deputetë,

Ky është fjalimi i vitit 2011 i deputetit Glauk Konjufca. Dhe, unë e lexova për shkak se mendoj që ky argument ende qëndron dhe mendoj që kjo punë është fare e thjeshtë. I procedojmë, i respektojmë rregullat, i respektojmë institucionet, e ruajmë frymën e Kushtetutës dhe dalim në votë. Faleminderit!

KRYETARI: AAK-ja. Ju lutem, kush e pat i AAK-së. Nuk ka. Atëherë, Nisma, Milaim Zeka. Jo, veç ta kryejmë në emër të grupit. Lista Serbe nuk ka. Atëherë, jemi tek deputetët. Milaim Zeka, Sami Kurteshi, Bekim Haxhiu janë, këta tre. Milaim Zeka, të lutem!

MILAIM ZEKA: Po, kryetar!

S'po dua të përzihem në këtë punë, sepse aspektin juridik e përmendi Dardani. Vetëm po dua të them diçka që çdokush çka mbjell edhe korr.

Këta çka kanë mbjellë për 12 vjet ua tha Dardani, janë tash duke e korrë. Kishte qenë mirë të dalin në foltore disa njerëz të Vetëvendosjes edhe të kërkojnë falje publike për linçimet që i kanë bërë, për fyerjet që i kanë bërë, për organizimet që i kanë bërë përmes rrjeteve sociale, duke sharë njerëzit, duke denigruar njerëzit, besa edhe për sulmet herë me vezë e herë pa vezë, herë me grushte e herë pa grushte.

Nuk mund ju të ecni përpara pa kërkuar falje publikisht edhe për dhunën që e keni përdorë edhe për familjet që i keni sharë, i keni fyer, i keni persekutuar. Kur ju tha Dardani t'i çelni kartat ai i çel edhe përnjëmend bash ju bllokoi në të gjitha anët, sepse ai e din, me i çel ne kartat edhe për disa fenomene tjera. Prandaj, ju që nuk jeni të përzier, pa marrë parasysh, nuk po dua të flas me emra, po disa që keni qenë të përzier nëpër fushata, nëpër linçime, nëpër sulme, që na i keni fyer familjet, s'keni lënë send të zezë pa bërë, bash kurrgjë të zezë nuk keni lënë pa bërë. Dhe, ka ende sende më të rënda që ndonjëherë do të vijë dita kur kemi me i hap kartat këtu.

Po e përfundoj, një diçka edhe po e them. Po të kishte mbjellë Lëvizja Vetëvendosje filozofinë e mendimit liberal brenda partisë dhe demokracinë e kishin edukua Aida Dërgutin dhe ajo do të kishte dhënë në vend dorëheqje, po ju e keni mbjellë filozofinë e dhunës, poshtërimin, të mendimit sikur të Fidel Kastros. Ju s'keni dashtë kurrkush të mendojë ndryshe në parti. Keni dashur të ecni njësoj, të shikoni njësoj, të shani njësoj dhe prandaj këtë unë nuk e pranoj asnjëherë brenda partisë sime, brenda Nismës.

Asnjëherë nuk do ta pranoj. Në qoftë se, unë e dua Nismën unë më së pari Nismën do ta sulmoj brenda forumeve të partisë, besa edhe në Parlament, në qoftë se do të kem argumente. Prandaj, këtë po e them që unë në mënyrë absolute kam me votua kundër. Jam për Aida Dërgutin. Aty nuk... në qoftë se do të vijmë te votat, por është mirë të sqarohen para opinionit, se boll na keni pas rënë në qafë një kohë. Po më vjen mirë, që po ju shoh nga pak duke u hëngër ndërmjet vete, po është kaluese kjo. Veç sot, tani... Rexhë, unë me ty... mos më detyro tash t'i shpalos letrat e Ramiz Lladrovci. Hajde!

KRYETARI: Sami Kurteshi, urdhëro!

SAMI KURTESHI: Faleminderit, kryesues!

Unë e di se në këtë drejtim ne kemi shumë gjëra për të thënë, por një po dua ta konstatoj megjithatë, se duhet ne të gjithë të pajtohemi, unë po pajtohem me Ligjin e Darvinit.

Unë s'thashë Shkumbini po pajtohet, po unë po pajtohem. Prandaj, edhe natyrisht se lufta brenda llojit është lufta më e ashpër që e ka njohur historia te qeniet. Kështu që, nuk e përjashtoj se kjo mund të jetë këtu. Unë i kam dy gjëra, që dua t'i them. Nga diskutimet që i dëgjova edhe prej Dardanit, unë e kam koleg më vonë, Glauku e ka më herët, të tjerët s'po dua t'i përmend, se mirë

është ai të replikojë, se disa të tjerë që flasin nga jashtë në mënyrën “unë i hap letrat” e “unë e di...” andej e këndej, janë shantazhe të panevojshme dhe të pavlera.

Unë megjithatë kërkoj dhe ende besoj edhe sot, se krejt çka mund të hapet brenda Lëvizjes Vetëvendosje dhe sot Partisë Socialdemokrate e ka vendin brenda Kushtetutës dhe Ligjit, qofshin ato edhe vepra penale dhe që nga këtu unë megjithatë jam i interesuar që t’i ftoj krejt shokët e mëparshëm, ish-kolegët që të hapin çdo çështje që ka të bëjë dhe është publike, edhe pse ka qenë e brendshme. Po, të mos merren me atë kërcënimin “i hapim letrat, diskutojmë”, sepse shtojnë më shumë dyshime, se sa që unë po di. Nëse vërtet ka vepra të tilla, urdhëroni, foltorja është. Po, është edhe Prokuroria, janë edhe krejt.

Prandaj, unë mendoj se duhet hequr dorë nga kjo metodë e diskutimit. Kjo ndarje i ka shkaktuar dhembjet e veta dhe ka me i shkaktua ende, se ende s’ka marrë fund krejt, ka çka të ndahet. Në një familje edhe përsëri kur ndahen ka gjëra që mbeten më vonë. Ne e kemi ligjin, kemi Kushtetutën edhe Ligji edhe Kushtetuta megjithatë nuk i saktësojnë këto gjëra deri në fund.

Është një çështje, domethënë se çdo ligj që i definojnë të gjitha gjërat 100%, në të vërtet ai është ligj diktatorial, se nuk i lë liri njeriut që të punojë me ndërgjegjen e vet. Ne nuk kemi asi ligji. Ne e dimë, që Kushtetuta edhe rregullorja, megjithatë lë shumë vrima, hapësira për të zgjidhur probleme.

Siç duket, ky problem nuk është zgjidhur me diskutime. Unë e ftoj, i ftoj të gjithë kolegët dhe koleget në këtë Kuvend, që të votojnë sipas bindjes së tyre lidhur me këtë çështje, nëse kjo qenka çështje që duhet të dalë në votim, le të votojnë si e kanë bindjen e tyre. E thamë, unë jo, ai tjetri po... dikush do të votojë për, dikush kundër, dikush do të abstenojë, po unë mendoj se megjithatë ky konflikt ka shkaktuar edhe ka nxjerrë një problem që duhet të sqarohet ndoshta edhe përmes Gjykatës Kushtetuese. Nuk ka kurrgjë të keqe. Unë ende sot jetoj me bindjen, se çfarëdo që të dalë në diskutimet e mëvonshme, qoftë nga Dardan Molliqaj, qoftë nga çdokush tjetër, nuk do të jetë e një karakteri të tillë, që nxjerr kriminalizim sipas ligjeve pozitive në Republikën e Kosovës.

Prandaj, nëse bashkimi ka qenë i natyrës politike, unë ftoj të gjithë njerëzit, që të gjitha problemet politike që i kanë pasur dhe publike, le t’i thonë hapur. Unë nuk mendoj dhe ende sot besoj se ka probleme dhe konflikte, probleme që kanë lindur në konflikte, edhe sot i kemi, i shohim, që nuk mund të nxirren. Mirëpo, nëse duhet të nxirren të gjitha, edhe bisedat private e personale, unë mendoj se ka një kod të sjelljes ndërnjerëzore, që nuk lejon të gjitha bisedat, qofshin edhe të karakterit publik, po që kanë qenë krejt private të nxirren, sepse atë nuk e rregullon as ligji.

Keni kujdes, ruajeni minimumin e marrëdhënieve ndërnjerëzore, sepse këto marrëdhënie do t'u duhen edhe më vonë. Prandaj, unë nuk shoh ndonjë problem. Le ta nxjerrin në votim ashtu siç po kërkojnë, po kërkon edhe Partia Socialdemokrate, po kërkon edhe Lëvizja Vetëvendosje, ta shohim rezultatin dhe t'i ndjekim të gjitha rrugët ligjore të mundshme. Po kërkoj edhe një herë që të ndalet ajo gjuha “kemi me i nxjerrë, kemi me ua bë, keni me pa e s'keni me pa...”, sepse unë mendoj se në fund të fundit s'ka për ta çuar kurrkund hiç. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Sami, a e ke përmendur Dardanin? Replikë. Urdhëro! Dardan Molliqaj ka replikë.

DARDAN MOLLIQAJ: Së pari, faleminderit, unë i them Axha Sami, më vjen keq që po shprehem kështu, po për shkak të respektit po ashtu.

E para, Axha Sami, nuk i di shumicën e gjërave dhe është e vërtetë që nuk i di, sepse ka ardhur më vonë dhe nuk është faj pse ka ardhur më vonë, po s'ka qenë. As të mirat, as të këqijat, jo vetëm të të tjerëve, po edhe të miat.

E dyta, Axha Sami, nuk e përfaqëson zërin e Vetëvendosjes në këtë çështje. Unë kisha pasur qejf shumë t'i përfaqësojë, se e para s'di a e dëgjuat, tha kjo është ndarje, prej kryetarit të partisë e teposhtë kanë thënë “ka largime”. Tash, a jemi ndarë a jemi larguar, s'po di. Kështu që, kjo është një ndarje e madhe që e keni në këtë adresim.

E dyta, unë prapë ju bëj thirrje, ju bëra thirrje edhe në foltore aty, që çështjet që s'kemi mundur t'i zgjidhim për shkak se kemi pasur dallime brenda, le t'i lëmë dhe diskutimet në mes PSD-së dhe VV-së të jenë për të ardhmen dhe dallimet që i kemi në të ardhmen, kush çka po bën. Por, nëse konsideron Vetëvendosja se në vazhdimësi mund të sulmojë dhe heshtjen tonë ta kuptojë si dobësi, atëherë po ne mund të vazhdojmë një betejë shumë herë më të ashpër, se sa e keni parë deri tash në mes vete edhe të flasim edhe shumë herë sende që s'i kemi folur, por unë kam besuar deri vonë, të ju them të drejtën deri në muajin e fundit, që Vetëvendosja do ta tejkalojë këtë problem edhe nuk do të merret. Nuk keni paraqitje mediatike, ku diku 70% të kohës flitni për ne. Respektojini rregullat, Ligjin, Kushtetutën, jemi në rregull.

Ajo çfarë unë ju thash nuk ishte, as kërcënim, as shantazh, po për shkak se ju ndjeheni të shantazhuar, ky është problemi juaj. Unë nuk ndjehem i shantazhuar prej Vetëvendosjes, jam i hapur të flas për krejt, pra edhe nuk e shantazhoj kurrkënd. Por, ajo që jam duke bërë është thirrje, nëse nuk jeni gati me e bë debatin politik, sigurisht se nuk do të durojmë pafundësisht. Dhe fillimi i padurimit është sot dhe po shpresoj që të ndërtojmë marrëdhënie politike, në cilindo pozicion që jemi, përndryshe edhe ne do ta bëjmë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit! Do të ishte mirë... nuk po dua ta luaj rolin e mediatorit fare, po të futemi te tema. Urdhëro, Sami, një minutë!

SAMI KURTESHI: Faleminderit!

Megjithatë, ftesën time e bëra, sido që të kuptohet.

Sa i përket asaj që po përpiqet Dardani t'i kapë nuancat e fjalëve, pra atëherë në gjuhën politike unë po them, për mua personalisht, unë kam folur në emër timin, jo në emër të Vetëvendosjes, sepse këtu kemi imunitet si deputetë, kjo u ngrit këtu në Kuvend, e jo në parti.

Unë po e them se në gjuhën politike kjo quhet "faksion", bile as "fraksion" jo. Nëse doni ta tירni aq shumë, po unë nuk po dua ta tјerr. Unë veç po them që ka mundësi të diskutohet edhe çështja, të shkojë në nivelin ligjor e politik dhe të mos personalizohet. Kaq, nuk kam diçka më shumë.

KRYETARI: Faleminderit! Salih Zyba e ka fjalën.

SALIH ZYBA: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Nëse mund të dëgjoni pak, ju lutem, kam një pyetje konkrete.

Subjektit prapa meje ia dhe dy herë fjalën në emër të grupit, domethënë dy persona me emër të njëjtë, ia dhatë fjalën në emër të grupit. A ishte gabim apo e qëllimshme? Ndoshta e konsiderove apo e pate parasysh fjalimin e Glaukut, kur tha se kë e emiton, të lutem, një sqarim për këtë, pse ndodhi dy persona në emër të një grupi?

Ndërsa sa për personat mbrapa, është mundësi, është kënaqësi e tyre të jenë opozitë e Lëvizjes Vetëvendosje, mirëpo do të duhej të ishin opozitë e Qeverisë. Faleminderit! Kërkoj sqarim, të lutem.

KRYETARI: Vetëm diçka, unë e di se është seancë e ngarkuar. Reagimet tuaja mes jush, replikë, reagim, replikë, pastaj kur ia kam dhënë fjalën Dardan Sejdiut, ia kam dhënë në emër të Grupit Parlamentar, më herët e ka marrë në emër të replikës, kjo ishte çështja. Po, kjo se, gabimi i regjisë është, e pat edhe ju isha duke biseduar me sekretarin, replikën e ka bartur në minutazhin e gjatë, siç e ka bartur edhe dje, ka ndoshta në regji një simpati për PSD-në si parti e re, ia ka bartur nja tre minuta më shumë Dardanit kur kemi folur për Contour Globalin, kjo ka qenë, po fjala i është dhënë për replikë, ta keni parasysh. Është çështje tjetër vëmendja ime, për opinionin publik, nuk e përcaktoj minutazhin unë nga foltorja ime si kryetar, përcaktohet atje, ta keni parasysh.

Urdhëro, zoti Zyba, prapë!

SALIH ZYBA: Të lutem, nëse është diskriminim pozitiv, e kam parasysh, mirëpo arsyetimi nuk është për teknikën, po është për juve, në mënyrën qysh e thirre ti, se ky diskriminim të flasë dikush në emër të grupit në këtë formë për replikë, nuk ka qenë praktikë e deritashme, aq më pak për neve si mundësi. Faleminderit!

KRYETARI: Edhe një herë, nuk po dua ta ekzagjeroj këtë çështje, por nuk ia ndal fjalën askujt. Çështja e gabimit fillestar ka qenë replikë, edhe sipas të gjitha gjasave, ka ndodhur ngase ka folur më gjatë, kjo është çështja, replikë e ka marrë fjalën, ta keni parasysh.

Po në qoftë se mendoni se minutat ia kam zvogëluar unë Vetëvendosjes, ju jap sa të doni, thjesht, po nuk është ndonjë qëllim, në qoftë se mendon diçka. Në rregull, e kam për opinion publik, në njëfarë forme ne parti e djathtë jemi PDK-ja, PSD-ja më shumë na lidh me juve të Vetëvendosjes, se po dilni e djathtë, po më duket, duam të hyjmë në koalicion, edhe dje mirë kemi kaluar në Prishtinë. Pak shaka, në politikë jemi, nuk ka ndodhur me qëllim, këtë po dua ta them, kjo nuk ka ndodhur me qëllim specifik. Urdhëro, Salih Zyba, prapë!

SALIH ZYBA: S'i kemi kaluar në të kaluarën e largët apo të djeshmen në Prishtinë, do të shihet sot me vota që do të ketë përkrahja e kësaj pikës tonë që është më se e arsyeshme edhe e ...

KRYETARI: A është e mençur kjo? Kjo është e mençur, vërejtje e mençur. Adem Mikullovcit, edhe Memli Krasniqi, po jep fjalën Adem Mikullovcit përpara, Memli, më vjen keq!

ADEM MIKULLOVCI: Faleminderit, zoti kryetar!

Po ju drejtohem juve personalisht,

Zoti kryetar, vetëm përgjigju, pyetja është: A duhet partia e tretë numerikisht në Kuvend ta ketë nënkryetarin a jo? Nëse duhet, duhet ta ketë dhe s'ka tjetër muhabet këtu. Me Rregullore i takon vendi. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Mikullovcit, ke të drejtë, po tash e vendosin deputetët. Zoti Krasniqi e ka fjalën.

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit, zoti kryetar!

Pak si ta kisha ditur, m'u përzjeve në temë, se unë, thënë të drejtën, ne si PDK nuk kemi, figurativisht po shprehem, 'kali në garë', por që u përmend PDK-ja, e kanë bërë një zanat këta PSD-ja me Vetëvendosjen kur donë ta ngucin njëri-tjetrin, flasin për PDK-në, e kanë njëfarë si tip 'rreshqitjeje frojdiane', kështu, demek ti je me PDK-në, ti je me PDK-në, të gjithë kanë qejf të jenë me PDK-në, po u vjen rendi edhe këtyre ndonjëherë, nuk dihet, ne jemi të hapur për koalicion, qoftë në nivelin lokal ose qendror. Desha ta sqaroj më shumë se Molliqaj tha "urime koalicionin që e keni bërë". Nuk kemi bërë koalicion, por e vërteta është që dje kanë ndodhur që Vetëvendosja e PDK-ja, disa asamblistë kanë votuar dhe e kanë shkarkuar një zyrtar të PSD-së.

Po tash e vërteta është që pas votimit të sotëm tash Vetëvendosja do ta akuzojë PSD-në që është bërë me PDK-në, se ne nuk do ta mbështesim kërkesën e Vetëvendosjes, sepse kemi besimin që nuk mund të japim përgjigje në këtu, edhe këta qëllimi realisht s'e kanë ta shkarkojnë Aidën sot në Kuvend, se e dinë që nuk i kanë 80 vota, por duhet të kryhet votimi që këta ta dërgojnë në Gjykatë Kushtetuese, e Gjykata Kushtetuese le ta thotë mendimin e vet dhe na çliron të gjithëve. Po unë fola veç prej perspektivës së PDK-së. Bëjeni garën ndryshe, mos u merrni me PDK-në, ne ndonjëherë mund të kemi koalicion në nivel qendror, ndonjëherë në nivel lokal, qysh ta vlerësojmë situatën. Faleminderit!

KRYETARI: Dardan, a ta ka përmendur emrin? Memli, a e ke përmendur me emër? Jo, Dardanin, Dardan Molliqaj, po atëherë ka të drejtë për replikë. Në krah të Dardanit, edhe Glauku, atëherë. Dardan, fjala për ju.

DARDAN MOLLIQAJ: Memli dje nuk është vetëm që është votuar diçka, por besoj që e ke parë edhe një postim të një fotos, opozita e bashkuar ku kanë qenë PDK-LDK-VV.

Për Frojдин, s'po di a të flas, po e lë, më mirë, se nuk m'u duk që ke në linjë çka the. Një send duhet ta kuptosh, Memli. Dhe mbaje në mend, jo për ndonjë arsye, po ta kesh të qartë.

PSD nuk bën koalicion me PDK-në pa shkuar PDK-ja një herë në opozitë, hiç, në asnjë rrethanë, me asnjë çmim, me asnjë kusht.

Dëshirë juaja mund të jetë, është në rregull, sikur është qëndrimi ynë, nuk kemi kurrfarë fiksimit me PDK-në, çfarë po mendon ti. PDK-ja qeveris prej 2007, faktikisht 2008, keni bërë keqqeverisje, keni bërë gabime, për këtë arsye duhet të shkoni në opozitë. Pasi të ktheheni prej mandatit në opozitë, të shohim çka ka ndodhur, kështu që jo që s'kemi dëshirë, po është e patejkalueshme që Partia Socialdemokrate të bëjë koalicion me PDK-në pa shkuar një herë në opozitë.

Aty anash, në krah të majtë që i keni, edhe në krahët e tjerë mund të diskutoni, me neve kjo punë është e kryer, për kurrfarë arsye tjetër, përveç që keni keqqeverisur me vendin, asgjë më shumë.

KRYETARI: Për ta legjitimuar thyerjen e Rregullores, kundër-replikë. Jo, po dua të krijoj pretekst që t'ia jap Glaukut fjalën, mos e bë të njëjtin gabim si Dardani, se qytetarët e kanë vendosur që të mos shkojë PDK-ja në opozitë, pastaj jetë gjatë, Dardan, në opozitë. Kush po e merr fjalën? A i lëmë replikë, kundër-replikë, a të shkojmë drejt votimit?

Memli Krasniqi, kundër-replikë!

MEMLI KRASNIQI: Është e vërtetë se nuk e përmenda Glauk Konjufcën, po e përmenda Vetëvendosjen, pak më herët, nuk di a më dëgjove.

Ndërsa për zotin Molliqaj, e konfirmova atë që e thashë, edhe këtë fjalim që e tha në replikë, më shumë e pate për Vetëvendosjen, se sa për neve. Më shumë deshe ta bësh dallimin me Vetëvendosjen, këqyr se ne mendojmë kështu, më ndryshe për PDK-në, se sa ata.

Krejt çka desha të them më herët, ne nuk jemi parti e vijave të kuqe, gjithmonë kemi thënë, ne jem parti e hapur, i preferojmë partitë që janë ideologjikisht më të afërta me neve, ju nuk jeni shumë, se keni shkuar në të majtë goxha shumë, por problemin që desha ta cek është se dje prapë keni bërë propagandë, fushatë, duke u thirrur se PDK-ja me Vetëvendosjen janë bashkë, nuk është e vërtetë. Fotografitë, tash fotografitë nuk e di kush i ka bërë, nuk është që më pëlqej mua shumë si foto, s’kishin dalë bash mirë në fotografi, po ajo nuk konfirmon asgjë nga ajo që e thatë ju. Faleminderit!

KRYETARI: Urdhëro, Glauk!

GLAUK KONJUFCA: Unë duhet kundër të dyve, se edhe ai ka folur për Vetëvendosjen atje, edhe Memli ka folur këtu.

Kur po thotë Dardani që Vetëvendosja u bë me PDK-në, po PSD ja pa dalë një herë në opozitë PDK-ja nuk shkon në koalicion. Ky është i vetmi qëndrim i mirë që e ka marrë prej Vetëvendosjes, kur ka dalë, veç këtë qëndrim të mirë e ka marrë. Domethënë këtë që PDK-ja duhet të shkojë në opozitë, këtu pajtohem plotësisht.

Sa i përket Memlit që tha se Vetëvendosja ka shumë qejf të bëhet me PDK-në, po ja u tregoj vetëm një sekuençë, është shumë interesant.

“Në vitin 2014, po ju kujtohen zgjedhjet e vitit 2014, na pati ardhur një letër prej kryetarit, jo tash ti qenke kryetar, prej ish-kryetarit, atëherë Hashim Thaçit, për të ardhur Vetëvendosja në koalicion me PDK-në, letër zyrtare ka qenë, i pati dërguar edhe njerëzit e tij, edhe disa ‘mësit’ prej Shqipërisë. Lëvizja Vetëvendosje ia ktheu dhe i tha nuk bën. Domethënë, kjo është e mjaftueshme për të kallëzuar sa shumë ka qejf Vetëvendosja të shkojë në koalicion me PDK-në.

KRYETARI: Faleminderit! Armend, a ke folur? Armend Zemaj. Po bëhet shumë. Armendi flet pastaj, Dardan, kundër-replikë. Edhe Memli Krasniqi ka kundër-replikë.

ARMEND ZEMAJ: Kryetar!

Ndoshta në këto momente e vetmja gjë që ndodhi mirë është largimi i këtyre fëmijëve që ishin për 1 Qershor, të mos vazhdohet me këto trauma të kota procedurale për të gjithë ne tjerëve që, për mendimin tonë është dashur të zgjidhen brenda Kryesisë së Kuvendit.

Është i pakuptimtë gjithë ky debat, për diçka që të gjithë e dimë rezultatin. Kështu që ju kisha lutur ta ndërprisni, për hir të korrektësisë, edhe ndaj ne të tjerëve që nuk po kyçemi në këtë debat. Çështjet e nënkryetarit, të pagesave, të grupeve parlamentare, të kryesive të komisionit kryeni në mënyrë adekuate, ashtu siç i ka praktikuar Kuvendi dhe mos na thëlloni në këto tema, sepse me të vërtetë është lodhje, është mundim edhe për qytetarë që na shikojnë. E kam një lutje kështu shumë parimore, shumë korrekte, në raport me gjithë neve edhe juve, a na pëlqeu apo s'na pëlqeu ky debat.

KRYETARI: Armend, edhe kështu jemi në përfundim. Memli e Dardani kanë kundër-replikë, edhe Bilalli në fund, më mos nxit tepër. Urdhëro Dardan, kundër replikë Memli edhe me Bilallin e përfundojmë.

DARDAN MOLLIQAJ: Shumë radhë pajtohem me Armendin, por sot do të pajtohem. Seriozisht edhe në foltore u mundova të kërkoj që të shkojmë sipas rregullave të procedurës, sepse është çështje e Vetëvendosjes, normalisht që është edhe çështje e Kuvendit për të votuar ose jo.

Glauk, kam marrë shumë çështje prej Vetëvendosjes dhe nuk i mohoi kurrë, edhe shumë sende të mira, bile, por një dallim është që disa prej tyre nuk i braktis kurrë, por janë disa që i kanë braktisur e dita-ditës do të konfirmohet që do t'i braktisin.

E shumë prej çështjeve në Vetëvendosje mendoj që është korrekt të thuhet që janë pjesë e krejt njerëzve që kanë qenë në Vetëvendosje, secili ka dhënë nga një grimë kontribut aty në Vetëvendosje. Secili ka mësuar në Vetëvendosje, unë jam prej tyre që kam mësuar shumë prej Vetëvendosjes, po do të jem njëri prej atyre që s'do t'i braktis, e një prej tyre është edhe kjo, Glauk, nuk e braktis unë, për dallim prej disa prej jush që s'e keni thënë as më herët këtë çështje. Edhe më herët keni flirtuar, është krejt e drejtë, jeni parti në vete, mund të bëni koalicion, veç mund të mos pajtohem. Kaq!

KRYETARI: Memli e ka fjalën.

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit, kryetar!

Ndoshta, Glauk, unë gabova, u nisa prej atij konstatimi tashmë publik me konstante dhe variabla që buron prej Vetëvendosjes.

E dyta, asaj çka po i referohesh ti, nëse e di, nuk jam i sigurt a e di, ata njerëz që kanë biseduar, kanë biseduar prej vullnetit të mirë, është një ish-zyrtar i lartë i Vetëvendosjes, një zyrtar asnjëherë i lartë i PDK-së dhe një gazetar nga Shqipëria, po ajo ka qenë krejtësisht e parëndësishme, letra e panëshkruar, sepse ju e keni ditur që ne koalicionin duam ta bëjmë me LDK-në, kështu që keni qenë të kthjelltë sa ta merrni vesh atë farë pune që ata që kanë biseduar për atë punë as s'kanë pasur mandat, as s'kanë pasur ndikim, as s'e kanë pasur përnjëmend, sepse vendimi ka qenë shumë më herët që koalicioni 2014 të jetë mes PDK-së dhe LDK-së.

KRYETARI: Faleminderit! Bilall Sherifi, edhe Islam Pacolli është i fundit.

BILALL SHERIFI: Tash unë e vazhdoj aty ku e la Memli pak, kryetar.

Memli tha ka qenë i vendosur, po, por pak më vonë ka qenë i vendosur, kjo është temë tjetër.

Është e vërtetë që ndër më insistuesit e vitit 2014 për të mos bërë koalicion me PDK-në kanë qenë Nisma dhe Dardan Molliqaj.

Natyrisht, ka përfaqësuar Vetëvendosjen, po më insistuesi aty ka qenë Dardan Molliqaj që në asnjë rast të mos i jepet shans PDK-së të hyjë në koalicion, por kjo është hyrja, e tash vazhdon tregimi im.

Tamam e menduam që e shumë ngushtë PDK-në, nuk po do LDK-ja, nuk po do AAK-ja, s'po do VV-ja, ne që mund ta përmbysnim, 6 deputetë e bënim mazhorancën qoftë andej, qoftë këndeje, u gëzuam. Veç kur e pamë një ditë që doli LDK-ja dhe ia bëri shumicën.

Kështu që, krejt këta që thonë sot nuk bëjmë kurrë koalicion, mos ta thonë, se kështu patën thënë këta kolegët djathtas, kur ka ndodhur PAN-i, tashmë nuk besoj në asgjë që nuk ndodh.

Prandaj, le të mbetemi pak më kolegjalë, edhe le të punojmë për aq sa mundemi të punojmë tash së bashku.

Sa i përket temës në fjalë, unë mendoj që legjitimiteti dhe procedura, këto janë kundërthënie me njëra-tjetrën.

Legjitimiteti, legaliteti thotë që po, i takon tri partive më të mëdha, në këtë rast Vetëvendosjes, të propozojë kandidatin për nënkryetar dhe, siç tha Glauku, po formalisht votohet. Krejt rastësisht kjo formalisht është në rregull. Pra, duhet të votohet qoftë edhe me ngritje dore, vetëm formale. Po njëkohësisht Kushtetuta parasheh që formalisht gjithsesi duhet të votohet edhe shkarkimi, nëse nuk bëhet me marrëveshje apo me dorëheqje nga personi në fjalë.

Kështu që tash jemi te procedura, meqë s'ka marrëveshje, s'ka konsensus dhe procedura jorastësisht parasheh masën mbrojtëse nga 80 deputetë për ta shkarkuar, madje sipas Kushtetutës jo vetëm që duhet 80 vota për ta shkarkuar nënkryetarin, po propozimi duhet të vijë vetëm nga Grupi Parlamentar që e ka propozuar në fillim. Nuk mund të propozojmë ta shkarkojmë sot Kujtim Shalën ne si Nismë, as PDK-ja, sepse nuk është i propozuar nga grupi parlamentar në fjalë.

Kështu që, këtu kemi të bëjmë me kundërthënien mes legjitimitetit të votës dhe procedurës, por sigurisht ligjvënësi e ka pasur parasysh këtë fakt kur e ka vendosur të tillë dhe le të vazhdojmë te procedura, le të hidhet në vota, nëse nuk merr shumicën e duhur, le të shkojë atëherë në Gjykatë Kushtetuese. Faleminderit!

KRYETARI: Replikë Memli Krasniqi, Islam, bëhesh gati.

MEMLI KRASNIQI: Shoku im Bilall Sherifi sa herë flet për VLAN-in, flet me një nostalgji, i ka mbetur merak ashiqare, e unë absolutisht nuk kam asgjë kundër, nuk e fajësoj për atë punë, se besoj që ka besuar në atë farë opsioni, tash pse kanë besuar ata, është dashur ta dinë që, sillet e pëstillet, po në fund ai që i fiton zgjedhjet, atij që i jep besimin qytetari, ai edhe i krijon institucionet, gjë që ka ndodhur edhe tash kur jemi bërë bashkë si PAN, po do të ndodhë edhe në të ardhmen, kurdo që mbahen zgjedhjet. Faleminderit!

KRYETARI: Bilalli, kundër-replikë!

BILALL SHERIFI: Memli ka filluar tash të lexojë njëfarë parapsikologjie, tash po e dika kush çka ndjen, s'e kam njohur këtë veti të Memlit. Unë vetëm u përpoqa të shpjegoj sesi është zhvilluar. Me pak fjalë, se kam qenë një ndër aktorët e drejtpërdrejtë, e Memli ka me të dëgjuar, unë i kam kështu të drejtpërdrejta këto tema. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Islam Pacolli e ka fjalën!

ISLAM PACOLLI: Përshëndetje, kryetar!

Kabinet,

Kolegë të nderuar,

Me të vërtetë, më herët më mbetët borxh që s'munda ta marr fjalën, desha të them që kur t'i nxjerrin rezolutat grupet parlamentare, është mirë t'i konsultojnë edhe deputetët që janë të pavarur, apo deputetët që s'kanë grupe, për arsye që në fund nevojitet vota e tyre, e nëse nuk konsultohemi pastaj nuk do ta kenë votën, nën një.

E dyta, nuk jam shumë i lumtur që sot një ditë të xhumaje, që ne duhet më shumë të përllahemi sesa të mendojmë për zhvillimin ekonomik, pasi ne jemi edhe të thirrur për këtë. Nuk mund ta

çojmë përpara vendin tonë ne vetëm me replika e kundër-replika. Do të ishte mirë, apo u kisha bërë thirrje kolegëve që t'u largohemi këtyre dhe ta marrim aq seriozisht, që çështjen tonë ta çojmë përpara. Një kërkesë për ju, zoti kryetar Kadri Veseli, me të vërtetë është një bufë këtu mbrapa, e di që është muaji i Ramazanit, por megjithatë është e pamundshme të dilet në atë bufë aty që i vjen era duhan dhe është e pamundshme, se nëse vetëm 2 minuta qëndron aty, me ato rroba nuk mund të shkosh në shtëpi se u vjen era shumë e keqe. Një dëm jashtëzakonisht i rëndë. Dhe, për ata të cilët nuk e pinë duhanin, është e pamundshme të përdoret ajo bufë. Prandaj, kërkoj nga ju që të jepni urdhër që ta bëjnë një hapësirë edhe për ata që nuk e pinë duhanin.

E dyta, po dua të them që është një bufë aty, ku prej kur jam në cilësinë e deputetit, asnjëherë nuk e kam parë një arkë fiskale që qëndron aty. S'është e rëndësishme sa është qarkullimi, sa është e rëndësishme të jenë e barabartë me të gjitha bizneset që qëndrojnë në gjithë Kosovën. Faleminderit!

KRYETARI: Zoti Pacolli, faleminderit! I bëj thirrje publike Inspektoratit ta respektojë Ligjin nga Kuvendi dhe në të njëjtën kohë Administratës Tatimore të Kosovës, dyjave. Kjo është ajo, s'kemi çka japim më shumë as udhëzim, as urdhër, se ligji e përcakton qartë njëjtë për të dyja rastet. Nuk jeni vetëm ju ankues, ka shumë deputetë, dje me kolegen deputete e kemi pasur po ashtu një debat pikërisht për këtë çështje, mirë që e bërë edhe publike.

Jemi duke shkuar drejt votimit, ka përfunduar debati. Vetëm të bëj një sqarim procedural, kemi për ta votuar propozimin e Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje për shkarkimin e nënkryetares së Kuvendit të Kosovës, zonjës Aida Dërguti. Para se të vazhdojmë me votimin, konstatoj se në sallë janë të pranishëm 74 deputetë, që nuk është numër i mjaftueshëm për procedim. Ne kot shkojmë në votim, s'janë 80 deputetë. Thirrini deputetët, ju lutem! Tash po mundohemi që të qëndrojmë nja 1-2 minuta, por pa qenë 80 deputetë s'di pse të futemi në votim. Vetëvendosja, shikoni a i keni të gjithë deputetët, bile ju.

Të nderuar kolegë deputetë, e vazhdojmë pikën e radhës për arsye se nuk kemi deputetë? Vetëm futemi kot në votim.

10. Formimi i Komisionit Hetimor Parlamentar në lidhje me shpenzimet për lobim nga Presidenca dhe Qeveria e Republikës së Kosovës

Diskutimet për këtë pikë kanë përfunduar në seancën plenare, të mbajtur më 3 maj 2018. Gjithashtu në këtë seancë grupet parlamentare i kanë propozuar deputetët për anëtarë të këtij komisioni. Grupi Parlamentar i PDK-së duhet t'i sjellë... Memli Krasniqi dhe Partia Socialdemokrate duhet edhe një deputetë ta sjellë. Dardan Sejdiu, edhe një deputetë duhet për anëtar. Memli Krasniqi, në rend të parë.

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit!

Nëse ju kujtohet, na ka pas mbetur pa u votuar kjo çështje se ka qenë e ndërlidhur edhe me një pikë tjetër, e cila kaloi dje. Kështu që ne mund të jua japim emrat, më tregoni saktësisht nëse s'prish punë Sekretaria sa anëtarë duhet t'i dërgojë Partia Demokratike e Kosovës, 3 apo 4? 3 anëtarë, a po? A mund të kalojmë në votim pa emra, t'i sjellim emrat zyrtarisht sot gjatë ditës?

KRYETARI: Po, ka mundësi gjatë ditës, vetëm plotësohet, po komisioni votohet. Atëherë, Partia Demokratike e Kosovës e plotëson numrin me 3 sot. Partia Socialdemokrate, dëshiron tani a më vonë e sillni edhe ju? Urdhëro, zoti Sejdiu!

DARDAN SEJDIU: Atëherë, nga Grupi i Partisë Socialdemokrate është Shqipe Pantina.

KRYETARI: Shqipe Pantina. Lista serbe nuk është në sallë. Atëherë, sot vazhdojmë me procedimin e votimit për formimin e këtij komisioni. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

71 deputetë kanë votuar, 66 për, 2 kundër, 3 abstenime.

Kuvendi e formoi Komisionin Hetimor Parlamentar në përbërjen që e keni secili prej jush, plotësohen edhe me emrat të cilët kanë mbetur për t'u plotësuar.

Kërkohet nga Komisioni Hetimor Parlamentar që të veprojë në përputhje me Ligjin për hetim parlamentar dhe Kuvendit t'ia paraqesë raportin me rekomandime në afatin prej një muaj nga dita e formimit.

Jemi te vazhdimi i seancës plenare me pikat e papërfunduara, më 17 dhe 30 maj 2018.

Administrata ndërkohë e shikon sa deputetë jemi në sallë edhe pastaj mund të rikthehemi. 77 deputetë janë në sallë.

* * *

E hënë, 4 qershor 2018

Vazhdimi i mbledhjes plenare, e filluar më 3, 31 maj dhe 1 qershor 2018

Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Vazhdojmë me pikat e papërfunduara nga seancat plenare, të mbajtura më 3 maj dhe 1 qershor, si në vijim:

4. Votimi i Projektligjit nr. 06 për ratifikimin e Traktatit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Hungarisë për ekstradim

Është çështje procedurale, e votuat edhe më herët, por tash pasi është vazhdim edhe një herë. Përgatitemi për votim, votojmë tash!

Prapë nuk ka kuorum. 66 deputetë kanë votuar, 64 për, asnjë kundër, 2 abstenime. Kuvendi nuk e miratoi Ligjin nr. 06/L-062 për ratifikimin e Traktatit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Hungarisë për ekstradim.

9. Votimi i propozimit të Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje për shkarkimin e nënkryetares së Kuvendit, zonjës Aida Dërguti

Krejt diskutimet i kemi kryer në seancën plenare të datës 1 qershor. Në mungesë të kuorumit të mjaftueshëm për vendimmarrje nuk u procedua për votim. Për korrektësi, duhen 2/3 e deputetëve për shkarkimin e nënkryetares së Kuvendit.

Atëherë, regjia dhe deputetët të përgatiten për votim. Kemi të bëjmë me fatin e nënkryetares së Kuvendit, zonjës Aida Dërguti. A përgatitemi për votim? Vendimmarrja është juaja, urime zonja Aida Dërguti çfarëdo që të jetë votimi paraprakisht, urime. Votojmë tash!

Kanë votuar 75 deputetë, 2 me dorë, abstenim...? Zonja Millaku, cila është vota? Duhet ta deklaroni votën zonja Millaku për arsye se nuk është çështje... Faleminderit, se s'të dëgjova, kërkoj falje!

Zonja Aida Dërguti, 75 deputetë kanë votuar, përkatësisht 77.

Kanë votuar 15, përkatësisht 16 për ta shkarkuar, 29 kanë votuar kundër shkarkimit tuaj dhe 31, përkatësisht 32, me votën e Memli Krasniqit, janë abstenime.

Kuvendi nuk e miratoi propozimin e Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje për shkarkimin e nënkryetares së Kuvendit të Kosovës, zonjës Aida Dërguti.

Jemi në vazhdimin e seancës. Ta kini parasysh, dy pikat e fundit në cilat janë dashur 2/3-at, te traktati dhe Zonja Dërguti, nuk janë miratuar, por nuk kanë votuar edhe 80 deputetë. Duhet 80 deputetë, ta kini parasysh këtë pse s'u miratua, se s'ka pasur 80 deputetë. S'kanë votuar. Pavarësisht, kanë qenë 92 deputetë sot, por s'kanë votuar. Në bazë të aktvendimit të Gjykatës Kushtetuese, e kemi situatën e njëjtë.

A e provojmë edhe një herë. Edhe një herë mundemi. Atëherë, shkojmë edhe një herë në votim. Traktatin nuk po e fus edhe një herë, se katër herë e futa në votim, pesë. Vetëm zonjën Aida Dërguti edhe një herë në votim po e fusim.

Atëherë, tek çështja e traktatit, unë po e fus njëherë votimin për kryetaren, më duket paska edhe një kusht Vetëvendosja në çështjen e votimit të nënkryetares, pastaj traktatin në qoftë se e voton. Unë po e fus një herë nënkryetaren në votim edhe një herë.

9. Votimi për shkarkimin e nënkryetares së Kuvendit të Republikës së Kosovës, zonjës Aida Dërguti

Është propozim i Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje. Deputetë ka të mjaftueshëm në sallë, ju kisha lutur votoni, prej meje e të gjithë. Shkojmë votojmë tash. Votojmë tash!

A ka mundësi edhe deklarimi me dorë. Pro votimit shkarkim, abstenim.

Kanë votuar 91 deputetë, 89 në mënyrë elektronike, 16 me votën me dorë 17 janë për shkarkim, 26 janë kundër, 47 përkatësisht me votën e Memli Krasniqit 48 janë abstenim.

Kuvendi nuk e miratoi shkarkimin e nënkryetares, zonjës Aida Dërguti.

4. Votimi i Projektligjit nr. 06/L-062 për ratifikimin e Traktatit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Hungarisë për ekstradim

Votojmë tash! Kërkoj falje, duhet edhe një herë se patëm vonesë në sistem. Nuk ka faj edhe regjia, ta kemi parasysh. Regjia, ju kisha lut edhe një herë, kur jeni gati, i bëni me shenjë administratës për t'u futur në proces të votimit. Urdhëro, Sami deri sa të bëhen gati, urdhëro.

SAMI KURTESHI: Tash është për persona të dënuar, për ekstradim e kryem.

KRYETARI: Po, po gjithsesi tani është për persona të dënuar, por të gjitha i kemi vënë nga dytri herë e nuk kalonin, kjo dikur u bë e tepërt. Faleminderit zoti Kurteshi për... se më duket prapë ma kanë sjellë të njëjtën.

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*